

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 39

Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij standardi është të vendosë parimet për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, pasiveve financiare dhe të disa kontratave për shitjen ose blerjen e zërave jofinanciarë. Kërkesat për paraqitjen e informacionit rreth instrumentave financiarë janë dhënë në SNK 32 *Instrumentat financiarë: Paraqitja*. Kërkesat për dhënien e informacionit shpjegues rreth instrumentave financiarë janë dhënë në SNRF 7 *Instrumentat financiarë: Dhënie informacionesh shpjeguese* Dhënia e informacioneve shpjeguese.

Objekti

- 2 Ky standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike, për të gjitha llojet e instrumentave financiarë, me përjashtim të:
- (a) atyre interesave në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta të cilat kontabilizohen sipas SNK 27 *Pasqyrat financiare të veçanta dhe të konsoliduara*, SNK 28 *Investime në sipërmarrje ose SNK 31 Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, njësitë ekonomike do të zbatojnë këtë standard në rastin e interesit në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që në përputhje me SNK 27, SNK 28 ose SNK 31 është kontabilizuar sipas këtij standardi. Njësitë ekonomike do ta zbatojnë, gjithashtu, këtë standard për derivativët mbi një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët me përjashtim të rastit kur derivativi plotëson përkufizimin e dhënë në SNK 32 të një instrumenti kapitali neto të një njësie ekonomike.
 - (b) të drejtat dhe detyrimet që lindin nga qiratë për të cilat zbatohet SNK 17 *Qiratë*. Megjithatë:
 - (i) qiratë e arkëtueshme të njohura nga qiradhënësi janë subjekt i mosnjohjes dhe i provizioneve për zhvlerësim të këtij standardi (shih paragrafet 15–37, 58, 59, 63–65 dhe paragrafet AG36–AG52 dhe AG84–AG93 në shtojcën A);
 - (ii) qiratë financiare të pagueshme, të njohura nga qiramarrësi, janë subjekt i provizioneve të mosnjohjes të këtij standardi (shih paragrafet 39–42 dhe paragrafet AG57–AG63 të shtojcës A); dhe (iii) derivativët që janë të përfshirë në qiratë janë subjekt i provizioneve për derivativët e përfshirë të këtij standardi (shih paragrafet 10–13 dhe paragrafet AG27–AG33 në shtojcën A).
 - (c) të drejtat dhe detyrimet e punonjësve sipas skemave të përfitimit të punonjësve për të cilat zbatohet SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*.
 - (d) instrumentat financiarë, të emetuara nga njësia ekonomike, që plotësojnë përkufizimin e dhënë në SNK 32 të një instrumenti kapitali neto (përfshirë opsionet dhe garancitë). Megjithatë, zotëuesi i këtyre instrumentave kapitali neto do të zbatojë këtë standard për këto instrumenta, me përjashtim të rastit kur ato plotësojnë pikën (a) më sipër.
 - (e) të drejtat dhe detyrimet që lindin nga (i) një kontratë sigurimi që përkufizohet në SNRF 4 *Kontratat e sigurimit*, përveç të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga një kontratë sigurimi që plotëson përkufizimin e dhënë për një kontratë garancie financiare në paragrafin 9, ose (ii) një kontratë që është objekt i SNRF 4 meqë ajo përmban një tipar të pjesëmarrjes së lirë. Megjithatë, ky standard zbatohet për një derivativ që është i përfshirë në një kontratë që përbën objekt të SNRF 4, në qoftë se derivativi nuk është në vetvete një kontratë objekt i SNRF 4 (shih paragrafet 10–13 dhe paragrafet AG27–AG33 në shtojcën A të këtij standardi). Për më tepër, në qoftë se një emetues i kontratave të garancisë financiare ka pohuar paraprakisht në mënyrë të qartë që ai i konsideron këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për kontratat e sigurimit, atëherë emetuesi mund të zgjedhë të zbatojë ose standardin ose SNRF 4 për këto lloj kontratash (shih paragrafet AG4 dhe AG4A). Emetuesi mund ta bëjë këtë zgjedhje kontratë pas kontrate, por zgjedhja për secilën kontratë është e papapësueshme.
 - (f) kontratat për shumat eventuale në një kombinim biznesesh (shih SNRF 3 *Kombinimet e bizneseve*). Ky përjashtim bëhet vetëm për blerësin.

- (g) kontratat midis një blerësi dhe një shitësi në një kombinim biznesesh për të blerë ose për të shitur një njësi të blerë në një datë të ardhshme.
- (h) angazhimet për hua, përveç atyre angazhimeve të përshkruara në paragrafin 4. Një emetues i angazhimeve për hua do të zbatojë SNK 37 *Provizionet, pasivet eventuale dhe aktivet eventuale* për angazhime huaje të cilat nuk janë objekt i këtij standardi. Megjithatë, të gjitha angazhimet për hua janë subjekt i provizioneve për mosnjohje të këtij standardi (shih paragrafet 15–42 dhe paragrafet AG57–AG63 të shtojcës A);
- (i) instrumentat financiarë, kontratat dhe detyrimet sipas transaksioneve të pagesave bazuar në aksione, për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesa të bazuara në aksione*, me përjashtim të kontratave që janë objekt i paragrafeve 5–7 të këtij standardi, për të cilat zbatohet ky standard.
- (j) të drejtat e njësisë ekonomike për pagesa për rimbursim të shpenzimeve që kërkohen të bëhen për të shlyer një pasiv që njihet si një provizion në përputhje me SNK 37, ose për të cilin, në një periudhë më të hershme, është njohur një provizion në përputhje me SNK 37.

3 [Fshirë]

4 **Angazhimet e mëposhtme për hua janë objekt i këtij standardi:**

- (a) angazhimet për hua që njësia ekonomike i ka planifikuar si pasive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Një njësi ekonomike që ka një praktikë të kaluar të shitjes së aktiveve, si rezultat i një angazhimi për hua, pak pas nisjes do të zbatojë këtë standard për të gjitha angazhimet për hua të saj të së njëjtës klasë.
- (b) angazhimet për hua që mund të shlyhen neto në mjete monetare ose duke livruar apo duke emetuar një tjetër instrument financiar. Këto angazhime për hua quhen derivativë. Një angazhim për hua nuk konsiderohet si hua që shlyhet neto vetëm sepse huaja paguhet në këste (p.sh. një hua hipotekare për ndërtesë që paguhet në këste sipas shkallës së përfundimit të ndërtesës).
- (c) angazhimet për të siguruar një hua me një normë interesi poshtë nivelit të tregut. Paragrafi 47(d) specifikon matjen e mëpasshme të pasiveve që lindin nga këto angazhime për hua.

5 **Ky standard do të zbatohet për ato kontrata blerje ose shitje të një zëri jofinanciar që mund të shlyhet neto në mjete monetare ose me një tjetër instrument financiar, ose nëpërmjet këmbimit të instrumentave financiarë, sikur këto kontrata të ishin instrumenta financiarë, me përjashtim të kontratave që janë klasifikuar dhe vazhdojnë të mbahen për qëllime të marrjes ose livrimit të një zëri jofinanciar, në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerje, shitje apo përdorim.**

6 Ka mënyra të ndryshme sipas të cilave një kontratë shitjeje ose blerjeje e një zëri jofinanciar mund të shlyhet neto në mjete monetare ose me një instrument financiar tjetër ose nëpërmjet këmbimit të instrumentave financiarë. Këto përfshijnë:

- (a) kur termat e kontratës lejojnë që çdo palë të shlyejë neto në mjete monetare ose me një instrument financiar tjetër ose nëpërmjet këmbimit të instrumentave financiarë;
- (b) kur mundësia për të shlyer neto në mjete monetare ose me një instrument financiar tjetër ose nëpërmjet këmbimit të instrumentave financiarë nuk është shprehur në mënyrë të qartë në termat e kontratës, por njësia ekonomike ka një praktikë të shlyerjes së kontratave të ngjashme neto në mjete monetare ose në instrument financiar tjetër ose nëpërmjet këmbimit të instrumentave financiarë (qoftë nga pala tjetër, nëpërmjet hyrjes në kontrata kompensuese ose nëpërmjet shitjes së kontratës para ushtrimit apo ndërprerjes së saj);
- (c) kur njësia ekonomike, për kontrata të ngjashme ka një praktikë të marrjes në dorëzim dhe shitjes së aktivitet bazë brenda një periudhe të shkurtër kohe mbas livrimit me qëllim gjenerimin e fitimit nga luhatjet afatshkurtëra në çmim ose në marzhin e shitësit; dhe
- (d) kur zëri jofinanciar, që është subjekt i kontratës, është i konvertueshëm menjëherë në mjete monetare.

Kontrata për të cilën zbatohet pika (b) ose (c) nuk ka si qëllim marrjen apo livrimin e zërit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerje, shitje ose për përdorim dhe rrjedhimisht është objekt i këtij standardi. Për kontratat e tjera, për të cilat zbatohet paragrafi 5, përcaktohet nëse ato klasifikohen dhe vazhdojnë të mbahen për qëllim të marrjes ose livrimit të zërit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerje, shitje ose përdorim dhe rrjedhimisht nëse ato janë objekt i këtij standardi.

7 Një opsion i shkruar për të blerë ose shitur një zëri jofinanciar që mund të shlyhet neto në mjete monetare ose në një instrument financiar tjetër ose nëpërmjet këmbimit të instrumentave financiarë, në përputhje me paragrafin 6(a) ose (d) është objekt i këtij standardi. Një kontratë e tillë nuk mund të klasifikohet për qëllim të marrjes ose

livrimin të një zëri jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësië ekonomike për blerje, shitje ose përdorim.

Përkufizime

8 Termat e përkufizuar në SNK 32 përdoren në këtë standard me kuptimet e specifikuar në paragrafin 11 të SNK 32. Në SNK 32 përkufizohen termat e mëposhtëm:

- instrument financiar
- aktiv financiar
- pasiv financiar
- instrument kapitali neto

dhe jepet udhëzimi për zbatimin e këtyre përkufizimeve.

9 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë standard me kuptime të specifikuar:

Përkufizimi i një derivativi

Derivativi është një instrument financiar ose çdo kontratë tjetër që përbën objekt të këtij standardi (shih paragrafet 2–7), që ka të tre karakteristikat e mëposhtme:

- (a) vlera e tij ndryshon në vartësi të normës specifike të interesit, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallit, kursit të këmbimit të monedhës, indeksit të çmimeve ose normave, normës së kredisë apo indeksit të kredisë, ose variablave të tjerë, siç është në rastin e një variabli jofinanciar që nuk është specifik për njërën palë të kontratës (shpeshherë i quajtur variabël “bazë”);
- (b) kostoja fillestare e tij është zero ose më e vogël në krahasim me lloje të tjera kontratash, që priten të ndikohen në të njëjtën mënyrë nga ndryshimet në faktorët e tregut; dhe
- (c) shlyerja e tij bëhet në të ardhmen.

Përkufizimet e katër kategorive të instrumentave financiarë

Aktivi financiar ose pasivi financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një aktiv financiar ose pasiv financiar që plotëson njerin prej kushteve të mëposhtme.

- (a) Klasifikohet si aktiv financiar i mbajtur për tregtim. Një aktiv financiar ose pasiv financiar klasifikohet si i mbajtur për tregtim në qoftë se ai është:
 - (i) blerë ose krijuar kryesisht për qëllime shitjeje ose riblerjeje në një periudhë të shkurtër kohe;
 - (ii) pjesë e një portofoli të instrumentave financiarë të identifikuar që drejtohen sëbashku dhe për të cilin ka evidencë të ekzistencës së një modeli të kohëve të fundit për realizimin e fitimeve afatshkurtëra; ose
 - (iii) pjesë e një portofoli të instrumentave financiarë të identifikuar që drejtohen sëbashku dhe për të cilin ka evidencë të ekzistencës së një modeli të kohëve të fundit për realizimin e fitimeve afatshkurtëra; ose
- (b) Në njohjen e tij fillestare, njësi ekonomike e përcakton si instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Një njësi ekonomike mund të bëjë këtë përcaktim vetëm kur lejohet nga paragrafi 11A, ose kur, duke vepruar kështu, merret informacioni i duhur, sepse nga njera anë
 - (i) eliminohet ose ulet në mënyrë të ndryshme paqëndrueshmëria në matjen ose njohjen fillestare (disa herë referuar si një “mospërkim kontabël”), që do të ishte si rezultat i matjes së aktiveve ose pasiveve apo njohjes së fitimeve dhe humbjeve të tyre mbi baza të ndryshme; ose nga ana tjetër
 - (ii) një grup aktivesh financiare, pasivesh financiare ose të dyja së bashku drejtohen dhe performanca e tyre vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me një drejtim rreziku të dokumentuar apo strategji investimi. Informacioni rreth grupit sigurohet brenda për brenda me mbështetjen e personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike

(sikurse përkufizohet në SNK 24 *Dhënie informacionesh shpjeguese për palët e lidhura* (i rishikuar në 2003)), për shembull bordi i drejtorëve dhe presidenti i njësisë ekonomike.

Në SNRF 7, në paragrafet 9–11 dhe B4 kërkohet që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese rreth aktiveve financiare dhe pasiveve financiare që ajo ka përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, duke treguar mënyrën se si duhet të plotësohen këto kushte. Për instrumentat e kualifikuar në përputhje me pikën (ii) më sipër, informacioni shpjegues jepet në formën e një përshkrimi tregues se si është bërë përcaktimi si instrument me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me drejtimin e rrezikut të dokumentuar ose me strategjinë e investimit të njësisë ekonomike.

Investimet në instrumenta kapitali neto, që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar në një treg aktiv, dhe që vlera e drejtë e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme (shih paragrafin 46(c) dhe paragrafet AG80 dhe AG81 në shtojcën A), nuk do të përcaktohen si instrumenta financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Duhet të vihet në dukje që paragrafet 48, 48A, 49 dhe paragrafet AG69–AG82 në shtojcën A, të cilat vendosin kërkesat për të bërë një matje të besueshme të vlerës së drejtë të një aktivi financiar ose të një pasivi financiar, zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë zërat e matur me vlerë të drejtë si gjatë përcaktimit, ashtu edhe kur jepet informacion shpjegues për vlerën e drejtë.

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare joderivative me pagesa fikse të përcaktueshme dhe me maturitet fiks, që një njësi ekonomike ka synimin e qartë dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim (shif paragrafet AG16–AG25 në shtojcën A), me përjashtim të :

- (a) atyre që njësi ekonomike në njohjen fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- (b) atyre që njësi ekonomike i përcakton si të vlefshme për shitje; dhe
- (c) atyre që plotësojnë përkufizimin e dhënë për huatë dhe llogaritë e arkëtueshme.

Një njësi ekonomike nuk do të klasifikojë asnjë aktiv financiar si të mbajtur për maturim në qoftë se ajo, gjatë vitit aktual financiar ose gjatë dy viteve financiare të mëparshme, ka shitur ose riklasifikuar përpara maturimit një sasi të rëndësishme (kjo në lidhje me sasinë totale të investimeve të mbajtura për maturim) investimesh të mbajtura për maturim, përveç shitjeve ose riklasifikimeve që:

- (i) janë kaq afër maturimit ose datës së blerjes së aktivit financiar (për shembull, më pak se tre muaj përpara maturimit) sa që ndryshimet në normën e interesit të tregut nuk kanë ndikim të ndjeshëm në vlerën e drejtë të aktivit financiar;
- (ii) kryhen pasi njësi ekonomike ka arkëtuar kryesisht të gjithë principalin fillestar të aktivit financiar nëpërmjet pagesave të planifikuara ose parapagesave; ose (iii) lidhen drejtpërdrejt me një ngjarje të izoluar, që është jashtë kontrollit të njësisë ekonomike, që është e papërsëritshme dhe që nuk mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme nga njësi ekonomike.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare joderivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, me përjashtim të:

- (a) atyre që njësi ekonomike ka si qëllim t'i shesë menjëherë ose në një periudhë të afërt, që do të klasifikohen si aktive të mbajtura për tregtim dhe atyre që njësi ekonomike në njohjen fillestare i përcakton si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- (b) atyre që njësi ekonomike në njohjen fillestare i përcakton si të vlefshme për shitje; ose
- (c) atyre për të cilat mbajtësi nuk mund të mbulojë kryesisht të gjithë investimin fillestar, përjashtuar për shkak të përkeqësimit të kredisë, që do të klasifikoheshin si të vlefshme për shitje.

Një interes i përfutur nga një grup aktivesh që nuk janë hua ose llogari të arkëtueshme (për shembull, një interes në fondet e përbashkëta ose fondet e ngjashme) nuk është hua ose llogari e arkëtueshme.

Aktivet e vlefshme për shitje janë ato aktive financiare joderivative që përcaktohen si të vlefshme për shitje ose që nuk klasifikohen si (a) hua dhe llogari të arkëtueshme (b) investime të mbajtura deri në maturim ose (c) aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Përkufizimi i një kontrate të garancisë financiare

Kontrata e garancisë financiare është një kontratë sipas të cilës kërkohet që emetuesi të bëjë pagesa të specifikuara për të rimbursuar zotëruesin për një humbje që ndodh për shkak se një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesën në përputhje me kushtet fillestare ose të modifikuara të instrumentit të borxhit.

Përkufizimi në lidhje me njohjen dhe matjen

Kostoja e amortizuar e një aktivi financiar ose pasivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose pasivi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar të ndonjë difference mes shumës fillestare dhe shumës në maturim, duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe minus çdo zvogëlim (të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes) për shkak të zhvlerësimit ose pamundësisë së arkëtimit.

Metoda e interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një pasivi financiar (ose grup aktivesh financiare ose pasivesh financiare) dhe për shpërndarjen e të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit në periudhën përkatëse. *Norma e interesit efektiv* është norma, me të cilën skontohen ekzaktësisht pagesat e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose kur është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të aktivit financiar ose pasivit financiar për periudhën më të shkurtër. Për llogaritjen e normës së interesit efektiv, njësia ekonomike duhet të çmojë flukset e mjeteve monetare duke iu referuar të gjitha termave kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull shlyerjeve, blerjeve dhe opsioneve të ngjashme), por pa marrë parasysh humbjet e ardhshme kreditore. Llogaritja përfshin të gjitha shumatat e paguara ose të marra midis palëve të kontratës që janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv (shih SNK 18 *Të ardhurat*), si dhe të gjitha primet ose zbritjet e tjera. Kjo presupozon që flukset e mjeteve monetare dhe jeta e pritshme e një grupi instrumentash financiarë të ngjashëm mund të çmohen me besueshmëri. Megjithatë, në raste të rralla, kur nuk është e mundur të çmohen në mënyrë të besueshme flukset e mjeteve monetare ose jeta e pritshme e një instrumenti financiar (ose grupi instrumentash financiarë), njësia ekonomike do të përdorë flukset kontraktuale të mjeteve monetare gjatë afatit të plotë kontraktual të instrumentit financiar (ose grupi instrumentash financiarë).

Mosnjohja është heqja nga bilanci kontabël i njësisë ekonomike e një aktivi financiar ose pasivi financiar paraprakisht të njohur.

Vlera e drejtë është shuma me të cilën mund të shkëmbehej një aktiv, ose mund të shlyhej një pasiv, midis palëve të vullnetëshme të mirëinformuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën.^{*}

Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje është blerja ose shitja e një aktivi financiar sipas një kontrate, termat e së cilës kërkojnë që aktivi të livrohet brenda kuadrit kohor të vendosur, në përgjithësi sipas rregullimit ose konvencionit në tregun përkatës.

Kostot e transaksioneve janë kostot shtesë që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen, emetimin ose likuidimin e një aktivi financiar ose pasivi financiar (shih shtojcën A paragrafi AG13). Një kosto shtesë është ajo kosto e cila nuk ndodh nëse nuk kryhet blerja, emetimi ose likuidimi i instrumentit financiar.

Përkufizimet në lidhje me kontabilitetin mbrojtës

Një angazhim i përcaktuar është një marrëveshje e detyrueshme për këmbimin e një sasive të specifikuar burimesh, me një çmim të specifikuar, në një datë të ardhshme të specifikuar.

Një transaksion parashikues është një transaksion i paangazhuar, por që parashikohet të realizohet në të ardhmen.

Instrument mbrojtës është një derivativ i përcaktuar ose (për mbrojtjen vetëm nga rreziku i ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhës) një aktiv financiar joderivativ, ose një pasiv financiar joderivativ, vlera e drejtë e të cilit ose flukset e mjeteve monetare të tij pritet të kompensojnë ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të zërit të mbrojtur të përcaktuar (paragrafet 72–77 dhe paragrafet AG94–AG97 në shtojcën A shtjellojnë përkufizimin e një instrumenti mbrojtës).

Një zë mbrojtës është një aktiv, pasiv, angazhim i përcaktuar, transaksion parashikues me një probabilitet të lartë ose investimi neto në një njësi ekonomike të huaj që (a) e ekspozon njësinë ndaj rrezikut të ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e ardhshme të mjeteve monetare dhe (b) është përcaktuar që të jetë mbrojtës (paragrafet 78–84 dhe paragrafet AG98–AG101 në shtojcën A shtjellojnë përkufizimin e zërave të mbrojtur).

^{*} Paragrafët nga 48 deri në 49 dhe nga AG69 deri në AG82 të Shtojcës A pëmbajnë kërkesat për gjetjen e vlerës së drejtë të një aktivi financiar ose të një pasivi financiar.

Mbrojtja efektive është shkalla me të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare, që lidhen me një rrezik të mbrojtur, kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të instrumentit mbrojtës (shih paragrafet AG105–AG113 në shtojcën A).

Derivatvët e përfshirë

- 10 Një derivativ i përfshirë është një element i një instrumenti të kombinuar që gjithashtu përfshin një kontratë bazë joderivative – duke bërë që flukset e mjeteve monetare të instrumentit të kombinuar të ndryshojnë në të njëjtën mënyrë sikur të ishte një derivativ i veçuar. Një derivativ i përfshirë bën që të gjitha ose një pjesë e flukseve të mjeteve monetare të një kontrate të modifikohen në vartësi të normës specifike të interesit, çmimit të instrumentit financiar, çmimit të mallit, kursit të këmbimit të monedhës, indeksit të çmimeve ose normave, normës së kredisë apo indeksit të kredisë, ose variablave të tjerë, siç është në rastin e një variabli jofinanciar që nuk është specifik për një palë të kontratës. Një derivativ që është i lidhur me një instrument financiar, por që është i transferueshëm kontraktualisht në mënyrë të pavarur nga ky instrument, ose që ka një llogari të zbritjes të ndryshme nga ky instrument, nuk konsiderohet një derivativ i përfshirë, por një instrument financiar i veçantë.
- 11 **Një derivativ i përfshirë duhet të jetë i veçuar nga kontrata bazë dhe të kontabilizohet sipas standardit nëse dhe vetëm nëse:**
- (a) **karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e derivativit të përfshirë nuk kanë lidhje shumë të ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë (shih paragrafet AG30 dhe AG33 të shtojcës A);**
 - (b) **një instrument i veçantë me të njëjtat terma sikurse derivativi i përfshirë duhet të plotësojë përkufizimin e një derivativi; dhe**
 - (c) **instrumenti hibrid (i kombinuar) nuk matet me vlerën e drejtë nëpërmjet njohjes në fitim ose humbje të ndryshimeve në vlerën e drejtë (d.m.th. një derivativ që është i përfshirë në një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk konsiderohet i veçuar).**
- Në qoftë se një derivativ i përfshirë është i veçuar, kontrata bazë duhet të kontabilizohet sipas këtij standardi nëse ai është një instrument financiar dhe në përputhje me standardet e tjera përkatëse nëse nuk është një instrument financiar. Ky standard nuk adreson nëse një derivativ i përfshirë do të paraqitet në pasqyrat financiare.
- 11A **Pavarësisht nga paragrafi 11, në qoftë se një kontratë përmban një ose më shumë derivativë të përfshirë, njësia ekonomike mund ta përcaktojë tërë kontratën hibride (të kombinuar) si një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes me përjashtim të:**
- (a) **derivativit(ët) të përfshirë që nuk modifikon në mënyrë të ndjeshme flukset e mjeteve monetare që ndërkaq do të kërkoheshin nga kontrata; ose**
 - (b) **është e qartë, pa qenë nevoja e ndonjë analize, se për një instrument të konsideruar qysh në fillim si instrument hibrid (i kombinuar), nuk lejohet ndarja e derivativit të përfshirë, si në rastin e një opsioni parapagimi i përfshirë në një hua që i lejon mbajtësit të parapaguajë huanë afërsisht me koston e saj të amortizuar.**
- 12 **Në qoftë se një njësi ekonomike, sipas këtij standardi, kërkohet të ndajë derivativin e përfshirë nga kontrata e tij bazë, por që nuk ka mundësi të matë derivativin e përfshirë në mënyrë të veçantë as në datën e blerjes, as në datën e mëpasshme të raportimit financiar, atëhere ajo do ta përcaktojë tërë kontratën hibride (të kombinuar) si instrument me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.**
- 13 Në qoftë se një njësi ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të një derivativi të përfshirë mbi bazën e termave dhe kushteve të tij (për shembull, për shkak se derivativi i përfshirë bazohet në një instrument kapitali neto të pakuotuar), atëhere vlera e drejtë e derivativit të përfshirë do të jetë diferenca midis vlerës së drejtë të instrumentit hibrid (të kombinuar) dhe vlerës së drejtë të kontratës bazë, vetëm nëse këto mund të përcaktohen sipas këtij standardi. Në qoftë se njësia ekonomike nuk është në gjendje të përcaktojë vlerën e drejtë të derivativit të përfshirë duke përdorur këtë metodë, atëhere zbatohet paragrafi 12 dhe instrumenti hibrid (i kombinuar) përcaktohet si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja dhe mosnjohja

Njohja fillestare

- 14 Një njësi ekonomike do të njohë një aktiv financiar ose pasiv financiar në bilancin e saj kur dhe vetëm kur njësia bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. (Shih paragrafi 38 në lidhje me mënyrën e rregullt të blerjeve të aktiveve financiare.)

Mosnjohja e një aktivi financiar

- 15 Në pasqyrat financiare të konsoliduara, paragrafet 6–23 dhe paragrafet AG34–AG52 në shtojcën A zbatohen për një nivel të konsoliduar. Kështu, një njësi ekonomike fillimisht konsolidon të gjitha filialet në përputhje me SNK 27 dhe KIS-12 Konsolidimi— Njësitë ekonomike me qëllim të veçantë dhe pastaj zbatohen paragrafet 16–23 dhe paragrafet AG34–AG52 të shtojcës A në lidhje me grupin që rezulton.

- 16 Përpara se të gjykohet se kur dhe në ç'masë mosnjohja duhet të bëhet sipas paragrafeve 17–23, një njësi ekonomike përcakton nëse këto paragrafe do të zbatohen për një pjesë të aktivit financiar (ose një pjesë të një grupi aktiveve financiare të ngjashme) ose për aktivin financiar (ose grupin e aktiveve financiare të ngjashme) në tërësinë e tij, si më poshtë.

- (a) Paragrafet 17–23 zbatohen për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të grupit të aktiveve financiare të ngjashme) në qoftë se, dhe vetëm në qoftë se, pjesa që konsiderohet për mosnjohje plotëson një nga tre kushtet e mëposhtme.
- (i) Pjesa përfshin vetëm flukset e mjeteve monetare nga aktivi financiar (ose një grup aktiveve financiare të ngjashme), të identifikuar në mënyrë specifike. Për shembull, kur një njësi ekonomike futet në një interval norme interesi me anën e të cilit pala tjetër përfiton të drejtën e flukseve të mjeteve monetare të interesit, por jo të principalit, nga një instrument borxhi, do të zbatohen paragrafet 17-23 për flukset e mjeteve monetare të interesit.
- (ii) Pjesa përfshin vetëm pjesën proporcionale (pro rata) të plotë të flukseve të mjeteve monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktiveve financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në marrëveshje nëpërmjet të cilës pala tjetër përfiton të drejtën e 90% të të gjithë fluksit të mjeteve monetare të një instrumenti borxhi, do të zbatohen paragrafet 17-23 për 90% të këtyre flukseve të mjeteve monetare. Nëse ka më tepër se një palë tjetër, secila prej tyre nuk kërkohet të ketë një pjesë proporcionale në flukset e mjeteve monetare të siguruara, me kusht që njësia transferuese të ketë pjesën e plotë proporcionale.
- (iii) Pjesa përfshin vetëm pjesën e plotë proporcionale (pro rata) të flukseve të mjeteve monetare të identifikuar në mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktiveve financiare të ngjashme). Për shembull, kur një njësi ekonomike hyn në një marrëveshje nëpërmjet të cilës pala tjetër përfiton të drejtën e 90% të të gjithë fluksit të mjeteve monetare të interesit nga një aktiv financiar, do të zbatohen paragrafet 17-23 për 90% të këtyre flukseve të mjeteve monetare. Nëse ka më tepër se një palë tjetër, secila prej tyre nuk kërkohet të ketë një pjesë proporcionale në flukset e mjeteve monetare të identifikuar në mënyrë specifike, me kusht që njësia transferuese të ketë pjesën e plotë proporcionale.
- (b) Në të gjitha rastet e tjera, paragrafet 17–23 zbatohen për një aktiv financiar në tërësinë e tij (ose për një grup aktiveve financiare të ngjashëm në tërësinë e tyre). Për shembull, kur një njësi transferon (i) të drejtat për 90% e parë ose të fundit të arkëtimit në mjete monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktiveve financiare), ose (ii) të drejtat për 90% të flukseve të mjeteve monetare nga një grup llogarish të arkëtueshme, por siguron një garanci për të kompensuar blerësin për një humbje kredie deri në 8 per qind të shumës së principalit të llogarive të arkëtueshme, zbatohen paragrafet 17–23 për aktivin financiar (ose një grup aktiveve financiare të ngjashme) në tërësinë e tij.

Në paragrafet 17–26, termi ‘aktiv financiar’ i referohet ose një pjesë të aktivit financiar (ose një pjesë të një grupi aktiveve financiare të ngjashme) të identifikuar sipas pikës (a) më sipër, ose një aktivi financiar (ose një grup aktiveve financiare të ngjashme) në tërësinë e tij.

- 17 Një njësi ekonomike nuk do të njohë një aktiv financiar kur dhe vetëm kur:

- (a) humbet të drejtën mbi flukset e mjeteve monetare të aktivit financiar; ose

- (b) transferon aktivin financiar sikurse kërkohet në paragrafet 18 dhe 19 dhe transferimi cilësohet për mosnjohje në përputhje me paragrafin 20.

(Shih paragrafin 38 për mënyrën e rregullt të shitjeve të aktiveve financiare.)

- 18 Një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar në qoftë se dhe vetëm në qoftë se, ajo ose :
- (a) transferon të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar. ose
- (b) ruan të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukset e mjeteve monetare nga aktivi financiar, por edhe merr përsipër detyrimin për të paguar flukset e mjeteve monetare për një ose më tepër përfitues në një marrëveshje që plotëson kushtet në paragrafin 19.
- 19 Kur njësi ekonomike ka të drejtë kontraktuale të arkëtojë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ('aktivi origjinal'), por merr përsipër një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse të mjeteve monetare për një ose më shumë njësi ekonomike ('përfitues i rastit'), njësi e trajton transaksionin si një transferim të aktivit financiar nëse dhe vetëm nëse plotësohen tre kushtet e mëposhtme.
- (a) Njësi ekonomike nuk ka detyrim të paguajë përfituesit e rastit, po të mos mbledhë shumat ekuivalente nga aktivi origjinal. Paradhëniet afatshkurtëra nga njësi ekonomike, me të drejtën e mbulimit të plotë të shumës së dhënë hua plus interesin e konstatuar sipas normave të tregut, nuk çenojnë këtë kusht.
- (b) Njësi ekonomike nuk lejohet sipas termave të kontratës së transferimit të shesë apo të hipotekojë aktivin origjinal me përjashtim të rastit të vënies si garanci për përfituesit e rastit për detyrimin për t'u paguar atyre flukset e mjeteve monetare.
- (c) mbledh në emër të përfituesve të rastit pa ndonjë vonesë materiale. Për më tepër, njësi ekonomike nuk ka të drejtën të riinvestojë këto flukse të mjeteve monetare, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare (siç përkufizohet në SNK 7 *Pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare*) gjatë periudhës së shkurtër të shlyerjes nga data e mbledhjes deri në datën e kthimit të kërkuar për përfituesit e rastit. Interesi i përfituar nga këto investime u kalohet përfituesve të rastit.
- 20 Kur një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar (shih paragrafin 18), ajo do të vlerësojë shkallën e rreziqeve dhe përfitimeve që do të ketë nga pronësia e aktivit financiar. Në këtë rast:
- (a) në qoftë se njësi ekonomike transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, atëherë ajo nuk do të njohë aktivin financiar dhe do të njohë veçan si aktive ose pasive çdo të drejtë apo detyrim që lind apo që ruan gjatë transferimit.
- (b) në qoftë se njësi ekonomike ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, atëherë ajo vazhdon ta njohë aktivin financiar.
- (c) në qoftë se njësi ekonomike as nuk transferon, as nuk ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, atëherë ajo do të përcaktojë nëse ka ruajtur kontrollin mbi aktivin financiar. Në këtë rast:
- (i) në qoftë se njësi ekonomike nuk e ka ruajtur kontrollin, ajo nuk do të njohë aktivin financiar dhe do të njohë veçan si aktive apo pasive të drejtat dhe detyrimet e lindura apo të ruajtura nga transferimi.
- (ii) në qoftë se njësi ekonomike e ka ruajtur kontrollin, ajo do të vazhdojë të njohë aktivin financiar sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar (shih paragrafin 30).
- 21 Transferimi i rreziqeve dhe i përfitimeve (shih paragrafin 20) vlerësohet duke krahasuar ekspozimin e njësisë ekonomike para dhe pas transferimit, ndaj ndryshueshmërisë në vlerat dhe afatin kohor të flukseve neto të mjeteve monetare të aktivit të transferuar. Një njësi ekonomike ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi financiar, në qoftë se ekspozimi ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve neto të mjeteve monetare nga aktivi financiar nuk ndryshon në mënyrë të ndjeshme si rezultat i transferimit (p.sh. për shkak se njësi ekonomike ka shitur një aktiv financiar, subjekt i një marrëveshjeje për ta blerë atë përsëri me një çmim fiks ose çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit). Një njësi ekonomike transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi financiar, në qoftë se ekspozimi ndaj një ndryshueshmërie të tillë nuk është mjaft i rëndësishëm në lidhje me ndryshueshmërinë në total në vlerën aktuale të flukseve neto të mjeteve monetare që shoqërojnë aktivin financiar (p.sh. për shkak se njësi ekonomike ka shitur një aktiv financiar, subjekt vetëm i një opsioni për ta blerë atë përsëri me vlerën e drejtë të tij në momentin e riblerjes ose ka transferuar një pjesë proporcionale të plotë të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar më i madh sipas një marrëveshjeje, siç është një hua me nënpjesëmarrje, që plotëson kushtet e paragrafit 19).

- 22 Shpesh është e dallueshme nëse njësi ekonomike ka transferuar ose ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk është e nevojshme që të bëhet ndonjë llogaritje. Në raste të tjera, është e nevojshme të llogaritet dhe të krahasohet ekspozimi i njësisë ekonomike ndaj ndryshueshmërisë në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme neto të mjeteve monetare para dhe pas transferimit. Llogaritja dhe krahasimi bëhet duke përdorur si normë skontimi normën përkatëse të interesit aktual të tregut. E gjithë ndryshueshmëria e mundshme e flukseve të mjeteve monetare merret parasysh duke i dhënë rëndësi të madhe rezultateve që kanë më tepër mundësi të ndodhin.
- 23 Ruajtja e kontrollit (shih paragrafin 20(c)) të aktivit të transferuar nga ana e njësisë ekonomike kushtëzohet nga aftësia e të transferuarit për të shitur aktivin. Në qoftë se i transferuari ka aftësinë praktike të shesë aktivin në tërësinë e tij një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa qenë nevojë të diktojë kufizime shtesë në transferim, atëhere njësi ekonomike nuk e ka ruajtur kontrollin. Në të gjitha rastet e tjera, njësi ekonomike ruan kontrollin.

Transferimet e kualifikuara për mosnjohje (shih paragrafet 20(a) dhe (c)(i))

- 24 Në qoftë se një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar në një transferim që e kualifikon për mosnjohje në tërësinë e tij dhe ruan të drejtat për ta ofruar aktivin financiar për shërbim kundrejt një shpërblimi, ai do të njihet ose si aktiv për shërbim ose si një pasiv për shërbim për këtë kontratë shërbimi. Nëse shpërblimi që merret nuk pritet të kompensojë mjaftueshëm njësinë ekonomike për kryerjen e shërbimit, atëhere do të njihet një pasiv shërbimi me vlerën e drejtë për detyrimin e shërbimit. Nëse shpërblimi që merret pritet të kompensojë mjaftueshëm njësinë ekonomike për kryerjen e shërbimit, atëhere për të drejtën e shërbimit do të njihet një aktiv shërbimi, me vlerën e përcaktuar mbi bazën e shpërndarjes së vlerës kontabël të aktivit më të madh financiar, në përputhje me paragrafin 27.
- 25 Në qoftë se si rezultat i një transferimi, një aktiv financiar nuk është njohur në tërësinë e tij dhe ky transferim çon në përfitim të një aktivi financiar ose marrjen përsipër të një pasivi financiar të ri nga ana e njësisë, ose të një pasivi shërbimi, atëhere njësi ekonomike do të njohë aktivin financiar të ri, pasivin financiar të ri ose pasivin e shërbimit me vlerën e drejtë.
- 26 Nga mosnjohja e një aktivi financiar në tërësinë e tij, diferenca midis:
- (a) vlerës kontabël (neto) dhe
 - (b) madhësisë së (i) shumës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfutur pakësuar me çdo pasiv të ri të marrë përsipër) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto (shih paragrafin 55(b))
- do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.
- 27 Në qoftë se aktivi i transferuar është pjesë e një aktivi financiar të madh (p.sh. kur një njësi ekonomike transferon flukset e mjeteve monetare të interesit që janë pjesë e një instrument borxhi, shih paragrafin 16(a)) dhe pjesa e transferuar kualifikohet për mosnjohje në tërësinë e saj, vlera kontabël neto e mëparshme e aktivit financiar të madh do të shpërndahet midis pjesës që do të vazhdojë të njihet dhe pjesës që nuk do të njihet, bazuar në vlerat e drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, një aktiv shërbimi i ruajtur do të trajtohet si një pjesë që vazhdon të jetë e njohur. Diferenca midis:
- (a) vlerës kontabël neto që i përket pjesës që nuk njihet dhe
 - (b) madhësisë së (i) shumës së arkëtuar për pjesën që nuk njihet (përfshirë çdo aktiv të ri të përfutur pakësuar me çdo pasiv të ri të marrë përsipër) dhe çdo fitimi ose humbje neto kumulative që i përket asaj pjese që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto (shih paragrafin 55(b))
- do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Fitimi ose humbja neto kumulative që është njohur në kapitalin neto shpërndahet midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që nuk është njohur, bazuar në vlerat e drejta përkatëse të këtyre pjesëve.
- 28 Kur një njësi shpërndan vlerën kontabël neto të mëparshme të një aktivi financiar të madh midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që nuk është njohur, është e nevojshme të përcaktohet vlera e drejtë e pjesës që vazhdon të njihet. Kur njësi ekonomike ka një histori të shitjes së pjesëve të ngjashme me pjesën që vazhdon të njihet ose ekzistojnë transaksione të tjera të tregut për këto pjesë, çmimet më të fundit të transaksioneve aktuale japin vlerësimin më të mirë të vlerës së drejtë. Kur nuk ka çmime të kuotuar ose transaksione tregu më të fundit për të mbështetur vlerën e drejtë të pjesës që vazhdon të njihet, vlerësimi më e mirë e vlerës së drejtë është diferenca midis vlerës së drejtë të aktivit financiar të madh në tërësi dhe shumës së marrë nga i transferuari për pjesën që nuk njihet.

Transferimet që nuk kualifikohen për mosnjohje (shih paragrafin 20(b))

- 29 Në qoftë se një transferim nuk çon në mosnjohje, sepse njësi ekonomike ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit të transferuar, atëherë njësi do të vazhdojë të njohë aktivin e transferuar në tërësinë e tij dhe do të njohë një pasiv financiar për shumën e arkëtuar. Në periudhat e mëpasshme, njësi do të njohë çdo fitim nga aktivi i transferuar dhe çdo shpenzim të kryer për pasivin financiar.

Përfshirja e vazhdueshme në aktivet e transferuara (shih paragrafin 20(ii))

- 30 Në qoftë se një njësi ekonomike as nuk transferon, as nuk ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi të transferuar si dhe kontrollin e aktivit të transferuar, atëherë ajo vazhdon të njohë aktivin e transferuar në varësi të shkallës së përfshirjes së vazhdueshme në të. Shkalla e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike në aktivin e transferuar është shkalla me të cilën ajo ekspozohet ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar. Për shembull:

- (a) kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë merr formën e garantimit të aktivit të transferuar, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme është madhësia më e vogël e (i) vlerës së aktivit dhe (ii) madhësisë maksimale të shumës së arkëtuar që do t'i kërkohej njësisë për të ripaguar ('vlerë garancie').
- (b) kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerjes (ose të dyja bashkë) të aktivit të transferuar, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme është vlera e aktivit të transferuar që njësi ekonomike mund ta riblejë. Megjithatë, në rastin e një opsioni të shkruar për një aktiv që matet me vlerë të drejtë, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike kufizohet në madhësinë më të vogël të vlerës së drejtë të aktivit të transferuar dhe çmimit të përdorimit të opsionit (shih paragrafin AG48).
- (c) kur përfshirja e vazhdueshme e njësisë merr formën e një opsioni të shlyer me mjete monetare ose të një provizioni të ngjashëm për aktivin e transferuar, shkalla e përfshirjes së vazhdueshme matet në të njëjtën mënyrë siç rezulton nga opsionet e shlyera jo me mjete monetare sipas pikës (b) më sipër.

- 31 Kur një njësi ekonomike vazhdon të njohë një aktiv sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme në të, atëherë njësi njuh gjithashtu edhe pasivin që e shoqëron. Pavarësisht nga kërkesat e tjera të matjes në këtë standard, aktivi i transferuar dhe pasivi që e shoqëron maten mbi bazën që reflekton të drejtat dhe detyrimet që ka një njësi ekonomike. Pasivi shoqërues matet në një mënyrë të tillë që vlera kontabël neto e aktivit të transferuar dhe e pasivit shoqërues është:

- (a) kostoja e amortizuar e të drejtave dhe detyrimeve që ka njësi ekonomike, në qoftë se aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar; ose (b) e barabartë me vlerën e drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që ka njësi, të matura në mënyrë të veçantë, në qoftë se aktivi i transferuar matet me vlerën e drejtë;

- 32 Njësi ekonomike do të vazhdojë të njohë çdo fitim që rrjedh nga aktivi i transferuar sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme dhe do të njohë çdo shpenzim të kryer për pasivin shoqërues.

- 33 Për qëllime të matjes së mëpasshme, ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të aktivit të transferuar dhe pasivi shoqërues kontabilizohen në qëndrueshmëri me njëri tjetrin në përputhje me paragrafin 55, dhe nuk do të bëhet kompensim.

- 34 Në qoftë se përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike është vetëm në një pjesë të aktivit financiar (p.sh. kur një njësi ekonomike ka një opsion të riblerjes pjesërisht të një aktivi të transferuar, ose ka një interes të mbetur që nuk çon në marrjen kryesisht të të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë si dhe mbajtjen e kontrollit), njësi ekonomike shpërndan vlerën kontabël të mëparshme të aktivit financiar midis pjesës që ajo vazhdon ta njohë sipas përfshirjes së vazhdueshme dhe pjesës që nuk njihet më, mbi bazën e vlerave të drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, zbatohen kërkesat e paragrafit 28. Diferenca midis:

- (a) vlerës kontabël të shpërndarë për pjesën që nuk njihet më; dhe
- (b) madhësisë së (i) shumës së arkëtuar për pjesën që nuk njihet më dhe (ii) çdo fitim ose humbje neto kumulative që i përket asaj që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto (shih paragrafin 55(b)),

do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Fitimi ose humbja neto kumulative që është njohur në kapitalin neto shpërndahet midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që nuk njihet më, bazuar në vlerat e drejta përkatëse të këtyre pjesëve.

- 35 Në qoftë se aktivi i transferuar matet me koston e amortizuar, opsioni në këtë standard, për të përcaktuar një pasiv financiar si instrument financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nuk është i zbatueshëm për pasivin shoqërues.

Të gjitha transferimet

- 36 Në qoftë se një aktiv i transferuar vazhdon të njihet, atëhere aktivi dhe pasivi shoqërues nuk do të kompensohen. Në mënyrë të ngjashme, njësia nuk do të kompensojë fitimet që rrjedhin nga aktivi i transferuar me shpenzimet që kryhen për pasivin shoqërues (shih SNK 32 paragrafin 42).
- 37 Në qoftë se një transferues siguron një kolateral jo në mjete monetare (si një borxh ose instrument kapitali neto) për të transferuarin, kontabilizimi i kolateralit nga transferuesi dhe i transferuari varet nëse i transferuari ka të drejtën e shitjes ose të rivendosjes së garancisë të kolateralit dhe nëse transferuesi i ka plotësuar detyrimet. Transferuesi dhe i transferuari do të kontabilizojnë kolateralin si më poshtë:
- (a) Në qoftë se i transferuari ka të drejtën sipas kontratës ose të drejtës zakonore të shesë apo të rivendosë garancinë e kolateralit, atëhere transferuesi do ta riklasifikojë këtë aktiv në bilancin e tij (p.sh. si një aktiv të marrë hua, instrument kapitali neto të vënë si garanci ose riblerje e llogarive të arkëtueshme) veçan nga aktivet e tjera.
 - (b) Në qoftë se i transferuari shet kolateralin e vënë si garanci, atëhere do të njihen të ardhura nga shitja dhe një pasiv i matur me vlerën e drejtë për detyrimin që ka për të kthyer kolateralin.
 - (c) Në qoftë se transferuesi nuk plotëson detyrimet sipas termave të kontratës dhe nuk ka më të drejtën për ta riblerë kolateralin, atëhere ai nuk do të njohë kolateralin, ndërsa i transferuari do të njohë kolateralin si një aktiv të tij fillimisht të matur me vlerën e drejtë ose, në qoftë se tashmë e ka shitur kolateralin, nuk do të njohë detyrimin e tij për të kthyer kolateralin.
 - (d) Me përjashtim të asaj që thuhet në pikën (c), transferuesi do të vazhdojë ta njohë kolateralin si një aktiv të tij dhe i transferuari nuk do ta njohë kolateralin si një aktiv.

Mënyra e rregullt e blerjes ose shitjes së një aktivi

- 38 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e aktiveve financiare do të njihet ose nuk do të njihet, kur është e përshtatshme, duke përdorur kontabilizimin në datën e tregtimit ose kontabilizimin në datën e shlyerjes (shih paragrafet AG53–AG56 të shtojcës A).

Mosnjohja e një pasivi financiar

- 39 Një njësi ekonomike do të heqë një pasiv financiar (ose një pjesë të pasivit financiar) nga bilanci i saj kontabël kur dhe vetëm kur, ai është likuiduar— d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë është shlyer ose anuluar ose ka mbaruar.
- 40 Një këmbim midis një huamarrësi dhe huadhënësi ekzistues të instrumentave të borxhit, me terma kryesisht të ndryshëm, do të kontabilizohet si një likuidim i pasivit financiar origjinal dhe si njohje fillestare e një pasivi financiar të ri. Në mënyrë të ngjashme, një modifikim i rëndësishëm i termave të një pasivi financiar ekzistues ose të një pjese të tij (qoftë ose jo e lidhur drejtpërdrejt me vështirësinë financiare të debitorit) do të kontabilizohet si një likuidim i pasivit financiar origjinal dhe si njohje fillestare e një pasivi financiar të ri.
- 41 Diferenca midis vlerës kontabël të një pasivi financiar (ose pjesës së një pasivi financiar), i likuiduar ose i transferuar në një palë tjetër, dhe shumës së paguar, përfshirë edhe aktivet jo në mjete monetare të transferuara ose pasivet e marra përsipër, do të njihet në fitim ose humbje.
- 42 Në qoftë se një njësi ekonomike riblen një pjesë të pasivit financiar, njësia do të shpërndajë vlerën kontabël të mëparshme të pasivit financiar midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që nuk njihet bazuar në vlerat e drejta përkatëse të këtyre pjesëve në datën e riblerjes. Diferenca midis vlerës kontabël neto që i përket pjesës që nuk njihet dhe (b) shumës së paguar, përfshirë aktivet jo në mjete monetare të transferuara ose pasivet e marra përsipër, për pjesën që nuk është njohur, do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Matja

Matja fillestare e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare

- 43 Kur një aktiv financiar ose pasiv financiar njihet fillimisht, një njësi ekonomike do ta matë atë me vlerën e drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar ose pasivi financiar jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen ose emetimin e aktivit financiar ose pasivit financiar.
- 44 Kur një njësi ekonomike përdor kontabilizimin në datën e shlyerjes për një aktiv që është matur më pas me kosto ose me koston e amortizuar, atëherë aktivi njihet fillimisht me vlerën e drejtë në datën e tregtimit (shih paragrafet AG53–AG56 në shtojcën A).

Matja e mëposhme e aktiveve financiare

- 45 Për qëllime të matjes së një aktivi financiar pas njohjes fillestare, ky standard e klasifikon aktivin financiar në një nga katër kategoritë e mëposhtme të përkufizuara në paragrafin 9:

- aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes;
- investime të mbajtura deri në maturim;
- hua dhe llogari të arkëtueshme; dhe
- aktive financiare të vlefshme për shitje.

Këto kategori zbatohen për matjen dhe njohjen fillestare të fitimit ose humbjes sipas këtij standardi. Njësia ekonomike mund të përdorë të tjera përshkrime për këto kategori ose kategorizime të tjera kur paraqitet informacioni në pasqyrat financiare. Njësia ekonomike jep informacione shpjeguese në shënimet e kërkuara sipas SNRF 7.

- 46 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të matë aktivet financiare, përfshirë derivativët që janë aktive, me vlerën e drejtë të tyre, pa bërë ndonjë zbritje për kostot e transaksionit që mund të kryhen në shitje ose gjatë nxjerrjes nga përdorimi, me përjashtim të aktiveve financiare të mëposhtme:

- hua dhe llogari të arkëtueshme sipas përkufizimit të dhënë në paragrafin 9, të cilat do të maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- investime të mbajtura deri në maturim sipas përkufizimit të dhënë në paragrafin 9, të cilat do të maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv; dhe
- investimet në instrumenta kapitali neto, që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar në një treg aktiv dhe që vlera e drejtë e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme si dhe derivativët që janë të lidhur dhe duhet të shlyhen nëpërmjet livrimit të këtyre instrumentave kapitali neto të pakuotuar, të cilat do të maten me kosto (shih paragrafet AG80 dhe AG81 në shtojcën A).

Aktivët financiare që janë të përcaktuar si zëra të mbrojtur, i nënshtrohen matjes sipas kërkesave të kontabilitetit mbrojtës në paragrafet 89–102. Të gjitha aktivët financiare, me përjashtim të atyre të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, mund të rishikohen për zhvlerësim në përputhje me paragrafet 58–70 dhe paragrafet AG84–AG93 në shtojcën A

Matja e mëposhme e pasiveve financiare

- 47 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të matë të gjitha pasivet financiare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me përjashtim të:

- pasiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Të tilla pasive, përfshirë edhe derivativët që janë pasive, do të maten me vlerën e drejtë përjashtuar pasivet derivative që janë të lidhur dhe duhet të shlyhen nëpërmjet livrimit të një instrumenti kapitali neto të pakuotuar, që do të matet me kosto me që vlera e drejtë e tij nuk mund të matet në mënyrë të besueshme.
- pasiveve financiare që lindin kur një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për mosnjohje ose kur zbatohet metoda e përfshirjes së vazhdueshme. Paragrafet 29 dhe 31 zbatohen për matjen e këtyre pasiveve financiare.

- (c) kontratave të garancisë financiare sikurse janë përkufizuar në paragrafin 9. Pas njohjes fillestare, një emetues i një kontrate të tillë (nëse nuk zbatohen paragrafet 47(a) ose (b)) do ta matë me vlerën më të madhe të:
- (i) vlerës së përcaktuar në përputhje me SNK 37; dhe
 - (ii) vlerës fillestare të njohur (shih paragrafin 43) pakësuar, kur duhet, me amortizim kumulativ të njohur në përputhje me
- (d) angazhimet për të siguruar një hua me një normë interesi poshtë nivelit të tregut. Pas njohjes fillestare, një emetues i një angazhimi të tillë (nëse nuk zbatohet paragrafi 47(a)) do ta matë atë me vlerën më të madhe të:
- (i) vlerës së përcaktuar në përputhje me SNK 37; dhe
 - (ii) vlerës fillestare të njohur (shih paragrafin 43) pakësuar, kur duhet, me amortizim kumulativ të njohur në përputhje me

Pasivet financiare që janë përcaktuar si zëra të mbrojtur janë subjekt i kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të përshkruara në paragrafet 89–102.

Trajtimi i matjes me vlerën e drejtë

- 48 Në përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi financiar ose të një pasivi financiar me qëllim zbatimin e këtij standardi, SNK 32 ose SNRF 7, një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafet AG69–AG82 të shtojcës A.
- 48A Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi i kuotuar në një treg aktiv. Në qoftë se tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, atëherë njësi ekonomike do të përcaktojë vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është që të vendosë se cili do të ishte çmimi i transaksionit në datën e matjes gjatë këmbimit midis palëve jo të lidhura të mirëinformuara, të vullnetshme, të motivuara gjatë rrjedhës normale të biznesit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë transaksionet më të fundit të kryera midis palëve të palidhura me njera-tjetrën, të vullnetshme, në qoftë se është e mundshme, duke iu referuar vlerës së drejtë aktuale të një instrumenti tjetër që kryesisht është i njëjtë, analizës së fluksit të mjeteve monetare të skontuar dhe modeleve të vlerësimit të opsioneve. Njësi ekonomike përdor një teknikë vlerësimi në qoftë se kjo teknikë është përdorur, zakonisht, nga pjesëmarrësit e tregut për të vlerësuar instrumentin dhe ka treguar se siguron çmuarje të besueshme të çmimeve të përfutuara në transaksionet aktuale të tregut. Teknika e vlerësimit e zgjedhur përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të njësi ekonomike. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vlerësimin e instrumentave financiarë. Periodikisht, një njësi ekonomike kalibron teknikat e vlerësimit dhe i teston për vlefshmërinë e tyre duke përdorur çmimet e transaksioneve aktuale të tregut të mbikëqyruar të të njëjtit instrument (d.m.th. pa bërë modifikime) ose bazuar në të dhënat e disponueshme të tregut të mbikëqyruar.
- 49 Vlera e drejtë e një pasivi financiar me tipar kërkueshmërie pa afat (p.sh. një depozitë pa afat) nuk është më e vogël se shumta e pagueshme sipas kërkesës, skontuar që nga data e parë që shumta do të kërkohej për t'u paguar.

Riklasifikimet

- 50 Një njësi ekonomike nuk do të riklasifikojë një instrument financiar në ose jashtë kategorisë së instrumentit me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ndërkohë që ai mbahet ose emetohet.
- 51 Në qoftë se, si rezultat i një ndryshimi në synim ose në aftësi, nuk është më e përshtatshme të klasifikohet një investim si i mbajtur deri në maturim, ai do të riklasifikohet si instrument financiar i mbajtur për shitje dhe do të matet përsëri me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës së drejtë do të kontabilizohet në përputhje me paragrafin 55(b).
- 52 Sa herë që shitjet ose riklasifikimi i më tepër sesa një shume të parëndësishme të investimeve të mbajtura deri në maturim nuk plotësojnë ndonjë prej kushteve të paragrafit 9, atëherë shumta e mbetur e investimeve të mbajtura deri në maturim do të riklasifikohet si e vlefshme për shitje. Në të tilla riklasifikime, diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë do të kontabilizohet në përputhje me paragrafin 55(b).
- 53 Në qoftë se është e mundur të bëhet një matje e besueshme për një aktiv financiar ose pasiv financiar, për të cilin një matje e tillë nuk ka qenë e mundshme për t'u bërë në periudhat e mëparshme, dhe aktivi ose pasivi kërkohet të matet me vlerën e drejtë, nëse është e mundshme të bëhet një matje e besueshme (shih paragrafet 46(c) dhe 47), atëherë aktivi dhe pasivi do të rimaten me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës së tij kontabël neto dhe vlerës së drejtë do të kontabilizohet në përputhje me paragrafin 55.

- 54 Në qoftë se, si rezultat i një ndryshimi në synim, ose në aftësi, ose në rrethana të rralla që një matje e besueshme e vlerës së drejtë nuk është më e mundshme (shih paragrafet 46(c) dhe 47), ose sepse kanë kaluar ‘dy vitet financiare të shkuara’ duke iu referuar paragrafit 9, është e përshtatshme që një aktiv financiar ose pasiv financiar të mbahet me koston ose koston e amortizuar sesa me vlerën e drejtë, atëhere vlera kontabël sipas vlerës së drejtë e aktivit financiar ose e pasivit financiar në këtë datë do të jetë kostoja e tyre e re ose kostoja e amortizuar, që do të bëhet e zbatueshme. Çdo fitim ose humbje neto e mëparshme nga aktivi, që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto në përputhje me paragrafin 55(b), do të kontabilizohet si më poshtë:
- (a) Në rastin e një aktivi financiar me një maturitet të fiksuar, fitimi ose humbja neto do të amortizohet në fitim ose humbje mbi jetën e mbetur të investimit të mbajtur deri në maturim, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo diferencë midis koston së amortizuar të re dhe vlerës së maturimit, gjithashtu, do të amortizohet gjatë jetës së mbetur të aktivit financiar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, në mënyrë të ngjashme me amortizimin e primit apo të zbritjes. Në qoftë se aktivi financiar zhvlerësohet më pas, çdo fitim ose humbje që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto njihet në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 67.
 - (b) Në rastin e një aktivi financiar që nuk ka maturitet të fiksuar, fitimi ose humbja neto do të mbetet në kapitalin neto deri sa aktivi financiar të shitet ose ndryshe të nxirret jashtë përdorimit dhe të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Në qoftë se aktivi financiar zhvlerësohet më pas, çdo fitim ose humbje neto e mëparshme, që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto, njihet në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 67.

Fitimet dhe humbjet

- 55 Fitimi ose humbja neto që lind nga një ndryshim në vlerën e drejtë të një aktivi financiar ose pasivi financiar, që nuk është pjesë e marrëdhënies mbrojtëse (shih paragrafet 89–102), do të njihet si më poshtë.
- (a) Një fitim ose humbje neto nga një aktiv financiar ose pasiv financiar, i klasifikuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.
 - (b) Fitimi ose humbja neto nga një aktiv financiar i vlefshëm për shitje do të njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto, nëpërmjet pasqyrës së ndryshimeve në kapitalin neto (shih SNK 1 *Parajitja e pasqyrave financiare*), me përjashtim të humbjeve nga zhvlerësimi (shih paragrafet 67–70) dhe fitimeve dhe humbjeve neto nga këmbimi në monedhë të huaj (shih paragrafin AG83 të shtojcës A), deri sa aktivi financiar të mos njihet, moment në të cilin fitimi ose humbja neto kumulative e njohur në periudhat e mëparshme në kapitalin neto do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Megjithatë, interesi i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv (shih paragrafin 9), njihet në fitim ose humbje (shih SNK 18). Dividendët mbi instrumentat e kapitalit neto të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje kur ka lindur e drejta e njësisë ekonomike për të arkëtuar pagesat (shih SNK 18).
- 56 Për aktivet financiare dhe pasivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar (shih paragrafet 46 dhe 47), fitimi ose humbja neto njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur aktivi financiar ose pasivi financiar nuk njihet ose zhvlerësohet, si edhe nëpërmjet procesit të amortizimit. Megjithatë, për aktivet financiare ose pasivet financiare që janë zëra të mbrojtur (shih paragrafet 78–84 dhe paragrafet AG98–AG101 në shtojcën A) kontabilizimi i fitimit ose humbjes neto do të bëhet sipas paragrafeve 89–102.
- 57 Në qoftë se njësisë ekonomike njih aktivet financiare duke përdorur kontabilizimin në datën e shlyerjes (shih paragrafin 38 dhe paragrafet AG53 dhe AG56 të shtojcës A), çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivit të marrë gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes nuk njihet për aktivet e mbajtura me kosto ose me koston e amortizuar (përveç humbjeve nga zhvlerësimi). Sidoqoftë, për aktivet e mbajtura me vlerën e drejtë, ndryshimi në vlerën e drejtë do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose në kapitalin neto, sipas paragrafit 55.

Zhvlerësimi dhe mosarkëtueshmëria e aktiveve financiare

- 58 Njësisë ekonomike do të vlerësojë në çdo datë të bilancit, nëse ka të dhëna që një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare është i zhvlerësuar. Në qoftë se këto të dhëna ekzistojnë, atëhere njësisë ekonomike do të zbatojë paragrafin 63 (për aktivet financiare e mbajtura me koston e amortizuar), paragrafin 66 (për aktivet financiare e mbajtura me kosto) ose paragrafin 67 (për aktivet financiare të vlefshme për shitje) për të përcaktuar shumën e çdo humbjeje nga zhvlerësimi.
- 59 Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare zhvlerësohen dhe do të njihen humbjet nga zhvlerësimi nëse, dhe vetëm nëse, evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (një “rast humbjeje”) dhe që ky rast humbjeje (ose rastet) ka një ndikim në flukset e

çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të një aktivi financiar ose grupi aktivesh financiare që mund të çmohen në mënyrë të besueshme. Ndonjëherë është e pamundur të identifikohet një ngjarje e vetme, e shkëputur, që ka shkaktuar zhvlerësimin. Më saktë, zhvlerësimi mund të jetë shkaktuar nga ndikimi i kombinuar i një sërë ngjarjesh. Humbjet e pritshme si rezultat i ngjarjeve të ardhshme, pavarësisht sesa janë të mundshme, nuk njihen si të tilla. Evidenca objektive e zhvlerësimit të një aktivi financiar ose një grup aktivesh financiare përbëhet nga të dhënat e mbikëqyrura për ngjarjet e mëposhtme, për të cilat mbajtësi i aktivitetit duhet të ketë dijeni:

- (a) vështirësi të rëndësishme financiare të emetuesit ose të huamarrësit;
- (b) mosrespektim i kontratës, si për shembull rasti i dështimit ose rasti i vonësës në pagimin e interesit ose principalit;
- (c) huadhënësi i bën një lëshim huamarrësit, për arsye ekonomike ose ligjore, në lidhje me vështirësinë financiare në të cilën ndodhet, që për huadhënësin nuk është i rëndësishëm;
- (d) janë të mundshme falimentimi ose riorganizime të tjera financiare të huamarrësit;
- (e) zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare; ose
- (f) të dhëna të mbikëqyrura që tregojnë se ka një ulje të ndjeshme në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare nga një grup aktivesh financiare qysh nga njohja fillestare e tyre, ndonëse kjo ulje nuk mund të jetë akoma e identifikueshme për aktive financiare individuale brenda grupit, përfshirë:
 - (i) ndryshimet e pavolitshme në statusin e pagesave të huamarrësve në grup (p.sh. një shtim i pagesave të vonuara ose një shtim i huamarrësve me kartë kredie të cilët kanë arritur kufirin e tyre të kredisë dhe paguajnë shuma minimale mujore); ose
 - (ii) kushtet ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me mungesat në aktivet në grup (p.sh. një rritje në normën e papunësisë në rajonin gjeografik të huamarrësit, një ulje e çmimeve të pasurive të paluajtshme për hipotekim në zonën përkatëse, një ulje e çmimeve të naftës për aktivet e dhëna hua prodhuesve të naftës, ose ndryshimet e pafavorshme në kushtet e industrisë që prekin huamarrësit në grup).

60 Zhdukja e një tregu aktiv për shkak se instrumentat financiare të një njësie ekonomike nuk tregtohen më publikisht nuk përbën një evidencë zhvlerësimi. Një ulje e normës së kredisë së një njësie ekonomike, në vetvete nuk përbën një evidencë zhvlerësimi, ndonëse mund të konsiderohet si e tillë kur merret parasysh edhe një informacion tjetër i disponueshëm. Një ulje në vlerën e drejtë të një aktivi financiar nën koston e tij ose koston e amortizuar nuk përbën patjetër evidencë zhvlerësimi (për shembull, një ulje në vlerën e drejtë të një investimi në instrumenta borxhi që vjen nga rritja e normës së interesit pa rrezik).

61 Përveç llojeve të ngjarjeve të përmendura në paragrafin 59, evidenca objektive e zhvlerësimit për një investim në një instrument kapitali neto përfshin informacionin rreth ndryshimeve të rëndësishme me efekt të kundërt që ndodhin në mjedisin teknologjik, e tregut, ekonomik ose ligjor në të cilin vepron emetuesi dhe tregon që kostoja e investimit në instrument kapitali neto mund të mos rikuperohet. Një ulje e rëndësishme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të një investimi në një instrument kapitali neto, nën koston e tij, përbën gjithashtu një evidencë objektive zhvlerësimi.

62 Në disa raste, të dhënat e mbikëqyrura që duhen për të çmuar shumën e humbjes nga zhvlerësimi i një aktivi financiar mund të jenë të kufizuara ose nuk kanë lidhje plotësisht me rrethanat aktuale. Për shembull, siç është rasti kur huamarrësi është në vështirësi financiare dhe ka shumë pak të dhëna historike të disponueshme në lidhje me huamarrës të ngjashëm. Në të tilla raste, një njësi ekonomike përdor eksperiencën e saj për të çmuar shumën e humbjes nga zhvlerësimi. Po kështu, njësi ekonomike në sajë të përvojës së saj gjykon për rregullimin e të dhënave për një grup aktivesh financiare për të reflektuar rrethanat aktuale (shih paragrafin AG89). Përdorimi i çmuarjeve të arsyeshme është një pjesë e rëndësishme e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe kjo nuk çënon aspak besueshmërinë e tyre.

Aktivitetet financiare të mbajtura me koston e amortizuar

63 **Në qoftë se ka një evidencë objektive që tregon për një humbje nga zhvlerësimi në huatë dhe llogaritë e arkëtueshme ose investimet e mbajtura deri në maturim, të vlerësuara me koston e amortizuar, madhësia e humbjes përcaktohet si diferenca midis vlerës kontabël të aktiveve dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur) skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar (d.m.th. norma e interesit efektiv llogaritur qysh në njohjen fillestare). Vlera kontabël neto e aktivitetit do të zvogëlohet ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes. Vlera e humbjes do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.**

64 Së pari, njësi ekonomike shikon nëse ekziston një evidencë objektive e zhvlerësimit veç e veç për aktivet financiare të cilat janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose në mënyrë kolektive për aktivet

financiare të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht (shih paragrafin 59). Në qoftë se njësi ekonomike gjykon se nuk ekziston një evidencë objektive e zhvlerësimit për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, atëhere ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe i vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre. Aktivet që janë vlerësuar individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat është njohur ose vazhdon të njihet humbja nga zhvlerësimi nuk përfshihen në vlerësimin në mënyrë kolektive të zhvlerësimit.

- 65 Në qoftë se, në një periudhë të mëpasshme, shuma e humbjeve nga zhvlerësimi ulet dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi (siç është përmirësimi i klasifikimit kreditues i borxhmarrësit), humbja nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme do të anulohet ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet rregullimit të llogarisë së zbritjes. Anullimi nuk duhet të bëjë që vlera kontabël neto e aktivit financiar të tejkalojë koston e amortizuar që do të kishte patur ai sikur të mos ishte njohur zhvlerësimi në datën e anulimit. Vlera e humbjes do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Aktivitet financiare të mbajtura me koston

- 66 Në qoftë se ka një evidencë objektive që tregon se ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi në një instrument kapitali neto të pakuotuar, që nuk është mbajtur me vlerën e drejtë, sepse ajo nuk mund të matet me besueshmëri, ose në një aktiv derivativ që është i lidhur dhe që duhet të shlyhet nëpërmjet livrimit të një instrumenti kapitali neto të pakuotuar, shuma e humbjes së zhvlerësimit matet si diferenca midis vlerës kontabël neto të aktivit financiar dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të çmuara të mjeteve monetare skontuar me normën aktuale të tregut të kthimit për një aktiv financiar të ngjashëm (shih paragrafin 46(c) dhe paragrafet AG80 dhe AG81 të shtojcës A). Të tilla humbje nga zhvlerësimi nuk anulohen.

Aktivitet financiare të vlefshme për shitje

- 67 Kur një ulje në vlerën e drejtë të një aktivit financiar të vlefshëm për shitje është njohur drejtpërsëdrejti në kapitalin neto dhe ekziston një evidencë objektive që aktiviteti është zhvlerësuar (shih paragrafin 59), humbja kumulative që është njohur drejtpërsëdrejti në kapitalin neto do të kalojë nga kapitali dhe do të njihet në fitim ose humbje edhe pse nuk është bërë mosnjohja e aktivit financiar.
- 68 Shuma e humbjes kumulative, që është transferuar nga kapitali neto në fitim ose humbje sipas paragrafit 67, do të jetë diferenca midis koston së blerjes (pasi i zbriten shlyerjet e principalit dhe amortizimi) dhe vlerës së drejtë aktuale, zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi në aktivin financiar, që është njohur në periudhat e mëparshme në fitim ose humbje.
- 69 Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje për një investim në një instrument kapitali neto, i klasifikuar si i vlefshëm për shitje, nuk do të anulohen nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes.
- 70 Në qoftë se, në një periudhë të mëpasshme, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi, klasifikuar si i vlefshëm për shitje, rritet dhe kjo rritje vjen për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi, atëhere humbja nga zhvlerësimi do të anulohet në masën e anulimit të njohur në fitim ose humbje.

Mbrojtja

- 71 Në qoftë se ka një marrëdhënie mbrojtëse midis një instrumenti mbrojtës dhe një zëri të mbrojtur, si përshkruhet në paragrafet 85–88 dhe paragrafet AG102–AG104 të shtojcës A, trajtimi kontabël i fitimit ose i humbjes nga instrumenti mbrojtës dhe i zërit të mbrojtur do të përshkruhet në paragrafet 89–102.

Instrumentat mbrojtës

Kualifikimi i instrumentave

- 72 Ky standard nuk kufizon rrethanat në të cilat një derivativ mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës nëse plotësohen kushtet në paragrafin 88, me përjashtim të disa opsioneve të shkruara (shih paragrafin AG94 në shtojcën A). Megjithatë, një aktiv financiar joderivativ ose pasiv financiar joderivativ mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës vetëm për një mbrojtje nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj.
- 73 Për qëllim të kontabilitetit mbrojtës, vetëm instrumentat që përfshijnë një palë të jashtme në njësinë raportuese (d.m.th. i jashtëm për grupin, segment ose njësi e veçantë që raportohet) mund të përcaktohen si instrumenta mbrojtës. Ndonëse njësi ekonomike të veçanta brenda një grupi të konsoliduar ose divizione brenda një njësie

ekonomike mund të hyjnë në marrëdhënie mbrojtëse me njësi të tjera brenda grupit ose divizione brenda njësisë, këto transaksioneve ndërmjet grupit eliminohehen në konsolidim. Prandaj, të tilla transaksione mbrojtëse nuk kualifikohen për kontabilitetin mbrojtës në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit. Megjithatë, ato mund të kualifikohen për kontabilitetin mbrojtës në pasqyrat financiare individuale ose të veçanta të njësisve ekonomike individuale brenda grupit ose në raportimin segmentar me kusht që ato janë të jashtme për njësinë ekonomike individuale ose segmentin që raportohet.

Përcaktimi i instrumentave mbrojtës

- 74 Zakonisht, ka një matje të vetme të vlerës së drejtë për një instrument mbrojtës në tërësinë e tij dhe faktorët që shkaktojnë ndryshimet në vlerën e drejtë janë të bashkëvarur. Kështu, njësia ekonomike përcakton një marrëdhënie mbrojtëse për një instrument mbrojtës në tërësinë e tij. Bëhen vetëm këto përjashtime
- (a) ndarja e vlerës së perceptuar dhe vlerës në kohë të një kontrate opsi, përcaktimi si një instrument mbrojtës vetëm i ndryshimit në vlerën e perceptuar të një opsi dhe përjashtimi i ndryshimit në vlerën e tij kohore; dhe
- (b) ndarja e elementit të interesit dhe e çmimit të çastit (spot) të një kontrate të ardhshme.
- Këto përjashtime lejohen sepse vlera e perceptuar e opsi dhe primi i një kontrate të ardhshme në përgjithësi mund të maten në mënyrë të veçantë. Një strategji mbrojtëse dinamike që vlerëson si vlerën e perceptuar, ashtu dhe vlerën në kohë të një kontrate opsi mund të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës.
- 75 Një pjesë proporcionale e tërë instrumentit mbrojtës, të themi 50 për qind e shumës imagjinare, mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës në një marrëdhënie mbrojtëse. Megjithatë, një marrëdhënie mbrojtëse mund të mos përcaktohet vetëm për një pjesë të periudhës kohore gjatë të cilës instrumenti mbrojtës mbetet i pashlyer.
- 76 Një instrument mbrojtës i vetëm mund të përcaktohet për mbrojtje ndaj më tepër se një lloj rreziku me kusht që (a) rreziqet e mbrojtur mund të identifikohen qartë (b) efektiviteti i mbrojtjes mund të demonstrohet; dhe (c) është e mundur të bëhet një përcaktim specifik i instrumentit mbrojtës dhe i gjendjeve të ndryshme të rrezikut.
- 77 Dy ose më shumë derivativë ose proporcione të tyre, (në rastin e mbrojtjes nga rreziku i monedhës, dy ose më shumë joderivativë ose proporcione të tyre, ose një kombinim të derivativëve dhe joderivativëve ose proporcioneve të tyre), mund të shihen në kombinim dhe të përcaktohen së bashku si një instrument mbrojtës, duke përfshirë edhe rastet kur rreziqet që lindin nga disa derivativë kompensojnë ata që lindin nga të tjerë derivativë. Megjithatë, kufijtë e investimit me interes ose instrumentë të tjerë derivativë, që kombinojnë një opion të shkruar me një opion blerjeje nuk kualifikohen si instrument mbrojtës në qoftë se është, në fakt, një opion i shkruar neto (për të cilin merret një prim neto). Në mënyrë të ngjashme, dy ose më tepër instrumenta (ose proporcione të tyre) mund të përcaktohen si instrumenta mbrojtës vetëm në qoftë se asnjë prej tyre nuk është një opion i shkruar ose një opion i shkruar neto.

Zërat e mbrojtur

Kualifikimi i zërave

- 78 Një zë i mbrojtur mund të jetë një aktiv ose pasiv i njohur, një angazhim i përcaktuar i panjohur, një transaksion parashikues me probabilitet të lartë ose një investim neto në një njësi ekonomike të huaj. Zëri i mbrojtur mund të jetë (a) një aktiv i vetëm, një pasiv, një angazhim i përcaktuar, një transaksion parashikues me probabilitet të lartë ose një investim neto në një njësi ekonomike të huaj, (b) një grup aktivesh, pasivesh, angazhimesh të përcaktuara, transaksionesh parashikuese me probabilitet të lartë ose investimesh neto në njësi ekonomike të huaja, me karakteristika të njëjta rreziku ose (c) në një portofol mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, vetëm një pjesë e portofolit të aktiveve financiare ose pasiveve financiare që ndajnë rrezikun nga i cili janë të mbrojtur.
- 79 Ndryshe nga huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, një investim i mbajtur deri në maturim nuk mund të jetë një zë i mbrojtur në lidhje me rrezikun e normës së interesit ose rrezikut të parapagimit, sepse përcaktimi i një investimi të mbajtur deri në maturim kërkon që njësi ekonomike të ketë synimin për ta mbajtur këtë investim deri në maturim, pavarësisht nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të një investimi të tillë, drejtpërdrejt të lidhura me ndryshimet në normat e interesit. Megjithatë, një investim i mbajtur deri në maturim mund të jetë një zë i mbrojtur në lidhje me rreziqet nga ndryshimet në kurset e këmbimit dhe rrezikut të kredisë.
- 80 Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm aktivet, pasivet, angazhimet e përcaktuara ose transaksionet parashikuese me probabilitet të lartë, që përfshijnë një palë të jashtme në lidhje me njësinë ekonomike, mund të përcaktohen si zëra të mbrojtur. Në vijim të kësaj, kontabiliteti mbrojtës mund të zbatohet për transaksionet midis njësisve ekonomike ose segmenteve në të njëjtin grup, vetëm në pasqyrat financiare individuale ose të veçanta të këtyre njësisve ose segmenteve dhe jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit. Bën përjashtim,

një zë monetar brenda grupit (p.sh. një llogari e pagueshme/llogari e arkëtueshme midis dy filialeve) që mund të kualifikohet në pasqyrat financiare të konsoliduara si një zë i mbrojtur nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj, në qoftë se do të kemi një ekspozim ndaj këtij rreziku të fitimeve ose humbjeve neto, që nuk eliminohen plotësisht gjatë konsolidimit në përputhje me SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja*. Në përputhje me SNK 21, fitimet ose humbjet neto nga kursi i këmbimit në monedhë të huaj në zërat monetarë brenda grupit nuk eliminohen plotësisht në konsolidim, kur zëri monetar brenda grupit përdoret në transaksion midis dy njësisë ekonomike në grup që kanë monedha funksionale të ndryshme. Përveç kësaj, një transaksion parashikues me probabilitet të lartë, brenda grupit, mund të kualifikohet si një zë i mbrojtur nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj, në pasqyrat financiare të konsoliduara, me kusht që transaksioni është i shprehur në një monedhë tjetër të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike që hyn në këtë transaksion dhe rreziku i këmbimit në monedhë të huaj do të ndikojë në fitimin ose humbjen e konsoliduar.

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur

- 81 Në qoftë se një zë i mbrojtur është një aktiv financiar ose pasiv financiar, ai mund të jetë një zë i mbrojtur ndaj rreziqeve, i shoqëruar vetëm me një pjesë të flukseve të mjeteve monetare ose vlerën e drejtë (të tillë si një ose më tepër flukse të mjeteve monetare kontraktuale të përzgjedhura ose pjesë të tyre, ose një përqindje e vlerës së drejtë) me kusht që mund të matet efektiviteti. Për shembull, një pjesë e identifikueshme dhe e matshme në mënyrë të veçantë e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit të një aktivi që mbart interes ose pasivi që mbart interes mund të përcaktohet si një rrezik i mbrojtur (i tillë si elementi i normës së interesit pa rrezik ose normës së interesit bazë në ekspozimin total ndaj rrezikut të normës së interesit të një instrumenti financiar të mbrojtur).
- 81A Në mbrojtjen me vlerën e drejtë nga ekspozimi ndaj normës së interesit të një portofoli aktivesh financiare ose pasivesh financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), pjesa e mbrojtur mund të përcaktohet në termat e vlerës së një monedhe (p.sh. në vlerën e dollarit, euros, paund ose rand) sesa si aktiv individual (ose pasiv). Ndonëse portofoli mundet, për qëllime të drejtimit të rrezikut, të përfshijë aktive dhe pasive, vlera e përcaktuar është vlera e aktiveve ose e pasiveve. Përcaktimi i vlerës neto duke përfshirë aktivet dhe pasivet nuk lejohet. Njësia ekonomike mund të mbrojtë një pjesë të rrezikut të normës së interesit shoqëruar me këtë vlerë të përcaktuar. Për shembull, në rastin e mbrojtjes së një portofoli që përmban aktive të parapagueshme, njësia ekonomike mund të mbrojtë ndryshimin në vlerën e drejtë, që është i lidhur drejtpërdrejt me një ndryshim në normën e interesit të mbrojtur, në bazë të të dhënave të pritshme të rivlerësimit, sesa në ato kontraktuale. Kur pjesa e mbrojtur bazohet në të dhënat e pritshme të rivlerësimit, efekti që kanë ndryshimet e normës së interesit të mbrojtur në këto të dhëna do të përfshihet kur të përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur. Rrjedhimisht, në qoftë se një portofol që përmban zëra të parapagueshëm është i mbrojtur me një derivativ jo të parapagueshëm, nuk do të jetë aspak efektive rishikimi i të dhënave mbi bazën e të cilave pritet të parapaguhet zërat në portofolin e mbrojtur, ose kur të dhënat aktuale të parapagesës ndryshojnë nga ato të pritshme.

Përcaktimi i zërave jofinanciarë si zëra të mbrojtur

- 82 Në qoftë se zëri i mbrojtur është një aktiv jofinanciar ose pasiv jofinanciar, do të përcaktohet si një zë i mbrojtur (a) nga rreziqet e këmbimit në monedhë të huaj, ose (b) në tërësinë e tij nga të gjithë rreziqet për shkak të vështirësisë së izolimit dhe të matjes së proporcionit të përshtatshëm të ndryshimeve të flukseve të mjeteve monetare ose vlerës së drejtë të lidhura drejtpërdrejt me rreziqet specifike se sa me rreziqet e këmbimit në monedhë të huaj.

Përcaktimi i grupit të zërave si zëra të mbrojtur

- 83 Aktive të ngjashme ose pasive të ngjashme do të totalizohen dhe do të mbrohen si një grup vetëm në qoftë se aktivet individuale ose pasivet individuale të grupit ndajnë së bashku ekspozimin ndaj rrezikut që është përcaktuar për të qenë i mbrojtur. Për më tepër, ndryshimi në vlerën e drejtë i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur për çdo zë individual në grup pritet të jetë përafërsisht proporcional me ndryshimin e përgjithshëm në vlerën e drejtë, i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur të grupit të zërave.
- 84 Për shkak se një njësi ekonomike e vlerëson efektivitetin mbrojtës duke krahasuar ndryshimin në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të një instrumenti mbrojtës (ose grup instrumentash mbrojtës të ngjashëm) dhe një zëri të mbrojtur (ose grup zërash të mbrojtur të ngjashëm), atëherë krahasimi i një instrumenti mbrojtës me një gjendje neto të përgjithshme (p.sh. gjendja neto e të gjithë aktiveve me normë të fiksuar dhe pasivet me normë të fiksuar me afate maturimi të ngjashme), sesa me një zë të mbrojtur specifik, nuk kualifikohet për kontabilitet mbrojtës.

Kontabiliteti mbrojtës

- 85 Kontabiliteti mbrojtës njihet kompensimin e ndikimeve në fitim ose humbje të ndryshimeve në vlerat e drejta të instrumentit mbrojtës dhe zërit të mbrojtur.
- 86 **Marrëdhëniet mbrojtëse janë tre llojesh:**
- (a) *mbrojta me vlerën e drejtë*: një mbrojtje nga ekspozimi ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi ose pasivi të njohur, ose një angazhimi të përcaktuar të panjohur, ose një pjesë të identifikuar të një aktivi, pasivi ose angazhimi të përcaktuar, që është drejtpërdrejt e lidhur me një rrezik të veçantë dhe mund të ndikojë në fitim ose humbje.
 - (b) *mbrojta e fluksit të mjeteve monetare* një mbrojtje ndaj ekspozimit të ndryshueshmërisë në flukset e mjeteve monetare, që është e lidhur drejtpërdrejt me një rrezik të veçantë i shoqëruar me një aktiv të njohur ose pasiv të njohur (të tillë si të gjitha ose disa pagesa interesi në periudhën e ardhshme për borxhe me norma të ndryshueshme) ose një transaksion parashikues mjaft probabël dhe (ii) mund të ndikojë në fitim ose humbje.
 - (c) *mbrojtja e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj* sipas përkufizimit të bërë në SNK 21.
- 87 Mbrojtja nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj e një angazhimi të përcaktuar mund të trajtohet si një mbrojtje me vlerën e drejtë ose si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.
- 88 Një marrëdhënie mbrojtjeje kualifikohet për kontabilitet mbrojtës sipas paragrafeve 89–102 nëse dhe vetëm nëse, plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme.
- (a) Në fillimin e mbrojtjes bëhet përcaktimi formal dhe dokumentimi i marrëdhënies mbrojtëse, i objektivitetit të drejtimit të rrezikut nga njësi ekonomike dhe i strategjisë për ndërmarrjen e mbrojtjes. Dokumentimi do të përfshijë identifikimin e instrumentit mbrojtës, zërin ose transaksionin e mbrojtur, natyrën e rrezikut për të cilin bëhet mbrojtja dhe mënyrën se si njësi do të vlerësojë efektivitetin e instrumentit mbrojtës në kompensimin e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur ose flukset e mjeteve monetare të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur.
 - (b) *Mbrojtja pritjet* të jetë mjaft efektive (shih paragrafet AG105–AG113 në shtojcën A), kur kompensimi i ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare, që lidhen drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, arrihet në përputhje me strategjinë e drejtimit të rrezikut e dokumentuar qysh në fillim për këtë marrëdhënie mbrojtëse të veçantë.
 - (c) Për mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare, një transaksion parashikues që është subjekt i mbrojtjes mund të jetë mjaft probabël dhe mund të paraqitet i ekspozuar ndaj luhatjeve në flukset e mjeteve monetare që mund të ndikojnë në fund të fundit në fitim ose në humbje.
 - (d) Efektiviteti i mbrojtjes mund të matet në mënyrë të besueshme, d.m.th. vlera e drejtë ose fluksi i mjeteve monetare të zërit të mbrojtur që janë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur dhe vlera e drejtë e instrumentit mbrojtës mund të matet në mënyrë të besueshme (shih paragrafet 46 dhe 47 dhe paragrafet AG80 dhe AG81 në shtojcën A për udhëzimin mbi përcaktimin e vlerës së drejtë).
 - (e) Mbrojtja vlerësohet mbi bazën e vijueshmërisë dhe përcaktohet aktualisht nëse ka qenë mjaft efektive për tërë periudhat e raportimit financiar për të cilat është përcaktuar mbrojtja.

Mbrojtja me vlerën e drejtë

- 89 Në qoftë se gjatë periudhës, mbrojtja me vlerën e drejtë plotëson kushtet e parashtruara në paragrafin 88, do kontabilizohet si më poshtë:
- (a) fitimi ose humbja neto nga rimatja e instrumentit mbrojtës me vlerë të drejtë (për një instrument mbrojtës derivativ) ose të elementit të monedhës së huaj me vlerën e tij kontabël të matur në përputhje me SNK 21 (për një instrument mbrojtës joderivativ) do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes; dhe
 - (b) fitimi ose humbja neto nga zëri i mbrojtur i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur do të rregullojë vlerën kontabël të zërit të mbrojtur dhe do të njihet në fitim ose humbje. Kjo zbatohet në qoftë se zëri i mbrojtur është matur me kosto. Njohja fillestare e një fitimi ose humbjeje neto, të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur në pasqyrën e fitimit, bëhet në qoftë se zëri i mbrojtur është një aktiv financiar i vlefshëm për shitje.

89A Për mbrojtjen me vlerën e drejtë ndaj ekspozimit të rrezikut të normës së interesit, të një pjese të portofolit të aktiveve financiare ose pasiveve financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), kërkesa në paragrafin 89(b) mund të plotësohet duke paraqitur fitimin ose humbjen neto të lidhur drejtpërdrejt me zërin e mbrojtur ose:

- (a) në një zë të veçantë brenda aktiveve, për ato periudh kohe rivlerësimi për të cilat zëri i mbrojtur është një aktiv; ose
- (b) në një zë të veçantë brenda pasiveve, për ato periudha kohe rivlerësimi për të cilat zëri i mbrojtur është një pasiv;

Rreshti i veçantë i zërave që përmendet më sipër në pikat (a) dhe (b) do të jetë pranë aktiveve financiare ose pasiveve financiare. Vlerat e paraqitura në këtë rresht do të hiqen nga bilanci kur aktivet ose pasivet me të cilat lidhen nuk do të njihen më.

90 Në qoftë se janë të mbrojtura vetëm rreziqet e veçanta të lidhura drejtpërdrejt me një zë të mbrojtur, atëhere ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur, të palidhura me rrezikun e mbrojtur, njihen sipas përshkrimit të bërë në paragrafin 55.

91 Një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 89 në qoftë se:

- (a) **instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, i mbaron afati ose arrin përdorimin e plotë (për këtë qëllim, zëvendësimi ose ricikimi i instrumentit mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo mbarim afati në qoftë se një gjë e tillë është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar të njësisë ekonomike);**
- (b) **mbrojtja nuk plotëson më kriterin për kontabilitetin mbrojtës të përshkruar në paragrafin 88; ose**
- (c) **njësia ekonomike prapëson përcaktimin.**

92 Çdo rregullim që bëhet nga zbatimi i paragrafit 89(b) në vlerën kontabël të aktivitetit financiar të mbrojtur, për të cilin përdoret metoda e interesit efektiv (ose, në rastin e një portofoli mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, për zërat e veçantë të bilancit të përshkruara në paragrafin 89A) do të amortizohet në fitim ose humbje. Amortizimi mund të fillojë sa më shpejt që rregullimi të bëhet dhe nuk fillon më vonë se momenti që zëri i mbrojtur pushon së rregulluari për ndryshimet në vlerën e drejtë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur. Rregullimi bazohet në normën e interesit efektiv të rillozuar në datën kur fillon amortizimi. Megjithatë, në qoftë se, në rastin e mbrojtjes me vlerën e drejtë nga ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit të një portofoli të aktiveve financiare ose pasiveve financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), nuk është e mundur të zbatohet amortizimi duke përdorur normën e interesit efektiv të rillozuar, atëhere rregullimi do të amortizohet duke përdorur metodën lineare. Rregullimi do të amortizohet plotësisht gjatë maturitetit të instrumentit financiar ose në rastin e një portofoli mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, gjatë skadencës së periudhës përkatëse të rivlerësimit.

93 Kur një angazhim i përcaktuar i panjohur është përcaktuar si një zë i mbrojtur, ndryshimi i mëpasshëm kumulativ në vlerën e drejtë të këtij angazhimi të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, njihet si një aktiv ose pasiv dhe bashkë me të edhe fitimi ose humbja neto në pasqyrën e fitimit (shih paragrafin 89(b)). Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës gjithashtu njihen në fitim ose humbje.

94 Kur një njësi ekonomike hyn në një angazhim të përcaktuar për të blerë një aktiv ose për të marrë përsipër një pasiv, që është një zë i mbrojtur nga mbrojtja me vlerën e drejtë, vlera kontabël fillestare e aktivitetit ose e pasivit që është rezultat i plotësimit të këtij angazhimi rregullohet për të përfshirë ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të angazhimit të përcaktuar, të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, që është njohur në bilanc.

Mbrojtja e fluksit të mjeteve monetare

95 Në qoftë se, gjatë periudhës, mbrojtja e vlerës së drejtë plotëson kushtet e parashtruara në paragrafin 88, do kontabilizohet si më poshtë:

- (a) **pjesa e fitimit ose humbjes neto nga instrumenti mbrojtës, në rastin e një mbrojtjeje efektive (shih paragrafin 88), do të njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto nëpërmjet pasqyrës së ndryshimeve në kapital (shih SNK 1); dhe**
- (b) **pjesa joefektive e fitimit ose humbjes neto nga një instrument mbrojtës pasqyrën e fitimit.**

96 Në mënyrë më specifike, një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare kontabilizohet si më poshtë:

- (a) elementi i veçantë i kapitalit neto i lidhur me zërin e mbrojtur rregullohet për vlerën më të vogël të mëposhtme (në vlerë absolute):
 - (i) fitimi ose humbja neto kumulative nga instrumenti mbrojtës që nga fillimi i mbrojtjes; dhe

- (ii) ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë (vlerën aktuale) të flukseve të mjeteve monetare të pritshme nga zëri i mbrojtur që nga fillimi i mbrojtjes;
- (b) çdo fitim ose humbje neto e mbetur nga instrumenti mbrojtës ose elementi i përcaktuar i tij (që nuk është një mbrojtje efektive) njihet në pasqyrën e fitimit; dhe dhe
- (c) në qoftë se një strategji e dokumentuar e drejtimit të rrezikut për një marrëdhënie mbrojtjeje të veçantë përjashton nga vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes një element specifik të fitimit ose humbjes neto ose të lidhur me flukset e mjeteve monetare nga instrumenti mbrojtës (shih paragrafet 74, 75 dhe 88(a)), atëhere elementi i përjashtuar i fitimit ose humbjes neto njihet në përputhje me paragrafin 55.
- 97** Në qoftë se një transaksion parashikues çon në njohjen e mëpasshme të një aktivi ose një pasivi financiar, fitimi ose humbja neto e lidhur me të, që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto në përputhje me paragrafin 95, do të rriklassifikohet në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave aktivi i blerë ose pasivi i ndërmarrë ndikon në fitim ose humbje (siç është në periudhat që të ardhurat ose shpenzimet e interesit janë njohur). Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike parashikon që e gjithë ose një pjesë e humbjes së njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto nuk do të mbulohej në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo do ta rriklassifikojë në fitim ose humbje shumë të mbulohet.
- 98** Në qoftë se një mbrojtje e një transaksioni parashikues çon më pas në njohjen fillestare të një aktivi jofinanciar ose pasivi jofinanciar, ose një transaksion parashikues për një aktiv jofinanciar ose pasiv jofinanciar bëhet një angazhim i përcaktuar për të cilin zbatohet kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë, atëhere njësia ekonomike do të zbatohet pikën (a) ose (b) të mëposhtme:
- (a) Riklasifikon fitimet dhe humbjet neto të lidhura, që janë njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto në përputhje me paragrafin 95, në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave aktivi i blerë ose pasivi i ndërmarrë ndikon në fitim ose humbje (si në periudhat që njihen shpenzimet e amortizimit ose kostoja e shitjes). Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike parashikon që e gjithë ose një pjesë e humbjes së njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto nuk do të mbulohej në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo do ta rriklassifikojë në fitim ose humbje shumë të mbulohet.
- (b) I mbart fitimet dhe humbjet neto të lidhura që ishin njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto në përputhje me paragrafin 95, dhe i përfshin ato në koston fillestare ose në vlerën tjetër kontabël të aktivit ose pasivit.
- 99** Një njësi ekonomike do të zbatohet ose pikën (a) ose pikën (b) të paragrafit 98 si politikën e saj kontabël dhe do ta zbatohet atë në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha mbrojtjet që lidhen me këtë paragraf.
- 100** Për mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare me përjashtim të asaj që trajtohet nga paragrafet 97 dhe 98, shumat që janë njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto do të njihen në pasqyrën e fitimit në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave transaksioni parashikues i mbrojtur prek fitimin ose humbjen (për shembull, kur ndodh një shitje e parashikuar).
- 101** Në një nga rrethanat e mëposhtme, një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafet 95–100:
- (a) Instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, i mbaron afati ose arrin përdorimin e plotë (për këtë qëllim, zëvendësimi ose ricikimi i instrumentit mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo mbarim afati në qoftë se një gjë e tillë është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar të njësisë ekonomike). Në këtë rast, fitimi ose humbja kumulative nga instrumenti mbrojtës, që vazhdon të njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të vazhdojë të njihet në mënyrë të veçantë në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues. Kur ndodh transaksioni zbatohen paragrafet 97, 98 ose 100.
- (b) Mbrojtja nuk plotëson më kriterin për kontabilitetin mbrojtës sipas paragrafit 88. Në këtë rast, fitimi ose humbja kumulative nga instrumenti mbrojtës, që vazhdon të njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të vazhdojë të njihet në mënyrë të veçantë në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues. Kur ndodh transaksioni zbatohen paragrafet 97, 98 ose 100.
- (c) Transaksioni parashikues nuk pritët më të ndodhë, rast në të cilin çdo fitim ose humbje kumulative e lidhur me instrumentin mbrojtës, që vazhdon të njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të njihet në fitim ose humbje. Një transaksion parashikues që nuk është më mjaft probabël (shih paragrafin 88(c)), mund të pritët akoma që të ndodhë.
- (d) Njësia ekonomike prapëson përcaktimin. Për mbrojtjen e një transaksioni parashikues, fitimi ose humbja kumulative nga instrumenti mbrojtës, që vazhdon të njihet drejtpërdrejt në kapitalin

neto që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95(a)), do të vazhdojë të njihet në mënyrë të veçantë në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues ose që nuk pritet më të ndodhë. Kur ndodh transaksioni zbatohen paragrafet 97, 98 ose 100. Në qoftë se një transaksion nuk pritet më të ndodhë, fitimi ose humbja neto kumulative që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto do të njihet në pasqyrën e fitimit.

Mbrojtja e investimit neto

102 Mbrojtja e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj, duke përfshirë mbrojtjen e një zëri monetar që është kontabilizuar si një pjesë e investimit neto (shih SNK 21), do të kontabilizohet në mënyrë të ngjashme me mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare:

(a) pjesa e fitimit ose humbjes neto nga instrumenti mbrojtës, në rastin e një mbrojtjeje efektive (shih paragrafin 88), do të njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto nëpërmjet pasqyrës së ndryshimeve në kapital (shih SNK 1); dhe

(b) pjesa joefektive do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Fitimi ose humbja neto nga instrumenti mbrojtës, në lidhje me pjesën efektive të mbrojtjes, që është njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto do të njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes me likuidimin e njësisë ekonomike të huaj.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

103 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë standard (duke përfshirë dhe ndryshimet e bëra në mars 2004) në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2005. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Një njësi ekonomike nuk do të zbatojë këtë standard (duke përfshirë dhe ndryshimet e bëra në mars 2004) për periudhat kontabël të cilat fillojnë përpara 1 janarit 2005, edhe nëse ajo zbaton SNK 32 (të publikuar në dhjetor 2003). Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

103A Një njësi ekonomike do të zbatojë amendimin e bërë në paragrafin 2(j) për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2006. Në qoftë se një njësi ekonomike zbaton KIRFN 5 *Të drejtat për interesat që rrjedhin nga fondet e nxjerrjes jashtë përdorimit, restaurimi dhe rehabilitimi mjedisor* për një periudhë më të hershme, ky amendim do të zbatohet për këtë periudhë më të hershme.

103B *Kontratat e garanciaë financiare* (ndryshimet e bëra për SNK 39 dhe SNRF 4), e publikuar në gusht të vitit 2005, ka amenduar paragrafet 2(e) dhe (h), 4, 47 dhe AG4, dhe ka shtuar paragrafin AG4A, ka shtuar përkufizimin e ri të kontratave të garancisë financiare në paragrafin 9, dhe ka hequr paragrafin 3. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2006. Inkurajohet zbatimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime në një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë në të njëjtën ndryshimet e lidhura me SNK 32* dhe SNRF 4.

104 Ky standard do të zbatohet në mënyrë retrospektive me përjashtim të asaj që është specifikuar në paragrafet 105–108. Teprica e çeljes e fitimeve të pashpërndara për periudhën më të hershme të mëparshme dhe të gjitha shumat krahasuese do të rregullohen sikur ky standard të kishte qenë gjithmonë në zbatim, me përjashtim të rastit kur rivlerësimi i informacionit do të ishte i pamundur. Në qoftë se rivlerësimi është i pamundur, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues sipas shkallës së rivlerësimit të tij.

105 Kur ky standard zbatohet për herë të parë, njësia ekonomike lejohet të përcaktojë një aktiv të njohur më parë si të vlefshëm për shitje. Për një aktiv financiar të tillë, njësia ekonomike do të njohë të gjitha ndryshimet kumulative në vlerën e drejtë si një element i veçantë i kapitalit neto deri në mosnjohjen e mëpasshme ose zhvlerësim, kur njësia do të transferojë fitimin ose humbjen kumulative në pasqyrën e fitimit. Njësia ekonomike gjithashtu do të:

(a) rivlerësojë aktivin financiar duke bërë një përcaktim të ri në pasqyrat financiare krahasuese; dhe

* Kur një njësi ekonomike zbaton SNRF 7, referenca në SNK 32 është zëvendësuar nga referenca në SNRF 7.

- (b) japë informacion shpjegues për aktivet financiare në datën e përcaktimit, për klasifikimin e tyre dhe vlerën kontabël në pasqyrat financiare të mëparshme.
- 105A Një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafet 11A, 48A, AG4B–AG4K, AG33A dhe AG33B dhe ndryshimet e bëra në vitin 2005 në paragrafet 9, 12 dhe 13 për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2006. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm.
- 105B Një njësi ekonomike që zbaton për herë të parë paragrafet 11A, 48A, AG4B–AG4K, AG33A dhe AG33B dhe ndryshimet e bëra në vitin 2005 në paragrafet 9, 12 dhe 13 për periudhën vjetore që fillon përpara 1 janarit 2006.
- (a) lejohet, kur këto paragrafe të reja dhe të amenduara zbatohen për herë të parë, të përcaktohet si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes çdo aktiv financiar ose pasiv financiar i njohur në periudhat e mëparshme që pastaj kualifikohet për një përcaktim të tillë. Kur periudha vjetore fillon më 1 shtator 2005, të tilla përcaktime nuk kërkohet të përfundohen deri më 1 shtator 2005 dhe mund të përfshijnë gjithashtu aktivet financiare dhe pasivet financiare të njohura midis fillimit të kësaj periudhe vjetore dhe 1 shtatorit 2005. Pavarësisht nga paragrafi 91, aktivet financiare dhe pasivet financiare të përcaktuara si instrumenta financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me këtë nënpragaf, që paraprakisht kanë qenë të përcaktuar si zëra mbrojtës në marrëdhëniet e kontabilitetit mbrojtës me vlerë të drejtë do të shkëputen nga këto marrëdhënie në të njëjtën kohë që ata përcaktohen si instrumenta me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- (b) do të japë informacion shpjegues për çdo aktiv financiar ose pasiv financiar të përcaktuar në përputhje me nënparagrafin (a) për datën e përcaktimit, klasifikimin e tyre dhe vlerën kontabël në pasqyrat financiare të mëparshme.
- (c) do ta përjashtojë nga përcaktimi çdo aktiv financiar ose pasiv financiar të përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në periudhat e mëparshme, në qoftë se ai nuk kualifikohet për një përcaktim të tillë në përputhje me këto paragrafe të reja dhe të amenduara. Kur një aktiv financiar ose pasiv financiar do të matet me koston e amortizuar pas përjashtimit nga përcaktimi, data e këtij përjashtimi kërkohet të njihet si data e njohjes fillestare të tij.
- (d) do të japë informacion shpjegues për vlerën e drejtë të çdo aktivi financiar ose pasivi financiar që plotëson kërkesat e nënparagrafit (c) në datën e heqjes nga përcaktimi dhe klasifikimin e tyre të ri.
- 105C Një njësi ekonomike që do të zbatojë për herë të parë paragrafet 11A, 48A, AG4B–AG4K, AG33A dhe AG33B dhe ndryshimet e bëra në vitin 2005 në paragrafet 9, 12 dhe 13 në periudhën vjetore që fillon më ose pas 1 janarit 2006
- (a) do të përjashtojë nga përcaktimi çdo aktiv financiar dhe pasiv financiar të njohur në periudhat e mëparshme si instrumenta financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vetëm në qoftë se ai nuk kualifikohet për një përcaktim të tillë në përputhje me këto paragrafe të reja dhe të amenduara. Kur një aktiv financiar ose pasiv financiar do të matet me koston e amortizuar pas këtij përjashtimi, data e përjashtimit kërkohet të njihet si data e njohjes fillestare.
- (b) nuk do të përcaktohet si instrument financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes çdo aktiv financiar ose pasiv financiar i njohur në periudhat e mëparshme.
- (c) do të japë informacion shpjegues për çdo aktiv financiar ose pasiv financiar të përjashtuar nga përcaktimi në përputhje me nënparagrafin (a) për datën e përjashtimit nga përcaktimi dhe për klasifikimin e tyre të ri.
- 105D Një njësi ekonomike do të rivlerësojë pasqyrat financiare të krahasueshme duke përdorur përcaktimin e ri të përshkruar në paragrafin 105B ose 105C me kusht që, në rastin e një aktivi financiar, pasivi financiar, ose grup aktivesh financiare, pasivesh financiare ose të dyja së bashku, të përcaktuar si instrumenta financiarë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, këto zëra ose grupe duhet të plotësojnë kriterin në paragrafin 9(b)(i), 9(b)(ii) ose 11A në fillim të periudhës krahasuese ose, në qoftë se është përfunduar pas fillimit të periudhës krahasuese, duhet të plotësojë kriterin në paragrafin 9(b)(i), 9(b)(ii) ose 11A në datën e njohjes fillestare.
- 106 Duke bërë përjashtim nga sa lejohet në paragrafin 107, një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e mosnjohjes në paragrafet 15–37 dhe paragrafet AG36–AG52 të shtojcës A në mënyrë prospektive. Në lidhje me këtë, në qoftë se një njësi ekonomike nuk i ka më të njohura aktivet financiare sipas SNK 39 (rishikuar në vitin 2000) si rezultat i një transaksioni që ka ndodhur përpara 1 janarit 2004 dhe këto aktive nuk duhet të njiheshin edhe sipas këtij standardi, atëherë ajo nuk do t'i njohë këto aktive.
- 107 Pavarësisht nga sa thuhet në paragrafin 106, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat e mosnjohjes në paragrafet 15–37 dhe paragrafet AG36–AG52 të shtojcës A në mënyrë retrospektive nga data që njësi

ekonomike ka zgjedhur, me kusht që informacioni i kërkuar në zbatim të SNK 39 për aktivet financiare dhe pasivet e panjohura si rezultat i transaksioneve të kaluara të jetë përftuar në momentin e kontabilizimit fillestar të këtyre transaksioneve.

- 107A Pavarësisht nga sa thuhet në paragrafin 104, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat në frazën e fundit të paragrafit AG76, dhe paragrafit AG76A, në një nga mënyrat e mëposhtme:
- (a) në mënyrë prospektive për transaksionet e regjistruara pas 25 tetorit 2002; ose
 - (b) në mënyrë prospektive për transaksionet e regjistruara pas 1 janarit 2004;
- 108 Një njësi ekonomike nuk do të rregullojë vlerën kontabël të aktiveve jofinanciare dhe pasiveve jofinanciare për të përjashtuar fitimet dhe humbjet e lidhura me mbrojtjen e flukseve të mjeteve monetare që ka qenë të përfshira në vlerën kontabël para fillimit të vitit financiar në të cilin ky standard është zbatuar për herë të parë. Në fillim të periudhës financiare, në të cilën ky standard është zbatuar për herë të parë, çdo vlerë e njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto për mbrojtje të një anagazhimi të përcaktuar, që sipas këtij standardi kontabilizohet si një mbrojtje me vlerën e drejtë, do të riklasifikohet si një aktiv ose pasiv, me përjashtim të mbrojtjes nga rreziku i kursit të këmbimit në monedhës të huaj që vazhdon të trajtohet si mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.**
- 108A Një njësi ekonomike do të zbatojë frazën e fundit të paragrafit 80, paragrafeve AG99A dhe AG99B, për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2006. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike ka përcaktuar si një zë të mbrojtur një transaksion parashikues të jashtëm që
- (a) është i shprehur në monedhën funksionale të njësisë ekonomike që ka hyrë në transaksion,
 - (b) çon në një ekspozim që do të ketë një ndikim në fitimin ose humbjen e konsoliduar (d.m.th. është shprehur në një monedhë tjetër nga ajo e monedhës së paraqitjes së grupit),
 - (c) për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës nuk është shprehur në monedhën funksionale të njësisë ekonomike që ka hyrë në të,
- mund të zbatohet kontabiliteti mbrojtës në pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën (periudhat) para datës së zbatimit të frazës së fundit të paragrafit 80, paragrafeve AG99A dhe AG99B.
- 108B Një njësi ekonomike kërkohet të mos zbatojë paragrafin AG99B për informacionin krahasues në lidhje me periudhat përpara datës së zbatimit të frazës së fundit të paragrafit 80 dhe paragrafit AG99A.

Tërheqja e deklarimeve të tjera

- 109 Ky standard zëvendëson SNK 39 *Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja* që është rishikuar në tetor 2000.
- 110 Ky standard dhe udhëzuesi i zbatimit që e shoqëron zëvendëson udhëzuesin për zbatim të publikuar nga Komiteti i udhëzuesit për zbatim të SNK 39, të krijuar nga KSNK i mëparshëm.

Shtojcë A

Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë e pandarë e këtij standardi.

Objekti (paragrafet 2–7)

- AG1 Disa kontrata kërkojnë që pagesa të bëhet bazuar në variabla klimatike, gjeologjike ose variabla të tjerë fizikë. (Ato kontrata që bazohen në variabla klimatike shpeshherë quhen si ‘instrumente derivativë që mbulojnë rreziqet e lidhura me motin’.) Në qoftë se këto kontrata nuk janë objekt i SNRF 4, atëhere ato janë objekt i këtij standardi.
- AG2 Ky standard nuk ndryshon kërkesat në lidhje me skemat e përfitimeve të punonjësve në përputhje me SNK 26 *Kontabiliteti dhe Raportimi për Skemat e Përfitimit të Pensioneve* dhe marrëveshjet për pagesë për përdorimin e pronës bazuar në vëllimin e shitjeve ose të ardhurave nga shërbimet që janë trajtuar sipas SNK 18.
- AG3 Nganjëherë, një njësi ekonomike bën atë çfarë ajo e quan si një ‘investim strategjik’ në instrument kapitali neto të emetuar nga një njësi ekonomike tjetër, me synimin për të krijuar ose mbajtur një marrëdhënie operative afatgjatë me një njësi ekonomike në të cilën është bërë investimi. Njësia ekonomike investitore përdor SNK 28 për të përcaktuar nëse metoda kontabël e kapitalit neto është e përshtatshme për këtë investim. Në mënyrë të ngjashme, njësia ekonomike investitore përdor SNK 31 për të përcaktuar nëse konsolidimi proporcional ose metoda e kapitalit neto është e përshtatshme për këtë lloj investimi. Në qoftë se as metoda e kapitalit neto, as ajo e konsolidimit proporcional nuk është e përshtatshme, njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për investimin strategjik.
- AG3A Ky standard zbatohet për aktivet financiare dhe pasivet financiare të shoqërive të sigurimit, përveç të drejtave dhe detyrimeve që përjashtohen nga paragrafi 2(e), sepse ato lindin nga kontrata që janë objekt i SNRF 4.
- AG4 Kontratat e garancisë financiare mund të jenë të formave të ndryshme ligjore, të tilla si garanci, disa lloj letrash kredie, kontratë për shtyrje kredie ose kontratë sigurimi. Trajtimi i tyre kontabël nuk varet nga forma e tyre ligjore. Në vijim jepen shembuj të trajtimit përkatës (shih paragrafi 2(e)):
- (a) Ndonëse një kontratë e garancisë financiare plotëson përkufizimin e një kontrate sigurimi sipas SNRF 4, nëse rreziku i transferuar është i rëndësishëm, emetuesi do të zbatojë këtë standard. Gjithsesi, në qoftë se emetuesi ka pohuar paraprakisht, në mënyrë të qartë, se ai i konsideron këto kontrata si kontrata sigurimi dhe ka përdorur kontabilitetin e zbatueshëm për to, atëhere emetuesi mund të zgjedhë nëse duhet të zbatojë këtë standard, apo SNRF 4 për këto kontrata të garancisë financiare. Në qoftë se zbatohet ky standard, atëhere sipas paragrafit 43 kërkohet që emetuesi të njohë fillimisht kontratën e garancisë financiare me vlerën e drejtë. Kur kontrata e garancisë financiare është lidhur me një palë të palidhur në një transaksion të veçuar i kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, vlera e drejtë e saj në fillim është pak a shumë e barabartë me primin e marrë, me përjashtim kur vërtetohet e kundërta. Rrjedhimisht, nëse kontrata e garancisë financiare nuk është përcaktuar qysh në fillim si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose nëse nuk zbatohet paragrafet 29–37 dhe AG47–AG52 (kur transferimi i një aktivi nuk kualifikohet për mosnjohje ose zbatohet metoda e përfshirjes së vazhdueshme), atëhere emetuesi e mat atë me vlerën më të lartë ndërmjet:
- (i) vlerës së përcaktuar në përputhje me SNK 37; dhe
- (ii) vlerës të njohur fillimisht pakësuar, kur është e nevojshme, me amortizimin kumulativ të njohur në përputhje me SNK 18 (shih paragrafin 47(c)).
- (b) Disa garanci të lidhura me kredinë nuk kërkojnë, si një parakusht për pagesë, që mbajtësi të ekspozohet dhe të pësojë humbje nga vonesa e debitorit për të bërë në kohë pagesën për aktivin e garantuar. Si shembull për këtë lloj garancie është ajo e cila kërkon që pagesa të bëhet në përputhje me ndryshimet në klasifikimin e specifikuar të kredisë ose indeksin e kredisë. Të tilla garanci nuk janë kontrata të garancisë financiare, sikurse përkufizohet në këtë standard dhe nuk janë kontrata sigurimi, sipas përkufizimit të bërë në SNRF 4. Të tilla garanci janë derivativë dhe emetuesi zbaton këtë standard për to.
- (c) Në qoftë se një kontratë e garancisë financiare është emetuar në lidhje me shitjen e mallrave, emetuesi zbaton SNK 18 kur një të ardhurat nga garancia dhe nga shitja e mallrave.

AG4A Deklarimet e tilla që një emetues i konsideron kontratat si kontrata sigurimi, në përgjithësi, gjenden në tërë komunikimet e emetuesit me klientët dhe rregullatorët, kontratat, dokumentacionin e biznesit dhe pasqyrat financiare. Për më tepër, kontratat e sigurimit shpesh iu nënshtrohen kërkesave kontabël që dallohen nga kërkesat për llojet e tjera të transaksioneve, të tilla si kontratat e emetuara nga bankat ose shoqëritë tregtare. Në këto raste, në pasqyrën financiare të një emetuesi, në mënyrë tipike, përfshihet pohimi që emetuesi ka përdorur këto kërkesa.

Përkufizime (paragrafet 8 dhe 9)

Përcaktimi si instrument financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

AG4B Paragrafi 9 i këtij standardi lejon njësinë ekonomike të përcaktojë si një aktiv financiar, pasiv financiar, ose grup instrumentesh financiare (aktive financiare, pasive financiare ose të dy bashkë) si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, me kusht që, duke vepruar kështu të jepet informacioni i duhur.

AG4C Vendimi i një njësie ekonomike për të përcaktuar një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është i njëjtë me zgjedhjen e një politike kontabël (edhe pse zgjedhja e një politike kontabël, gjithsesi, nuk kërkohet të zbatohet vazhdimisht për të gjitha transaksionet e ngjashme). Kur një njësi ekonomike bën një zgjedhje të tillë, sipas paragrafit 14(b) i SNK 8 *Politikat kontabël, Ndryshimet në çmuarjet kontabël dhe gabimet* kërkohet që politika e zgjedhur të pasqyrohet në pasqyrat financiare duke dhënë informacionin e duhur dhe më të besueshëm mbi efektet e transaksioneve, ngjarjeve të tjera dhe kushteve mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare. Në rastin e përcaktimit të instrumentit si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, paragrafi 9 përshkruan dy rrethanat kur plotësohen kërkesat për të patur informacionin e duhur. Kështu, për të bërë një përcaktim të tillë në përputhje me paragrafin 9, njësia ekonomike duhet të tregojë se ajo ndodhet në njerën (ose në të dyja) prej këtyre rrethanave.

Paragrafi 9(b)(i): Përcaktimi eliminon ose zvogëlon në mënyrë të ndjeshme mospërputhjen e matjes ose njohjes që përndryshe do të lindte.

AG4D Sipas SNK 39, matja e një aktivi financiar ose pasivi financiar dhe klasifikimi i ndryshimeve të njohura në vlerën e tyre përcaktohen nga klasifikimi i zërit dhe nëse ky zë është pjesë e një marrëdhënie mbrojtëse të përcaktuar. Këto kërkesa mund të shkaktojnë mospërputhje në matje ose njohje (shpeshherë e quajtur si ‘kontabiliteti i mospërputhjes’) kur, për shembull, në mungesë të një përcaktimi si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, një aktiv financiar do të klasifikohet si i vlefshëm për shitje (me shumicën e ndryshimeve në vlerën e drejtë të njohura drejtpërdrejt në kapitalin neto) dhe pasivi, që njësia ekonomike e konsideron të lidhur, do të matej me koston e amortizuar (duke mos njohur ndryshimet në vlerën e drejtë). Në të tilla rrethana, një njësi ekonomike mund të arrijë në përfundimin se pasqyrat e saj financiare do të jepnin informacionin e duhur, nëse si aktivi, ashtu edhe pasivi klasifikohen si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

AG4E Shembujt e mëposhtëm tregojnë se në cilat raste plotësohet ky kusht. Në të gjitha këto raste, një njësi ekonomike duhet të përdorë këtë kusht për të përcaktuar aktivet financiare ose pasivet financiare si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vetëm nëse plotëson parimin e dhënë në paragrafin 9(b)(i).

- (a) Një njësi ekonomike njeh si pasive ato që flukset e mjeteve monetare të të cilave bazohen në mënyrë kontraktuale në performancën e aktiveve, që ndryshe mund të klasifikoheshin si të vlefshme për shitje. Për shembull, një sigures mund të ketë pasive që përmbajnë një tipar të pjesëmarrjes së lirë, që paguan interes bazuar në kthimet e investimit të realizuara/ose të përcaktuara të një bashkësie të specifikuar aktiveve të siguresit. Nëse matja e këtyre pasiveve pasqyron çmimet aktuale të tregut, klasifikimi i aktiveve si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes do të thotë që ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare njihen në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë që njihen edhe ndryshimet e lidhura me vlerën e pasiveve.
- (b) Një njësi ekonomike konsideron pasive sipas kontratave të sigurimit ato që matja e të cilave përfshin informacionin aktual (sikurse lejohet nga SNRF 4, paragrafi 24), dhe aktive financiare të lidhura konsideron ato që ndryshe do të ishin klasifikuar si të vlefshme për shitje ose të matura me koston e amortizuar.
- (c) Një njësi ekonomike ka aktive financiare, pasive financiare ose të dyja bashkë, që ndajnë në mënyrë të barabartë një rrezik, të tillë si rrezikun e normës së interesit, i cili shkakton ndryshime të kundërta në vlerën e drejtë, që synojnë të kompensojnë njera-tjetrën. Megjithatë, vetëm disa instrumente do të mateshin me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (d.m.th. janë derivativë ose klasifikohen si të mbajtur për tregtim). Gjithashtu, mund të paraqitet rasti që të mos plotësohen kërkesat për kontabilitetin

e mbrojtjes, për shembull, për shkak të mosplotësimit të kërkesave në lidhje me efektivitetin, të dhëna në paragrafin 88.

- (d) Një njësi ekonomike ka aktive financiare, pasive financiare ose të dyja bashkë, që ndajjnë në mënyrë të barabartë një rrezik, të tillë si rrezikun e normës së interesit, i cili shkakton ndryshime të kundërta në vlerën e drejtë, që synojnë të kompensojë njera-tjetrën dhe njësi ekonomike nuk i kualifikon për kontabilitetin mbrojtës për shkak se asnjë prej instrumenteve nuk është derivativ. Për më tepër, në mungesë të kontabilitetit mbrojtës, ka një mospërputhje të madhe në njohjen e fitimeve ose humbjeve neto. Për shembull:
- (i) njësi ekonomike ka financuar një portofol me aktive me normë të pandryshueshme, që ndryshe mund të klasifikoheshin si të vlefshme për shitje, dhe me obligacione me normë të pandryshueshme, ndryshimet e të cilëve në vlerën e drejtë tentojnë të kompensojnë njeri-tjetrin. Raportimi i aktiveve dhe i obligacioneve me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, korrigjon mospërputhjen që ndryshe do të lindte nga matja e aktiveve me vlerën e drejtë dhe ndryshimet e raportuara në kapitalin neto, si dhe nga matja e obligacioneve me koston e amortizuar.
- (ii) njësi ekonomike ka financuar një grup të specifikuar huash nëpërmjet emetimit të obligacioneve të tregtueshme, ndryshimet e të cilave në vlerën e drejtë tentojnë të kompensojnë njeri-tjetrin. Në qoftë se, përveç kësaj, njësi ekonomike blen dhe shet rregullisht obligacione, por rrallë, në mos asnjëherë, blen dhe shet huatë, atëherë raportimi i huave dhe i obligacioneve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes eliminon mospërputhjen në momentin e njohjes së fitimeve dhe humbjeve neto, që ndryshe do të kishte rezultuar nga matja e tyre me koston e amortizuar, dhe njohjen e fitimit ose humbjes neto sa herë që një obligacion riblihet.

AG4F Në raste të tilla, si ato të përshkuara në paragrafin e mësipërm, mospërputhja e matjes ose e njohjes mund të eliminohet ose të zvogëlohet dhe të sigurohet informacioni i duhur duke përcaktuar, në njohjen fillestare, aktivet financiare dhe pasivet financiare jo në rrugë tjetër, por veçse të matura si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për qëllime praktike, njësi ekonomike kërkon të mos regjistrojë të gjitha aktivet dhe pasivet duke shkaktuar mospërputhjen e matjes ose njohjes tamam në të njëjtën kohë. Një vonesë e arsyeshme lejohet me kusht që çdo transaksion të përcaktohet si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në njohjen e tij fillestare dhe, në të njëjtën kohë, të jetë parashikuar kryerja e transaksioneve të tjera.

AG4G Nuk do të ishte e pranueshme të përcaktohen vetëm disa aktive financiare dhe pasive financiare, që shkaktojnë mospërputhje, si instrumente me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse duke vepruar kështu nuk do të eliminohej ose të zvogëlohej ndjeshëm mospërputhja dhe si rezultat nuk do të sigurohej informacioni i duhur. Megjithatë, do të ishte e pranueshme të përcaktohen vetëm një numër aktivesh financiare të ngjashme ose pasive financiare të ngjashme, nëse duke vepruar kështu arrihet një ulje e ndjeshme (dhe mundësisht një ulje më e madhe sesa përcaktimet e tjera të lejueshme) e mospërputhjes. Për shembull, supozohet se një njësi ekonomike ka një numër pasivesh financiare të ngjashme që kapin shumën 100*NJM* dhe një numër aktivesh financiare të ngjashme që kapin shumën 50NJM, por janë të matura mbi baza të ndryshme. Njësi ekonomike mund ta ulë në mënyrë të ndjeshme mospërputhjen në matje duke përcaktuar në njohjen fillestare, të gjitha aktivet, por vetëm disa nga pasivet (për shembull, pasivet individuale me një total të kombinuar prej 45NJM) si me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Megjithatë, meqë përcaktimi si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mund të zbatohet vetëm për tërë instrumentin financiar, njësi ekonomike në këtë shembull duhet të përcaktojë një ose më shumë pasive në tërësinë e tyre. Ajo nuk mund të përcaktojë një përbërës të pasivit (p.sh. ndryshimet në vlerë të lidhura drejtpërdrejt vetëm me një rrezik, i tillë si ndryshimet në interesin bazë), ose një pjesë (d.m.th. përqindje) të tij.

Paragrafi 9(b)(i): Një grup aktivesh financiare, pasivesh financiare ose të dyja bashkë drejtohet dhe performanca e tij vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë, në përputhje me strategjinë e dokumentuar të drejtimit të rrezikut ose të investimit.

AG4H Një njësi ekonomike mund të drejtojë dhe të vlerësojë performancën e një grupi aktivesh financiare, pasivesh financiare ose të dyve bashkë, në mënyrë të tillë që matja e grupit me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të sigurojë informacionin e duhur. Ky shembull fokusohet më tepër në mënyrën e drejtimit dhe të vlerësimit të performancës, sesa në natyrën e instrumenteve financiare.

AG4I Shembujt e mëposhtëm tregojnë se kur plotësohet ky kusht. Në të gjitha rastet, një njësi ekonomike duhet të përdorë këtë kusht për të përcaktuar aktivet financiare ose pasivet financiare si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vetëm në qoftë se ajo plotëson parimin në paragrafin 9(b)(ii).

* Në këtë standard, shumat monetare janë shprehur në 'Njësi monetare' (NJM)

- (a) Njësia ekonomike është një organizatë sipërmarrjeje kapitali, fond i përbashkët, njësi besimi ose njësi ekonomike e ngjashme, kur biznesi i saj është investimi në aktive financiare me qëllim përfitimi nga kthimi në total i tyre, në formën e interesit ose të dividendëve dhe nga ndryshimet në vlerën e drejtë. SNK 28 dhe SNK 31 lejon që të tilla investime të mos jenë më objekt i tyre, kur sigurohet që këto janë të matura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Një njësi ekonomike mund të zbatohet të njëjtën politikë kontabël për investimet e tjera të drejtuara në bazë të kthimit total, por kjo është e pamjaftueshme që këto investime të jenë objekt i SNK 28 ose SNK 31.
- (b) Njësia ekonomike ka aktive financiare dhe pasive financiare që ndajnë në mënyrë të barabartë një ose më shumë rreziqe dhe këto rreziqe drejtohen dhe vlerësohen mbi bazën e vlerës së drejtë në përputhje me politikën e dokumentuar të drejtimit të aktivitetit dhe të pasivit. Një shembull mund të jetë një njësi ekonomike që ka emetuar 'produkte të strukturuar', të cilat përmbajnë derivativë të përfshirë të shumëfishtë, dhe i drejton rreziqet që rezultojnë mbi bazën e vlerës së drejtë duke përdorur një kombinim të një derivativi me instrumente financiare joderivative. Një shembull i ngjashëm mund të jetë një njësi ekonomike që ka emetuar hua me normë interesi të pandryshueshme dhe drejton rrezikun që rrjedh nga norma bazë e interesit duke përdorur një kombinim instrumentesh financiare derivativë dhe joderivativë.
- (c) Njësia ekonomike është një sigures që mban një portofol aktivesh financiare, e drejton këtë portofol në mënyrë të tillë që të maksimizojë kthimin total të tij (d.m.th. interesin ose dividendët dhe ndryshimet në vlerën e drejtë), dhe vlerëson performancën e tij mbi këtë bazë. Portofoli mund të mbahet për të financuar pasive specifike, kapital neto ose të dyja. Në qoftë se portofoli mbahet për të financuar pasive specifike, kushti në paragrafin 9(b)(ii) mund të plotësohet për aktivet, pavarësisht nëse siguresi gjithashtu drejton dhe vlerëson pasivet mbi bazën e vlerës së drejtë. Kushti në paragrafin 9(b)(ii) mund të plotësohet kur objektivi i siguresit është të maksimizojë kthimin total mbi aktivet afatgjata, edhe nëse shumat e paguara mbajtësit të kontratave pjesëmarrëse varen nga faktorë të tjerë si shumat e fitimit neto të realizuar në një periudhë të shkurtër kohe (p.sh. një vit) ose i nënshtrohen gjykimit të siguresit.

AG4J Siç u përmend më sipër, ky kusht mbështetet në mënyrën se si njësia ekonomike drejton dhe vlerëson performancën e grupit të instrumenteve financiarë në shqyrtim. Kështu, (sipas kërkesës së përcaktimit në njohjen fillestare) një njësi ekonomike që i përcakton instrumentet financiarë si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, po në bazë të këtij kushti do të përcaktojë të gjithë instrumentet financiare e përshtatshëm, që drejtohen dhe vlerësohen së bashku.

AG4K Documentacioni i strategjisë së njësisë ekonomike kërkohet të mos jetë i zgjeruar, por të jetë i mjaftueshëm për të demonstruar përputhjen me paragrafin 9(b)(ii). Ky lloj dokumentacioni nuk kërkohet të jetë për çdo zë individual, por mund të jetë mbi bazë portofoli. Për shembull, në qoftë se sistemi i drejtimit të performancës për një departament —sikurse është aprovuar nga personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike —tregon në mënyrë të qartë që performanca e tij është vlerësuar mbi bazën e kthimit total, nuk kërkohet dokumentacioni i mëtejshëm për të treguar përputhjen me paragrafin 9(b)(ii).

Norma e interesit efektiv

AG5 Në disa raste, aktivet financiare përftohen kundrejt një skontoje të madhe që pasqyron humbjet e pësuar nga kredia. Njësitë ekonomike i përfshijnë këto humbje të pësuar të kredisë në flukset e mjeteve monetare të çmuara, kur llogaritet norma e interesit efektiv.

AG6 Kur zbatohet metoda e interesit efektiv, një njësi ekonomike në përgjithësi amortizon çdo tarifë, shumat të arkëtuara ose të paguara, kostot e transaksionit dhe primet apo zbritjet e përfshira në llogaritjen e normës së interesit efektiv përgjatë jetës së pritshme të instrumentit. Megjithatë, si periudhë përdoret periudha më e shkurtër e kohës të cilës i përkasin tarifa, shumat e paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksionit, primet apo skontot. Kjo do të jetë në rastin kur variabli me të cilin janë lidhur tarifa, shumat e paguara ose të arkëtuara, kostot e transaksionit, primet ose skontot përkatëse rivlerësohet me normat e tregut përpara maturimit të pritshëm të instrumentit. Në një rast të tillë, periudha e duhur e amortizimit është periudha deri në datën tjetër të rivlerësimit. Për shembull, në qoftë se primi ose skontoja mbi një instrument me një normë të luhatshme pasqyron interesin që është konstatuar qysh nga momenti i pagesës së fundit të bërë për të, ose ndryshimet në normat e tregut qysh kur norma e luhatshme e interesit është rivendosur në normat e tregut, do të amortizohet deri në datën e afërt, kur interesi i luhatshëm rivendoset në normat e tregut. Kjo për shkak se primi ose skontoja lidhen me periudhën deri në datën tjetër të rivendosjes (rregullimit) të interesit, meqë, në këtë datë, variabli me të cilin lidhet primi ose skontoja (d.m.th. norma e interesit) rivendoset në normat e tregut. Megjithatë, në qoftë se primi ose skontoja rrjedh nga një ndryshim në marzhin e kredisë mbi normën e luhatshme të specifikuar në instrument, ose në variablat e tjerë që nuk janë rregulluar sipas normave të tregut, atëherë ai ose ajo amortizohet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit.

AG7 Për aktivet financiare me normë të luhatshme dhe pasivet financiare me normë të luhatshme, rivlerësimi periodik i flukseve të mjeteve monetare për të pasqyruar lëvizjet në normat e tregut të interesit ndryshon normën e

interesit efektiv. Në qoftë se aktivi financiar me normë të luhatshme ose pasivi financiar me normë të luhatshme njihet fillimisht me një vlerë të barabartë me principalin e arkëtueshëm ose të pagueshëm në maturim, rivlerësimi i pagesave të ardhshme të interesit zakonisht nuk ka ndonjë ndikim të ndjeshëm në vlerën kontabël (neto) të aktivit ose pasivit.

- AG8 Në qoftë se një njësi ekonomike rishikon çmuarjet e saj të bëra për pagesat ose arkëtimet, atëhere ajo do të rregullojë vlerën kontabël (neto) të aktivit financiar ose të pasivit financiar (ose grup instrumentesh financiare) për të pasqyruar çmuarjet aktuale dhe të rishikuara të flukseve të mjeteve monetare. Njësia ekonomike rilloarit vlerën kontabël (neto) duke njehsuar vlerën aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme të çmuara me normën fillimore të interesit efektiv të instrumentit financiar. Rregullimet njihen si të ardhura ose shpenzime në fitim ose humbje.

Derivativët

- AG9 Shembuj tipikë të derivativëve janë kontratat e të ardhmes (futures dhe forward), swap dhe optionet. Derivativi zakonisht ka një shumë imagjinare, e cila është vlera e monedhës, një numër aksionesh, një numër njësis në peshë specifike ose vëllim, ose njësi të tjera të specifikuara në kontratë. Megjithatë, një instrument derivativ nuk kërkon që mbajtësi ose shkruesi të investojë apo të arkëtojë shumë imagjinare në fillim të kontratës. Ndryshe, një derivativ do të kërkonte një pagesë të pandryshueshme ose pagesë të një shume që mund të ndryshojë (por jo në mënyrë përpjesëtimore me ndryshimet në bazë) si rezultat i disa ngjarjeve të ardhshme që nuk janë të lidhura me shumën imagjinare. Për shembull, një kontratë mund të kërkojë një pagesë të pandryshueshme prej 1,000^{*}NJM në qoftë se LIBOR për gjashtë muaj rritet me bazë pikësh 100. Një kontratë e tillë është një derivativ edhe pse nuk është e specifikuar shuma imagjinare.
- AG10 Përkufizimi i një derivativi në këtë standard përfshin kontrata që shlyhen bruto nëpërmjet livrimit të zërit bazë (p.sh. një kontratë e ardhshme (forward) për blerjen e një instrumenti borxhi me normë të pandryshueshme). Një njësi ekonomike mund të ketë një kontratë për të blerë ose shitur një zë jofinanciar që mund të shlyhet neto në mjete monetare, ose me një instrument tjetër financiar, ose nëpërmjet këmbimit me instrumente financiare (p.sh. një kontratë për të blerë ose shitur një mall me një çmim të pandryshueshëm në të ardhmen). Një kontratë e tillë është objekt i këtij standardi nëse nuk është e lidhur dhe vazhdon të jetë e lidhur me qëllim livrimin e një zëri jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerje, shitje ose përdorim (shih paragrafet 5–7).
- AG11 Një nga karakteristikat e përkufizimit të një derivativi është që ai ka një investim neto fillestar, që është më i vogël se sa do të kërkohej për llojet e tjera të kontratave që priten të kenë të njëjtin reagim ndaj ndryshimeve në faktorët e tregut. Një kontratë opsioni plotëson këtë përkufizim, sepse primi është më i vogël se investimi që do të kërkohej të bëhej për të përftuar instrumentin financiar bazë për të cilin është lidhur opsioni. Një swap monedhe që kërkon një shkëmbim fillestar të monedhave të ndryshme me vlera të drejta të njëjta plotëson përkufizimin e dhënë, sepse ka një investim fillestar neto zero.
- AG12 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje shkakton një angazhim me çmim të pandryshueshëm midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes, që plotëson përkufizimin e një derivativi. Megjithatë, për shkak të një kohëzgjatje të shkurtër të angazhimit, ajo nuk njihet si një instrument financiar derivativ. Kështu, ky standard përcakton mbajtjen e një kontabiliteti të veçantë për këto kontrata të lidhura në mënyrë të rregullt (shih paragrafet 38 dhe AG53–AG56).
- AG12A Përkufizimi i një derivativi u referohet variablave që nuk janë specifike për njërën palë të kontratës. Këta përfshijnë indeksin e humbjeve të shkaktuara nga tërmetet në një rajon të veçantë dhe indeksin e temperaturave në një qytet të veçantë. Variablat jofinanciare specifike për njerën palë të kontratës përfshijnë rënien ose jo të një zjarri, që dëmton ose shkatërron një aktiv të njërës palë të kontratës. Një ndryshim në vlerën e drejtë të një aktivi jofinanciar është specifik për pronarin në qoftë se vlera e drejtë pasqyron jo vetëm ndryshimet në çmimet e tregut për këto aktive (një variabël financiar), por gjithashtu edhe gjendjen e aktivit jofinanciar të mbajtur (një variabël jofinanciar). Për shembull, në qoftë se një garanci e vlerës së mbetur të një makine specifike e ekspozon garantuesin ndaj rrezikut të ndryshimeve në gjendjen fizike të makinës, atëhere ndryshimi në vlerën e mbetur është specifik për pronarin e makinës.

Kostot e transaksionit

- AG13 Kostot e transaksionit përfshijnë tarifat dhe komisionet e paguara agjentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitjeje), këshilltarët, ndërmjetësve dhe tregtarëve (dealer), taksat ndaj agjencive rregullatore dhe bursës së letrave me vlerë, tatimet dhe taksat e transferimit. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet ose skontot e borxheve, kostot e financimit ose të administrimit të brendshëm apo të mbajtjes.

* Në këtë standard, shumat monetare janë shprehur në 'Njësi monetare' (NJM).

Aktive financiare dhe pasive financiare të mbajtura për tregtim

AG14 Tregtimi në përgjithësi pasqyron blerjen dhe shitjen aktive dhe të shpeshtë, ndaj dhe instrumentet financiare të mbajtura për tregtim, përgjithësisht, përdoren me synim prodhimin e një fitimi nga luhatjet afatshkurtëra në çmim ose në marzhin e tregtarit.

AG15 Pasivet financiare të mbajtura për tregtim përfshijnë:

- (a) pasivet derivativë që nuk kontabilizohen si instrumente mbrojtës;
- (b) detyrimet për të livruar aktive financiare të huajtura nga një shitës jopronar (d.m.th. një njësi ekonomike që shet aktivet financiare që ajo i ka marrë borxh dhe ende nuk i zotëron);
- (c) pasivet financiare që merren përsipër me synimin për t'i riblerë në një periudhë të afërme (p.sh. një instrument borxhi i kuotuar që emetuesi mund ta blejë përsëri në një periudhë të afërt, në varësi të ndryshimeve në vlerën e drejtë të tij); dhe
- (d) pasivet financiare që janë pjesë e një portofoli instrumentash financiare të identifikuar, që drejtohen sëbashku dhe për të cilin ka një evidencë të një modeli të fundit të sigurimit të fitimeve afatshkurtëra.

Fakti që një pasiv përdoret për të financuar aktivitetet tregtare, në vetvete, nuk përbën një pasiv të mbajtur për tregtim.

Investime deri në maturim

AG16 Një njësi ekonomike nuk ka një synim pozitiv për të mbajtur deri në maturim një investim në një aktiv financiar me një maturim të fiksuar në qoftë se:

- (a) njësia ekonomike synon ta mbajë aktivin financiar për një periudhë të papërcaktuar;
- (b) njësia ekonomike është gati ta shesë aktivin financiar (me përjashtim të rastit kur kemi një situatë që nuk përsëritet dhe që nuk mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme nga ana e njësies ekonomike) në përgjigje të ndryshimeve në normat e tregut të interesit ose rreziqeve, nevojave për likuiditet, ndryshimeve në vlefshmërinë dhe në normën e interesit të investimeve alternative, ndryshimet në burimet e financimit dhe afatet ose ndryshimet në rrezikun e monedhës së huaj, ose
- (c) emetuesi ka të drejtën ta shlyejë aktivin financiar me një shumë kryesisht poshtë koston së amortizuar të tij.

AG17 Një instrument borxhi me një normë interesi të ndryshueshme mund të plotësojë kriterin e klasifikimit si investim që mbahet deri në maturim. Instrumentet e kapitalit neto nuk mund të konsiderohen si investime që mbahen deri në maturim sepse, ose kanë një jetë të papërcaktuar (të tilla si aksionet e zakonshme), ose sepse shumata që mbajtësi duhet të arkëtojë mund të ndryshojë në një mënyrë që nuk është e paracaktuar (të tilla si opsionet për aksione, garancitë dhe të drejta të ngjashme). Në lidhje me përkufizimin e investimeve të mbajtura deri në maturim, pagesa e pandryshueshme ose e përcaktuar dhe maturimi i pandryshueshëm do të thotë që, një marrëveshje kontraktuale përkufizon shumata dhe datat e pagesave për mbajtësin, siç janë pagesat e interesit dhe të principalit. Rreziku i rëndësishëm i mospagimit nuk shmanë klasifikimin e aktivitetit financiar si të mbajtur deri në maturim, për aq kohë sa pagesat e tij kontraktuale janë të pandryshueshme ose të përcaktuara dhe është plotësuar kriteri tjetër i këtij klasifikimi. Në qoftë se termat e një instrumenti borxhi të përhershëm përcaktojnë pagesa interesi për një periudhë të pacaktuar, atëherë instrumenti nuk mund të klasifikohet si i mbajtur deri në maturim, sepse nuk ka datë maturimi.

AG18 Kriteri për klasifikim si një investim që mbahet deri në maturim plotësohet për një aktiv financiar që është i kërkueshëm prej emetuesit, nëse mbajtësi synon dhe është në gjendje ta mbajë atë deri sa ai të kërkohet (blihet) ose deri në maturim, dhe mbajtësi duhet të mbulojë kryesisht të gjithë vlerën kontabël (neto) të aktivitetit. Opsioni i blerjes i emetuesit, në qoftë se ushtrohet, thjesht përshpejton maturimin e aktivitetit. Megjithatë, në qoftë se aktiviteti financiar është i kërkueshëm mbi një bazë të tillë që mbajtësi nuk mund të mbulojë kryesisht të gjithë vlerën kontabël (neto) të tij, atëherë aktiviteti financiar nuk mund të klasifikohet si një investim që mbahet deri në maturim. Në përcaktimin nëse vlera kontabël (neto) e aktivitetit është kryesisht e mbuluar, njësia ekonomike merr parasysh çdo prim të paguar dhe kostot e transaksionit të kapitalizuara.

AG19 Një aktiv financiar që është i kthyeshëm (aksioni) në shoqëri me çmimin e mëparshëm (d.m.th. mbajtësi ka të drejtën të kërkojë që emetuesi të ripaguajë ose të rishlyejë aktivin financiar para maturimit) nuk mund të klasifikohet si një investim që mbahet deri në maturim, sepse pagesa për tiparin e opsionit të kthimit në një aktiv financiar nuk është në përputhje me shprehjen e synimit për të mbajtur një aktiv financiar deri në maturim.

AG20 Për shumicën e aktiveve financiare, matja me vlerën e drejtë është matja më e përshtatshme se ajo me koston e amortizuar. Klasifikimi i investimit që mbahet deri në maturim është një përjashtim, por vetëm në qoftë se njësia ekonomike ka një synim pozitiv dhe është në gjendje ta mbajë investimin deri në maturim. Kur veprimet e një

njësia ekonomike ngjallin dyshim për synimin dhe aftësinë për të mbajtur një investim të tillë deri në maturim, paragrafi 9 shmang përdorimin e përjashtimit për një periudhë kohe të arsyeshme.

- AG21 Një skenar katastrofe që është vetëm një mundësi e largët, si në rastin e falimentimit të një banke ose për një situatë të ngjashme që ndikon tek siguruesi, nuk është diçka që mund të vlerësohet nga njësia ekonomike kur merr vendimin nëse ka një synim pozitiv dhe aftësinë për të mbajtur një investim deri në maturim.
- AG22 Të ardhurat nga shitjet para maturimit mund të plotësojnë kushtin e parashtruar në paragrafin 9 —prandaj nuk ngrihet çështja e synimit të njësies ekonomike për të mbajtur investime të tjera deri në maturim—në qoftë se ato lidhen drejtpërdrejt me sa më poshtë:
- një rënie e ndjeshme në aftësinë huamarrëse të emetuesit. Për shembull, në rastin e një shitjeje që ndjek një rënie në vlerësimin e kredisë të bërë nga një agjenci vlerësimi e jashtme, nuk do të ishte e nevojshme të ngrihej çështja e synimit të njësies ekonomike për të mbajtur investime të tjera deri në maturim, në qoftë se rënia përbën evidencën e një ulje të rëndësishme të aftësisë huamarrëse të emetuesit, gjykuar mbi bazën e referencës në vlerësimin e kredisë në njohjen fillestare. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se njësia ekonomike përdor vlerësimet e brendshme për të përcaktuar rreziqet, ndryshimet në këto vlerësime të brendshme mund të ndihmojnë për të identifikuar emetuesin për të cilin ka ndodhur një ulje e ndjeshme në aftësinë huamarrëse, duke treguar që, metoda e njësies ekonomike e përdorur në vlerësimet e brendshme dhe ndryshimet në këto vlerësime përbën një matje të qëndrueshme, të besueshme dhe objektive të cilësisë së kredisë të emetuesit. Në qoftë se ka një evidencë që vërteton se një aktiv financiar është zhvlerësuar (shih paragrafet 58 dhe 59), ulja e aftësisë huamarrëse konsiderohet si e rëndësishme.
 - një ndryshim në ligjin e tatimit, që eliminon ose ul ndjeshëm statusin e të qënurit si përjashtim nga tatimi i interesit mbi investimin që mbahet deri në maturim (por jo një ndryshim në ligjin e tatimit që rishikon normat e tatimit marzhinal të zbatueshme mbi të ardhurat nga interesi).
 - një kombinim biznesi i rëndësishëm ose një shitje e rëndësishme (siç është shitje e një segmenti), që bën të nevojshme shitjen ose transferimin e investimit që mbahet deri në maturim, për të ruajtur gjendjen ekzistuese të rrezikut të normës së interesit për njësinë ekonomike ose politikën e rrezikut të kredisë (ndonëse kombinimi i biznesit është një ngjarje brenda kontrollit të njësies ekonomike, ndryshimet në portofolin e investimit të saj, për të ruajtur një gjendje rreziku të normës së interesit ose politikën e rrezikut të kredisë, mund të jenë rrjedhimore, sesa të parashikuara).
 - një ndryshim në kërkesat statutores ose rregullatore, që modifikon në mënyrë të ndjeshme ose atë ç'ka përbën një investim të lejueshëm, ose nivelin maksimal të llojeve të veçanta të investimeve. Pra, një gjë e tillë bën që njësia ekonomike të shesë një investim të klasifikuar si i mbajtur deri në maturim.
 - një rritje e ndjeshme në kërkesat rregullatore për kapital në industri që e detyron njësinë ekonomike ta minimizojë nëpërmjet shitjes së investimeve që mbahen deri në maturim.
 - një rritje e ndjeshme në peshën specifike të rrezikut të investimeve që mbahen deri në maturim, e përdorur për qëllimet rregullatore të kapitalit të bazuar në rrezik.
- AG23 Një njësi ekonomike nuk ka një synimin pozitiv për të mbajtur deri në maturim një investim në një aktiv financiar me një maturim të fiksuar në qoftë se:
- nuk ka burime financiare të disponueshme për të vazhduar financimin deri në maturim; ose
 - i nënshtrohet një kufizimi ligjor ose ndonjë kufizimi tjetër që mund të përmbysë synimin për të mbajtur aktivin financiar deri në maturim. (Megjithatë, një emetues i një opsioni të blerjes jo domosdoshmërisht përmbys synimin e një njësie ekonomike për të mbajtur një aktiv financiar deri në maturim—shih paragrafin AG18.)
- AG24 Rrethanat, përveç atyre të përshkruara në paragrafet AG16–AG23, mund të tregojnë që një njësi ekonomike nuk ka synimin pozitiv ose aftësinë për të mbajtur një investim deri në maturim.
- AG25 Një njësi ekonomike e vlerëson synimin dhe aftësinë e saj për të mbajtur një investim deri në maturim jo vetëm kur aktivet financiare njihen fillimisht, por edhe më pas në çdo datë të bilancit.

Huate dhe llogaritë e arkëtueshme me origjinë tek njësia ekonomike

- AG26 Çdo aktiv financiar joderivativ me pagesa të pandryshueshme ose të përcaktuara (përfshirë aktivin me hua, llogaritë e arkëtueshme tregtare, investimet në instrumente borxhi dhe depozitat e mbajtura në banka) mund të plotësojë potencialisht përkufizimin e dhënë për huate dhe llogaritë e arkëtueshme. Megjithatë, një aktiv financiar që është i kuotuar në një treg aktiv (siç është një instrument borxhi i kuotuar, shih paragrafi AG71) nuk kualifikohet për klasifikim si një hua ose llogari e arkëtueshme. Aktivet financiare që nuk plotësojnë përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme mund të klasifikohen si investime që mbahen deri në maturim, në qoftë se ato plotësojnë kushtin për këtë klasifikim (shih paragrafet 9 dhe AG16–AG25). Në njohjen

fillestare të një aktivi, që ndryshe do të ishte klasifikuar si një hua ose llogari e arkëtueshme, një njësi ekonomike mund ta përcaktojë si një aktiv financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshëm për shitje.

Derivatvët e përfshirë (paragrafet 10-13)

- AG27 Në qoftë se një kontratë bazë nuk ka maturim të shpallur ose të paracaktuar dhe përfaqëson një interes të mbetur në aktivet neto të njësisë ekonomike, atëhere karakteristikat e saj ekonomike dhe rreziqet janë ato të një instrumenti kapitali neto, dhe do të duhej që një derivativ i përfshirë të kishte karakteristikat e kapitalit neto në lidhje me të njëjtën njësi ekonomike për ta quajtur si të lidhur ngushtë me të. Nëse kontrata bazë nuk është një instrument kapitali neto dhe plotëson përkufizimin e një instrumenti financiar, atëhere karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e saj janë ato të një instrumenti borxhi.
- AG28 Një derivativ i përfshirë pa opSION (siç është një swap apo forward i përfshirë) veçohet nga kontrata bazë e tij mbi bazën e termave thelbësore të shpallur ose të nënkuptuar, kështu që si rezultat ai do të ketë një vlerë të drejtë zero në njohjen fillestare. Një derivativ i përfshirë i bazuar në opSION (siç është një opSION i përfshirë shitjeje, blerjeje, me kufi maksimal, dyscheme ose proces shkëmbimi) veçohet nga kontrata bazë e tij mbi bazën e termave të shpallur të tiparit të opSIONIT. Vlera kontabël (neto) fillestare e instrumentit bazë është vlera e mbetur mbas ndarjes së derivativit të përfshirë.
- AG29 Në përgjithësi, derivativët e shumëfishtë të përfshirë në një instrument të vetëm trajtohen si një derivativ i përfshirë i përbërë i vetëm. Megjithatë, derivativët e përfshirë që klasifikohen si kapitali neto (shih SNK 32), trajtohen në mënyrë të veçantë nga ata të klasifikuar si aktive ose pasive. Përveç kësaj, në qoftë se një instrument ka më tepër se një derivativ të përfshirë dhe këta derivativë lidhen me rreziqe të ndryshme, si dhe janë pothuajse të ndashëm dhe të pavarur nga njeri-tjetri, ata trajtohen në mënyrë të veçantë nga njeri-tjetri.
- AG30 Karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me kontratën bazë (paragrafi 11(a)) në shembujt e mëposhtëm. Në këta shembuj, duke supozuar që plotësohen kushtet në paragrafet 11(b) dhe (c), njësi ekonomike i trajton derivativët e përfshirë në mënyrë të veçantë nga kontrata bazë.
- Një kontratë me opSION shitjeje e përfshirë në një instrument, që i jep mundësi mbajtësit t'i kërkojë emetuesit të riblejë instrumentin kundrejt një shume mjetesh monetare ose aktivesh të tjerë, që ndryshon në bazë të ndryshimit në kapitalin neto ose çmimin e mallit, ose indeksin, nuk është e lidhur ngushtë me një instrument borxhi.
 - Një opSION blerjeje i përfshirë në një instrument kapitali neto, që i jep mundësinë emetuesit të riblejë këtë instrument kapitali neto me një çmim të specifikuar, nuk është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë kapitali neto nga këndvështrimi i mbajtësit (nga këndvështrimi i emetuesit, opSIONI i blerjes është një instrument kapitali neto nëse ai plotëson kushtet për klasifikim sipas SNK 32, në rastin kur ai përjashtohet nga objekti i këtij standardi).
 - Një opSION ose klauzolë e vetvetishme për të shtyrë kohën e mbetur për maturimin e një instrumenti borxhi, nuk është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit, me përjashtim të rastit kur bëhet një rregullim i njëkohshëm për të përafëruar normën aktuale të tregut të interesit në momentin e shtyrjes. Në qoftë se një njësi ekonomike emeton një instrument borxhi dhe mbajtësi i këtij instrumenti borxhi nënshkruan një opSION blerjeje për të me një palë të tretë, emetuesi e trajton opSIONIN e blerjes si një shtyrje të afatit deri në maturim të instrumentit të borxhit, duke bërë që emetuesi të kërkojë të marrë pjesë në ose lehtësimin e rimarketingut të instrumentit të borxhit si rezultat i ushtrimit të opSIONIT të blerjes.
 - Pagesat e interesit të indeksuar të kapitalit neto ose pagesat e principalit të përfshira në instrumentin bazë të borxhit ose kontratën e sigurimit—prej të cilit, shumat e interesit ose principalit është indeksuar me vlerën e instrumentit të kapitalit neto—nuk janë të lidhura ngushtë me instrumentin bazë, sepse rreziqet e qenësishme në bazën dhe në derivativët e përfshirë nuk janë të njëjtë.
 - Pagesat e interesit të indeksuar të mallit ose pagesat e principalit të përfshirë në një instrument borxhi bazë ose kontratën e sigurimit—prej të cilit, shumat e interesit ose e principalit është e indeksuar me vlerën e mallit (siç është ari)—nuk janë të lidhur ngushtë me instrumentin bazë, sepse rreziqet e qenësishme në bazën dhe në derivativët e përfshirë nuk janë të njëjtë.
 - Një tipar konvertimi kapitali i përfshirë në një instrument borxhi të konvertueshëm nuk është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit nga këndvështrimi i mbajtësit të instrumentit (nga këndvështrimi i emetuesit, opSIONI i konvertimit të kapitalit është një instrument kapitali neto dhe përjashtohet nga qëllimi i këtij standardi nëse ai plotëson kushtet për klasifikim sipas SNK 32).
 - Një opSION blerjeje, shitjeje(put), ose parapagimi i përfshirë në një kontratë bazë borxhi ose kontratë bazë sigurimi nuk është e lidhur ngushtë me kontratën bazë, nëse opSIONI i çmimit të periudhës nuk është përafërsisht i barabartë, në secilën datë të periudhës, me koston e amortizuar të instrumentit bazë

të borxhit ose me vlerën kontabël (neto) të kontratës bazë të sigurimit. Nga perspektiva e emetuesit të instrumentit të borxhit të konvertueshëm në një opSION të përfshirë blerjeje ose në një tipar të kontratës me opSION (shitjeje), vlerësimi nëse opSIONI i blerjes ose i shitjes është i lidhur ngushtë me kontratën bazë të borxhit bëhet përpara se të veçohet elementi i kapitalit neto sipas SNK 32.

- (h) Derivatvët e kredisë, që janë të përfshirë në një instrument bazë borxhi dhe lejojnë që një palë (‘përfituesi’) t’ia transferojë rrezikun e kredisë së një aktivi, me një referencë të veçantë, të cilin mund të mos e ketë në pronësi, një pale tjetër (‘garantuesi’), nuk janë të lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit. Të tillë derivativë e lejojnë garantuesin të marrë përsipër rrezikun e kredisë të lidhur me aktivin e referencës pa e patur në pronësi të drejtpërdrejtë.

AG31 Një shembull i një instrumenti hibrid është rasti i një instrumenti financiar që i jep mbajtësit të drejtën për t’ia shitur përsëri emetuesit këtë instrument, në këmbim të një shume mjetesh monetare ose aktivesh të tjerë, që ndryshon në bazë të ndryshimit në kapitalin neto ose indeksin e çmimit të mallit, që mund të rritet ose zvogëlohet (një ‘instrument i kthimit të aksionit’). Nëse emetuesi, në njohjen fillestare, nuk e përcakton instrumentin e kthimit të aksionit si një pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kërkohet që ai të ndajë derivativin e përfshirë (d.m.th. pagesën e principalit të indeksuar) sipas paragrafit 11, sepse kontrata bazë është një instrument borxhi sipas paragrafit AG27 dhe pagesa e principalit e indeksuar nuk është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë të borxhit sipas paragrafit AG30(a). Meqë pagesa e principalit mund të rritet dhe të zvogëlohet, derivativi i përfshirë është një derivativ joopsional, vlera e të cilit indeksohet në variablin bazë.

AG32 Në rastin e një instrumenti të kthimit të aksionit, që mund të kthehet në çdo kohë në mjete monetare të barabarta me një pjesë proporcionale të vlerës së aktivit neto të një njësie ekonomike (siç janë njësitë e fondit të përbashkët të pakufizuar ose disa produkte investimi të lidhura), ndikimi i ndarjes së një derivativi të përfshirë dhe i trajtimit të çdo përbërësi është të matet instrumenti i kombinuar me vlerën e aksionit të riblerjes, që është i pagueshëm në datën e bilancit, në qoftë se mbajtësi ushtron të drejtën e tij për të rikthyer përsëri instrumentin tek emetuesi.

AG33 Në shembujt e mëposhtëm, karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë. Në këta shembuj, një njësi ekonomike nuk i trajton derivativët e përfshirë në mënyrë të veçantë nga kontrata bazë.

- (a) Një derivativ i përfshirë, ku baza është një normë interesi ose indeksi i normës së interesit, e cila mund të ndryshojë shumë e interesit, që ndryshe do të ishte paguar ose arkëtuar mbi një kontratë borxhi që mbart interes ose kontratë sigurimi, konsiderohet i lidhur ngushtë me kontratën bazë, me përjashtim kur instrumenti i kombinuar mund të shlyhet në një mënyrë të tillë që mbajtësi nuk do të mbulonte kryesisht të gjitha investimet e njohura ose kur derivativët e përfshirë mund të dyfishonin të paktën normën fillestare të kthimit mbi kontratën bazë të mbajtësit dhe mund të çojnë në një normë kthimi, që është të paktën dyfishi i asaj të tregut, për një kontratë me terma të njëjtë me ato të kontratës bazë.
- (b) Një kufi maksimal ose dysheme, i përfshirë në normën e interesit të një kontrate borxhi ose kontrate sigurimi, është i lidhur ngushtë me kontratën bazë, me kusht që kufiri maksimal është në ose mbi normën e tregut të interesit dhe ai dysheme është në ose nën normën e tregut të interesit, kur kontrata emetohet, ndërkohë që kufiri maksimal ose dysheme nuk përdoret si levë në lidhje me kontratën bazë. Në mënyrë të ngjashme, klauzolat e përfshira në kontratë për të blerë ose shitur një aktiv (p.sh. një mall), që krijojnë një kufi maksimal dhe një dysheme mbi çmimin që paguhet ose arkëtohet për aktivin, janë të lidhura ngushtë me kontratën bazë në qoftë se si kufiri maksimal dhe ai dysheme nuk duan mjete monetare në fillim dhe nuk janë ngritur.
- (c) Një derivativ i përfshirë në monedhë të huaj, nga i cili sigurohet një seri pagesash të principalit ose të interesit të shprehura në monedhë të huaj dhe që është i përfshirë në një instrument borxhi bazë (p.sh. një obligacion në monedhë të dyfishtë), është i lidhur ngushtë me këtë instrument borxhi bazë. Një derivativ i tillë nuk veçohet nga instrumenti bazë, sepse SNK 21 kërkon që fitimet neto dhe humbjet në monedhë të huaj për zërat monetarë të njihen në fitim ose humbje.
- (d) Një derivativ në monedhë të huaj në një kontrate bazë, që është një kontratë sigurimi ose jo një instrument financiar (siç është një kontratë për blerje dhe shitje të një zëri jofinanciar, kur çmimi është i shprehur në monedhë të huaj), është i lidhur ngushtë me kontratën bazë duke bërë që ajo të mos ngrihet, të mos ketë një tipar opSIONI dhe kërkon që pagesat të bëhen në një prej monedhave të mëposhtme:
- (i) në monedhën funksionale e secilës palë të rëndësishme të kësaj kontrate;
 - (ii) në monedhën me të cilën shprehet zakonisht çmimi i mallrave ose i shërbimeve përkatëse të blera ose të livruara në transaksionet tregtare në tërë botën (siç është dollari US në transaksionet për naftën bruto); ose
 - (iii) në monedhën që përdoret zakonisht në kontratat për të blerë ose shitur zëra jofinanciarë në mjedisin ekonomik në të cilin ka ndodhur transaksioni (p.sh. një monedhë relativisht stabilë dhe likuide që përdoret zakonisht në transaksionet e biznesit lokal ose në tregtinë e jashtme).

- (e) Një opzion me parapagim, i përfshirë në një interes të shitur veçmas ose në një principal të shitur veçmas, është i lidhur ngushtë me kontratën bazë duke bërë që kjo kontratë (i) fillimisht të rezultojë nga veçimi i të drejtës për të arkëtuar flukse mjetelesh monetare kontraktuale të një instrumenti financiar që, në vetvete ose më vete, nuk përbën një derivativ të përfshirë, dhe (ii) nuk përmban ndonjë term që nuk është paraqitur në kontratën bazë origjinale të borxhit.
- (f) Një derivativ i përfshirë në një kontratë bazë qiraje është i lidhur ngushtë me kontratën bazë, në qoftë se derivativi i përfshirë është (i) një indeks i lidhur me inflacionin siç është indeksi i pagesave të qirasë kundrejt indeksit të çmimeve të konsumit (me kusht që qiraja nuk ngrihet dhe indeksi lidhet me inflacionin e mjedisit ekonomik të vetë njësisë ekonomike), (ii) të ardhurat nga qiratë eventuale bazuar në shitjet përkatëse ose (iii) të ardhurat nga qiratë eventuale bazuar në normat variabël të interesit.
- (g) Një veti lidhëse e përfshirë në një instrument financiar bazë ose kontratë bazë sigurimi është e lidhur ngushtë me instrumentin bazë ose kontratën bazë, në qoftë se pagesat e shprehura në njësi maten me vlerat aktuale të njësisë, që pasqyrojnë vlerat e drejta të aktiveve të fondit. Një veti lidhëse është një term kontraktual i cili kërkon që pagesat të jenë të shprehura në njësitë e një investimi fondi të brendshëm ose të jashtëm.
- (h) Një derivativ i përfshirë në një kontratë sigurimi është i lidhur ngushtë me një kontratë bazë sigurimi, në qoftë se derivativi i përfshirë dhe kontrata bazë e sigurimit janë caq të ndërvarura sa që njësia ekonomike nuk mund ta matë derivativin e përfshirë në mënyrë të veçantë (d.m.th. pa marrë në konsideratë kontratën bazë).

Instrumentet që përmbajnë derivativë të përfshirë

- AG34A Kur një njësi ekonomike bëhet palë e një instrumenti hibrid (të kombinuar) që përmban një ose më shumë derivativë të përfshirë, paragrafi 11 kërkon që njësia ekonomike t'i identifikojë këta derivativë të përfshirë, t'i vlerësojë nëse kërkohet të jenë të veçuar, t'i matë derivativët me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe atë të mëpasshme. Këto kërkesa mund të jenë më tepër komplekse ose çojnë në matje më pak të besueshme, se sa matja e tërë instrumentit me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për këtë arsye ky standard lejon instrumentin e tërë të përcaktohet si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- AG35B Një përcaktim i tillë mund të përdoret nëse paragrafi 11 kërkon që derivativët e përfshirë të jenë të veçuar nga kontrata bazë ose ndalon të bëhet një veçim i tillë. Megjithatë, paragrafi 11A nuk do ta justifikonte përcaktimin e instrumentit hibrid (të kombinuar) si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në rastet e paraqitura në paragrafin 11A(a) dhe (b), sepse duke vepruar kështu nuk do të zvogëlohej kompleksiteti ose të rritet besueshmëria.

Njohja dhe mosnjohja (paragrafet 14–42)


Njohja fillestare (paragrafi 14)

- AG36 Nga parimi i paragrafit 14 rrjedh që një njësi ekonomike njihet në bilanc të gjitha të drejtat kontraktuale dhe detyrimet e saj në derivativë si aktive dhe pasive, përkatësisht, me përjashtim të derivativëve që ndalojnë një transferim të aktiveve financiare nga të trajtuarit si shitje (shih paragrafi AG49). Në qoftë se një transferim i një aktivi financiar nuk kualifikohet për mosnjohje, marrësi i aktivitetit nuk e njihet aktivin e transferuar si aktivin e tij (shih paragrafin AG50).
- AG37 Më poshtë jepen shembuj të zbatimit të parimit në paragrafin 14:
- (a) Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme të pakushtëzuara njihen si aktive ose pasive kur njësia ekonomike bëhet palë në një kontratë dhe si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të arkëtuar ose detyrim ligjor për të paguar mjete monetare.
 - (b) aktivet që blihen ose pasivet që ndërmerren si rezultat i një angazhimi të përcaktuar për të blerë ose për të shitur mallra dhe shërbime, që, në përgjithësi, nuk njihen, të paktën deri sa njera palë ka vepruar sipas marrëveshjes. Për shembull, një njësi ekonomike që ka marrë një porosi nga një firmë, në përgjithësi, nuk e njihet si aktiv (dhe njësia ekonomike që bën porosinë nuk e njihet si pasiv) në momentin e angazhimit, por, në një farë mënyre, e shtyn njohjen deri sa mallrat ose shërbimet e porositura transportohen, livrohen ose dorëzohen. Në qoftë se një angazhim i përcaktuar për të blerë ose për të shitur zëra jofinanciarë është objekt i këtij standardi sipas paragrafeve 5–7, vlera e drejtë neto e tij njihet si një aktiv ose pasiv në datën e angazhimit (shih pikën (c) më poshtë). Përveç kësaj, në qoftë se një angazhim i përcaktuar i panjohur paraprakisht përcaktohet si një element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë, çdo ndryshim në vlerën e drejtë neto të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun mbrojtës njihet si një aktiv ose pasiv mbas fillimit të mbrojtjes (shih paragrafet 93 dhe 94).

- (c) një kontratë e ardhshme që është objekt i këtij standardi (shih paragrafet 2–7) njihet si një aktiv ose pasiv në datën e angazhimit, dhe jo në datën në të cilën ndodh shlyerja. Kur një njësi ekonomike bëhet palë në një kontratë të ardhshme, vlerat e drejta të së drejtës dhe të detyrimit janë shpesh të barabarta, kështu që vlera e drejtë neto e kontratës së ardhshme është zero. Në qoftë se vlera e drejtë neto e të drejtës dhe detyrimit nuk është zero, atëhere kontrata njihet si një aktiv ose pasiv.
- (d) kontrata opsioni, që janë objekt i këtij standardi (shih paragrafet 2–7), njihen si aktive ose pasive kur mbajtësi ose nënshkruesi bëhet palë në kontratë.
- (e) transaksionet e ardhshme të planifikuara, pavarësisht se si ndodhin, nuk janë aktive dhe pasive, sepse njësi ekonomike nuk bëhet palë në një kontratë.

Mosnjohja e aktivitet financiar (paragrafet 15–37)

AG38 Bllok-skema e mëposhtme ilustron vlerësimin nëse dhe në ç'masë një aktiv financiar nuk njihet.



Marrëveshjet sipas të cilave një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukse mjeteshe monetare nga një aktiv financiar, ndërsa merr përsipër një detyrim kontraktual për t'u paguar flukse mjeteshe monetare një ose më shumë përfituesve (paragrafi 18(b))

- AG39 Situata e përshkruar në paragrafin 18(b) (kur një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të arkëtuar flukse mjeteshe monetare të aktivit financiar, por duke marrë përsipër një detyrim kontraktual për t'u paguar flukse mjeteshe monetare një ose më shumë përfituesve) ndodh, për shembull, në qoftë se njësi ekonomike është një njësi ekonomike për qëllime të veçanta ose njësi besimi, dhe kalon tek investitorët interesat përfituese në aktivin financiar bazë që ajo ka në pronësi dhe siguron shërbimin e këtyre aktiveve financiare. Në këtë rast, aktivet financiare kualifikohen për mosnjohje, në qoftë se plotësohen kushtet në paragrafet 19 dhe 20.
- AG40 Për zbatimin e paragrafit 19, njësi ekonomike mund të jetë, për shembull, krijuesja e aktivit financiar, ose mund të jetë një grup që përfshin një njësi ekonomike të konsoliduar për qëllime të veçanta, që ka blerë aktivin financiar dhe i kalon flukset e mjeteve monetare tek investitorët që janë palë e tretë të palidhur.

Vlerësimi dhe transferimi i rreziqeve dhe i përfitimeve të pronësisë (paragrafi 20)

- AG41 Shembuj, ku njësi ekonomike ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, janë:
- një shitje e pakushtëzuar e një aktivi financiar;
 - shitja e një aktivi financiar së bashku me një opion riblerjeje të aktivit financiar me vlerën e drejtë të tij në momentin e riblerjes; dhe
 - shitja e një aktivi financiar së bashku me një opion shitjeje (put) dhe blerjeje (call) që bëhet plotësisht pa mjete monetare (d.m.th. një opion që deri tani është pa para, saqë nuk ka të ngjarë aspak që këtë mjete monetare përpara mbarimit).
- AG42 Shembuj, ku njësi ekonomike ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, janë:
- shitja dhe transaksioni i riblerjes, ku çmimi i riblerjes është një çmimi i fiksuar ose çmimi i shitjes plus kthimi i huadhënësit;
 - një marrëveshje huadhënie e letrave me vlerë;
 - shitja e një aktivi financiar së bashku me të ardhurat gjithsej nga kontratat e shkëmbimit (swap) që transferon përsëri ekspozimin ndaj rrezikut të tregut tek njësi ekonomike;
 - shitja e një aktivi financiar së bashku me një opion shitjeje (put) dhe blerjeje (call) plotësisht në para (d.m.th. një opion deri tani në para, saqë nuk ka të ngjarë aspak që të mos ketë para përpara mbarimit). dhe
 - shitja e llogarive të arkëtueshme afatshkurtëra me të cilat njësi ekonomike garanton të kompensojë marresin për humbjet e kredisë që ka mundësi të ndodhin.
- AG43 Në qoftë se një njësi ekonomike përcakton se si rezultat i transferimit ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit të transferuar, atëherë ajo nuk e njeh përsëri aktivin e transferuar në periudhën e ardhshme, me përjashtim kur riblihet aktivi i transferuar në një transaksion të ri.

Vlerësimi i transferimit të kontrollit

- AG44 Një njësi ekonomike nuk ka ruajtur kontrollin mbi aktivin e transferuar, në qoftë se marresi ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar. Një njësi ekonomike ka ruajtur kontrollin mbi aktivin e transferuar në qoftë se marresi nuk ka aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar. Marresi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin e transferuar, në qoftë se ai tregtohet në një treg aktiv, sepse marresi mund ta riblejë aktivin e transferuar në treg nëse ai kërkon ta kthejë aktivin tek njësi ekonomike. Për shembull, marresi mund të ketë aftësinë praktike për ta shitur aktivin e transferuar, në qoftë se ky është subjekt i një opsioni që e lejon njësinë ekonomike ta riblejë, ndërsa ai mund ta përftojë menjëherë në treg aktivin e transferuar nëse përdoret opsioni. Marresi nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin e transferuar, në qoftë se njësi ekonomike ka një opion të tillë dhe ai nuk mund ta përftojë menjëherë aktivin e transferuar në treg nëse njësi ekonomike përdor opsionin e saj.

AG45 Marresi ka aftësinë praktike të shesë aktivin e transferuar vetëm në qoftë se ai mund t'ia shesë aktivin e transferuar, në tërësinë e tij, një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë këtë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa imponuar kufizime shtesë gjatë transferimit. Çështja kritike është se çfarë është në gjendje të bëjë në praktikë marresi, dhe jo çfarë të drejta kontraktuale i përkasin atij në lidhje me aktivin e transferuar ose çfarë pengesa kontraktuale ekzistojnë. Në veçanti:

- (a) një e drejtë kontraktuale për të shitur aktivin e transferuar ka një ndikim të vogël praktik nëse nuk ka treg për aktivin e transferuar; dhe
- (b) aftësia për të shitur aktivin e transferuar ka një ndikim të vogël praktik nëse ajo nuk mund të ushtrohet lirshëm. Për këtë arsye:
 - (i) aftësia e të transferuarit për të shitur aktivin e transferuar duhet të jetë e pavarur nga veprimet e të tjerëve (d.m.th. ajo duhet të jetë një aftësi e njëanshme); dhe
 - (ii) marresi duhet të jetë në gjendje ta shesë aktivin e transferuar pa patur kushte kufizuese ose 'litarë' gjatë transferimit (p.sh. kushtet se si një aktiv me hua shërbehet ose një opsion që i jep të transferuarit të drejtën e riblerjes së aktivitetit).

AG46 Fakti që marresi nuk ka të ngjarë që të shesë aktivin e transferuar, nuk do të thotë aspak që marresi ka kontrollin e aktivitetit të transferuar. Megjithatë, në qoftë se një kontratë me opsion ose garanci e kufizon të transferuarin nga shitja e aktivitetit të transferuar, atëherë transferuesi ka ruajtur kontrollin e aktivitetit të transferuar. Për shembull, në qoftë se një kontratë me opsion shitjeje (put) ose garanci është e vlefshme në mënyrë të mjaftueshme, ajo kufizon marresin nga shitja e aktivitetit të transferuar, sepse marresi, në praktikë, nuk do t'ia kishte shitur aktivin e transferuar një pale të tretë pa patur një opsion të ngjashëm ose kushte të tjera kufizuese. Në fakt, marresi do ta mbante aktivin e transferuar aq sa për të përfutur pagesat për garancinë ose kontratën me opsion shitjeje (put). Në këto rrethana transferuesi ruan kontrollin e aktivitetit të transferuar.

Transferimet që kualifikohen për mosnjohje

AG47 Një njësi ekonomike mund të ruajë të drejtën për një pjesë të pagesave të interesit për aktivet e transferuara si kompensim për shërbimin e këtyre aktiveve. Pjesa e pagesave të interesit që njësi ekonomike do të bënte deri në përfundimin ose transferimin e kontratës së shërbimit shpërndahet në aktivin që shërbehet ose pasivin që shërbehet. Pjesa e pagesave të interesit që njësi ekonomike nuk do të bënte është shuma e arkëtueshme e interesit të shitur veças. Për shembull, në qoftë se njësi ekonomike nuk do të jepte ndonjë interes për përfundimin ose transferimin e kontratës së shërbimit, i tërë interesi i shpërndarë është vetëm një interes i shitur veças i arkëtueshëm. Me qëllim zbatimin e paragrafit 27, vlerat e drejta të aktivitetit të shërbyer dhe shumave të arkëtueshme të interesit të shitur veças përdoren për të shpërndarë vlerën kontabël (neto) të llogarisë së arkëtueshme midis pjesës së aktivitetit që nuk njihet dhe pjesës që vazhdon të njihet. Në qoftë se nuk ka një tarifë shërbimi të specifikuar ose tarifa për t'u arkëtuar nuk pritet që të kompensojë njësinë ekonomike mjaftueshëm për kryerjen e shërbimit, njihet një pasiv me vlerën e drejtë për detyrim shërbimi.

AG48 Në çmuarjen e vlerës së drejtë të pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që nuk njihet me qëllim zbatimin e paragrafit 27, një njësi ekonomike zbaton kërkesat për matjen me vlerën e drejtë të paragrafeve 48-49 dhe AG69–AG82 në plotësim të paragrafit 28.

Transferimet që nuk kualifikohen për mosnjohje

AG49 Më poshtë jepet zbatimi i parimit të përvijuar në paragrafin 29. Në qoftë se një garanci e siguruar nga një njësi ekonomike për humbjet e pësuar nga aktivi i transferuar parandalon mosnjohjen e një aktivi të transferuar, sepse njësi ekonomike ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit të transferuar, atëherë aktivi i transferuar vazhdon të njihet në tërësinë e tij dhe shuma e arkëtuar njihet si një pasiv.

Përfshirja e vazhdueshme në aktivet e transferuara

AG50 Shembujt e mëposhtëm tregojnë se si një njësi ekonomike mat një aktiv të transferuar dhe pasivin që e shoqëron sipas paragrafit 30.

Të gjitha aktivet

- (a) Në qoftë se një garanci e siguruar nga një njësi ekonomike për të paguar humbjet e pësuar nga aktivi i transferuar parandalon mosnjohjen e aktivitet të transferuar sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme, aktivi i transferuar në datën e transferimit matet me vlerën më të ulët të (i) vlerës kontabël (neto) të aktivitet dhe (ii) vlerës maksimale të shumës së arkëtuar gjatë transferimit që do t'i kërkohej njësisë ekonomike për të ripaguar ('shuma e garancisë'). Pasivi shoqërues fillimisht matet me vlerën e garancisë plus vlerën e drejtë të garancisë (e cila është normalisht shuma e arkëtuar për garanci). Rrjedhimisht, vlera e drejtë fillestare e garancisë njihet në fitim ose humbje duke u përpjesëtuar në kohë (shih SNK 18) dhe vlera kontabël e aktivitet zvogëlohet me çdo humbje nga zhvlerësimi.

Aktivet e matura me koston e amortizuar

- (b) Në qoftë se një detyrim me opSION shitjeje (put) i paracaktuar nga një njësi ekonomike ose e drejta me opSION blerjeje e mbajtur nga një njësi ekonomike parandalon mosnjohjen e një aktivi të transferuar dhe njësisia ekonomike mat aktivitet e transferuar me koston e amortizuar, pasivi bashkëshoqërues matet me koston e tij (d.m.th. shumën e arkëtuar), të rregulluar për amortizim të çdo diference midis kësaj kostoje dhe koston së amortizuar të aktivitet të transferuar në datën mbarimit të opSIONIT. Për shembull, supozohet se kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël (neto) e aktivitet në datën e transferimit është 98NJM dhe shuma e arkëtuar është 95NJM. Kostoja e amortizuar e aktivitet në datën e ushtrimit të opSIONIT do të jetë 100NJM. Vlera kontabël (neto) fillestare e pasivit bashkëshoqërues është 95NJM dhe diferenca midis 95NJM dhe 100NJM njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në qoftë se opSIONI është ushtruar, çdo diferencë midis vlerës kontabël (neto) të pasivit bashkëshoqërues dhe çmimit të ushtrimit njihet në fitim ose humbje.

Aktivet e matura me vlerën e drejtë

- (c) Në qoftë se një e drejtë opSIONI blerjeje, e mbajtur nga një njësi ekonomike, parandalon mosnjohjen e një aktivi të transferuar dhe njësisia ekonomike mat aktivitet e transferuar me vlerën e drejtë, atëherë aktivi vazhdon të matet me vlerën e tij të drejtë. Pasivi bashkëshoqërues matet me (i) çmimin e ushtrimit të opSIONIT pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT, në qoftë se opSIONI është në ose me mjete monetare, ose (ii) vlerën e drejtë të aktivitet të transferuar pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT, në qoftë se opSIONI është pa mjete monetare. Rregullimi për matjen e pasivit bashkëshoqërues siguron që vlera kontabël (neto) e aktivitet dhe e pasivit bashkëshoqërues të jetë vlera e drejtë e opSIONIT të blerjes (call). Për shembull, në qoftë se vlera e drejtë e aktivitet bazë është 80NJM, çmimi i ushtrimit të opSIONIT është 95NJM dhe vlera në kohë e parasë është 5NJM, atëherë vlera kontabël (neto) e pasivit bashkëshoqërues është 75NJM (80NJM – 5NJM) dhe vlera kontabël (neto) e aktivitet të transferuar është 80NJM (d.m.th. vlera e tij e drejtë).
- (d) Në qoftë se një opSION shitjeje (put) i paracaktuar nga një njësi ekonomike parandalon mosnjohjen e aktivitet të tranferuar dhe njësisia ekonomike mat aktivitet e transferuar me vlerën e drejtë, pasivi bashkëshoqërues matet me çmimin e ushtrimit të opSIONIT plus vlerën në kohë të opSIONIT. Matja e aktivitet me vlerën e drejtë është e kufizuar në vlerën më të ulët midis vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opSIONIT, sepse njësisia ekonomike nuk ka të drejtë për rritjen e vlerës së drejtë të aktivitet të transferuar mbi çmimin e ushtrimit të opSIONIT. Kjo bën të mundur që vlera kontabël (neto) e aktivitet dhe e pasivit bashkëshoqërues të jetë vlera e drejtë e detyrimit me opSIONI shitjeje (put). Për shembull, në qoftë se vlera e drejtë e aktivitet bazë është 120NJM, çmimi i ushtrimit të opSIONIT është 100NJM dhe vlera në kohë e parasë është 5NJM, atëherë vlera kontabël (neto) e pasivit bashkëshoqërues është 105NJM (100NJM + 5NJM) dhe vlera kontabël (neto) e aktivitet është 100NJM (në këtë rast çmimi i ushtrimit të opSIONIT).
- (e) Në qoftë se një opSION investimi mbrojtës, në formën e opSIONIT të blerë të blerjes dhe të paracaktuar të shitjes, parandalon mosnjohjen e një aktivi të transferuar dhe njësisia ekonomike mat aktivitet me vlerën e drejtë, atëherë ajo vazhdon të matë aktivitet me vlerën e tij të drejtë. Pasivi bashkëshoqërues matet me (i) shumën e çmimit të ushtrimit të opSIONIT të blerjes me vlerën e drejtë të opSIONIT të shitjes pakësuar me vlerën në kohë të opSIONIT të blerjes, në qoftë se opSIONI i blerjes është në ose me mjete monetare, ose me (ii) shumën e vlerës së drejtë të aktivitet me vlerën e drejtë të opSIONIT të shitjes pakësuar

me vlerën në kohë të opsionit të blerjes, në qoftë se opsioni është pa mjete monetare. Rregullimi për matjen e pasivit bashkëshoqërues siguron që vlera kontabël (neto) e aktivit dhe e pasivit bashkëshoqërues të jetë vlera e drejtë e opsionit të mbajtur dhe të paracaktuar nga njësi ekonomike. Për shembull, supozohet se një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar të matur me vlerën e drejtë, ndërsa njëkohësisht blerja e një opsioni blerjeje matet me çmimin e periudhës për 120NJM dhe nënshkrimi i një opsioni shitjeje matet me një çmim të periudhës për 80NJM. Supozohet gjithashtu se vlera e drejtë e aktivit është 100NJM në datën e transferimit. Vlerat në kohë të opsionit të shitjes dhe opsionit të blerjes janë përkatësisht 1NJM dhe 5NJM. Në këtë rast, njësi ekonomike njuh një aktiv për 100NJM (vlera e drejtë e aktivit) dhe një pasiv për 96NJM [(100NJM + 1NJM) – 5NJM]. Pra, vlera neto e aktivit është 4NJM, e cila është vlera e drejtë e opsioneve të mbajtur dhe të shkruar nga njësi ekonomike.

Të gjitha transferimet

- AG451 Në masën që transferimi i një aktivi nuk kualifikohet për mosnjohje, të drejtat kontraktuale të transferuesit ose detyrimet e lidhura me transferimin nuk trajtohen në mënyrë të veçantë si derivativë, nëse njohja edhe e derivativit, edhe e aktivit të transferuar ose pasivit, që rrjedh nga transferimi, do të bënte që të njiheshin dy herë të njëjtat të drejta ose detyrime. Për shembull, një opsion blerjeje i mbajtur nga transferuesi mund të parandalojë trajtimin e transferimit të aktiveve financiare si një shitje. Në këtë rast, opsioni i blerjes nuk njihet në mënyrë të veçantë si një aktiv derivativ.
- AG52 Në masën që transferimi i një aktivi financiar nuk kualifikohet për mosnjohje, marresi nuk e njuh aktivin e transferuar si aktivin e tij. Marresi çregjistron mjetet monetare ose shumën tjetër të paguar dhe njuh një shumë të arkëtueshme nga transferuesi. Në qoftë se transferuesi ka edhe të drejtën, edhe detyrimin për të rimarrë kontrollin e tërë aktivit të transferuar për një shumë të pandryshueshme (siç është në rastin e një marrëveshje riblerjeje), marresi duhet ta trajtojë shumën e tij të arkëtueshme si një hua ose llogari të arkëtueshme.

Shembuj

- AG53 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë zbatimin e parimeve për mosnjohje të këtij standardi.
- Marrëveshjet e riblerjes dhe huadhënia e letrave me vlerë.* Në qoftë se një aktiv financiar shitet sipas një marrëveshjeje për ta riblerë atë me një çmim të pandryshueshëm ose me një çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, ose në qoftë se ai merret hua sipas një marrëveshjejeje për t'ia kthyer transferuesit, ai nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në qoftë se marresi përfiton të drejtën e shitjes ose të vënies si garanci të aktivit, atëhere transferuesi e klasifikon aktivin në bilancin e tij, për shembull, si një aktiv të marrë hua ose si një shumë të arkëtueshme për riblerje.
 - Marrëveshjet e riblerjes dhe huadhënies të letrave me vlerë —aktivet që janë kryesisht të njëjta.* Në qoftë se një aktiv financiar shitet sipas një marrëveshjeje për të riblerë të njëjtin ose kryesisht të njëjtin aktiv, me një çmim të pandryshueshëm ose me një çmim shitjeje plus kthimin e huadhënësit, ose në qoftë se aktivi financiar merret hua sipas një marrëveshjejeje për të kthyer tek transferuesi të njëjtin ose kryesisht të njëjtin aktiv, ai nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
 - Marrëveshjet e riblerjes dhe huadhënies së letrave me vlerë - e drejta e zëvendësimit.* Në qoftë se një marrëveshjeje riblerjeje me një çmim riblerjeje të pandryshueshëm ose çmim të barabartë me atë të shitjes plus kthimin e huadhënësit, ose një transaksion i ngjashëm i huadhënies së letrave me vlerë, i jep të drejtën marresit të zëvendësojë aktivet që janë të ngjashëm dhe me vlerë të barabartë me aktivin e transferuar në datën e riblerjes, atëhere aktivi i shitur ose i dhënë hua në një transaksion riblerjeje ose të dhënies hua të letrave me vlerë nuk çregjistrohet, sepse transferuesi ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
 - E drejta e riblerjes së ofertës së parë me vlerë të drejtë.* Në qoftë se një njësi ekonomike shet një aktiv financiar dhe ruan vetëm të drejtën e ofertës së parë për të riblerë aktivin e transferuar me vlerën e drejtë, nëse marresi më vonë e shet atë, atëhere njësi ekonomike transferuese e çregjistron aktivin, sepse ajo ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

- (e) *Transaksion shitblerje i parregullt.* Riblerja e aktivitet financiar menjëherë pasi ai është shitur, shpeshherë, quhet si një transaksion shitblerjeje i parregullt. Një riblerje e tillë nuk përjashton kualifikimin për mosnjohje, me kusht që transaksioni fillimor të plotësojë kërkesat për mosnjohje. Megjithatë, në qoftë se një marrëveshje për të shitur një aktiv financiar është lidhur njëkohësisht me marrëveshjen për ta riblerë të njëjtin aktiv me një çmim të pandryshueshëm ose me çmimin e shitjes plus kthimin huadhënësit, atëherë aktivi nuk çregjistrohet
- (f) *Opsionet e shitjes dhe opsionet e blerjes që janë shumë të favorshme.* Në qoftë se aktivi financiar i transferuar mund të blihet përsëri nga transferuesi dhe opsioni i blerjes është shumë i favorshëm, transferimi nuk kualifikohet për mosnjohje, sepse transferuesi ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se aktivi financiar mund të shitet përsëri nga marresi dhe opsioni i shitjes është shumë i favorshëm, transferimi nuk kualifikohet për mosnjohje, sepse transferuesi ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
- (f) *Opsionet e shitjes dhe opsionet e blerjes që janë pa mjete monetare.* Një aktiv financiar i transferuar çregjistrohet kur ai është subjekt vetëm i një opsioni shitjeje pa mjete monetare i mbajtur nga marresi ose i një opsioni blerjeje pa mjete monetare i mbajtur nga transferuesi. Kjo ndodh sepse transferuesi i ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.
- (h) *Aktivet lehtësisht të përfutueshme që i nënshtrohen një opsioni blerjeje, i cili nuk është i favorshëm, as pa mjete monetare.* Në qoftë se një njësi ekonomike mban një opsion blerjeje mbi një aktiv që është lehtësisht i përfutueshëm në treg dhe ky opsion është as i favorshëm, as pa mjete monetare, atëherë aktivi çregjistrohet. Kjo sepse njësi ekonomike (i) as ka ruajtur, as ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, dhe (ii) nuk ka ruajtur kontrollin. Megjithatë, në qoftë se aktivi nuk është lehtësisht i përfutueshëm në treg, mosnjohja e tij shmanget deri në masën e shumës për të cilën aktivi është subjekt i opsionit të blerjes, sepse njësi ka ruajtur kontrollin e aktivitet.
- (h) *Një aktiv jo lehtësisht i përfutueshëm, që i nënshtrohet një opsioni shitjeje të shkruar nga një njësi ekonomike që nuk është i favorshëm dhe as pa mjete monetare.* Në qoftë se një njësi ekonomike transferon një aktiv financiar që është jo lehtësisht i përfutueshëm në treg, dhe ajo shkruan një kontratë me opsion shitjeje që nuk është pa mjete monetare, atëherë njësi ekonomike as ruan, as transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, për shkak të kontratës me opsion shitjeje të shkruar. Njësi ekonomike ruan kontrollin e aktivitet, në qoftë se kontrata me opsion shitjeje është mjaftueshëm e vlefshme për të parandaluar të transferuarin nga shitja e aktivitet, rast në të cilin aktivi vazhdon të njihet në masën e përfshirjes së vazhdueshme të transferuesit (shih paragrafin AG44). Njësi ekonomike transferon kontrollin e aktivitet në qoftë se kontrata me opsion shitjeje nuk është mjaftueshëm e vlefshme për të parandaluar të transferuarin nga shitja e aktivitet, rast në të cilin aktivi çregjistrohet.
- (j) *Aktivet që janë subjekt i opsionit të shitjes ose blerjes me vlerë të drejtë ose i një marrëveshjeje riblerjeje të ardhshme.* Transferimi i një aktivitet financiar, që është subjekt vetëm i një opsioni shitjeje ose blerjeje, ose i një marrëveshjeje riblerjeje të ardhshme, që ka një çmim të ushtrimit të opsionit ose të riblerjes baraz me vlerën e drejtë të aktivitet financiar në momentin e riblerjes, çon në mosnjohje, për shkak të transferimit kryesisht të të gjitha rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë.
- (k) *Opsione të blerjes ose të shitjes të shlyera në mjete monetare.* Një njësi ekonomike vlerëson transferimin e aktivitet financiar, që është subjekt i një opsioni shitjeje ose blerjeje, ose i një marrëveshjeje riblerjeje të ardhshme, që do të shlyhet neto në mjete monetare, për të përcaktuar nëse janë ruajtur ose transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë. Në qoftë se njësi ekonomike nuk ka ruajtur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitet të transferuar, ajo përcakton nëse ka ruajtur kontrollin e aktivitet të transferuar. Nëse nëseopsioni i shitjes ose i blerjes, ose marrëveshja e riblerjes së ardhshme shlyhet neto në mjete monetare, nuk do të thotë që vetvetiu njësi ekonomike ka transferuar kontrollin (shih paragrafet AG44 dhe (g), (h) dhe (i) më sipër).
- (l) *Heqja e llogarive të provizionit* Heqja e llogarive të provizionit është një opsion riblerjeje (blerjeje) i pakushtëzuar që i jep të drejtën një njësi ekonomike për të kërkuar (t'i kthehen) aktivet e transferuara që u nënshtrohen disa kufizimeve. Meqë një opsion i tillë bën që njësi ekonomike të mos ruajë, as të transferojë kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, ajo shmang mosnjohjen vetëm në masën e shumës që është subjekt i riblerjes (supozohet që marresi nuk mund të shesë aktivet). Për shembull, në qoftë se

vlera kontabël (neto) dhe shumat e marra nga transferimi i aktiveve hua janë 100,000NJM dhe çdo hua individuale mund të merret përsëri, por shuma totale e huave që mund të riblihen nuk mund të jetë më tepër se 10,000NJM, 90,000NJM të huave do të kualifikoheshin për mosnjohje.

- (m) *Opsionet me balancë minimale.* Një njësi ekonomike, e cila është në rolin e transferuesit, që shërben aktive të transferuara, mund të mbajë një opsion blerjeje me balancë minimale për të blerë aktivet e transferuara të mbetura, kur shuma e aktiveve në qarkullim bie në një nivel të specifikuar në të cilin kostoja e shërbimit të këtyre aktiveve bëhet më e madhe se përfitimet nga shërbimi. Meqë një opsion i tillë bën që njësia ekonomike të mos ruajë dhe as të transferojë kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë si dhe marresi nuk mund të shesë aktivet, ajo shmang mosnjohjen vetëm në masën e shumës së aktivit që është subjekt i opsionit të blerjes.
- (n) *Interesat e ruajtura të varura dhe garancitë e kredisë.* Një njësi ekonomike mund t'i japë marresit një aktiv që mbahet si garanci kredie nëpërmjet varësisë të disa ose të gjitha interesave të ruajtura në aktivin e transferuar. Në të kundërt, një njësi ekonomike mund t'i japë atij një aktiv, i cili mbahet si garanci kredie, në formën e një garancie kredie që mund të jetë e pakufizuar ose e kufizuar për një shumë të specifikuar. Në qoftë se një njësi ekonomike ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit të transferuar, aktivi vazhdon të njihet në tërësinë e tij. Në qoftë se njësia ekonomike ruan disa, por jo kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, si dhe ka ruajtur kontrollin, atëherë mosnjohja shmanget në masën e shumës së mjeteve monetare ose të aktiveve të tjera, që do t'i kërkohej të paguante njësia ekonomike.
- (o) *Swap-et e kthimit total.* Një njësi ekonomike mund të shesë një aktiv financiar tek marresi dhe të lidhë një kontratë shkëmbimi (swap) të të ardhurave gjithsej me marresin, me anën e të cilës të gjitha pagesat e interesit në mjete monetare, që rrjedhin nga aktivi bazë, i kalojnë njësisë ekonomike në shkëmbim të pagesave të pandryshueshme ose të ndryshueshme, ndërsa çdo rritje ose ulje në vlerën e drejtë të aktivit bazë përballohet nga njësia ekonomike. Në një rast të tillë, është i ndaluar kualifikimi për mosnjohje të të gjithë aktivit.
- (p) *Swap-et e normës së interesit.* Një njësi ekonomike mund të transferojë tek marresi një aktiv financiar me normë interesi të pandryshueshme dhe të lidhë me të një kontratë swap për norma interesi për të arkëtuar norma interesi të pandryshueshme dhe të paguajë norma interesi të ndryshueshme bazuar në një shumë imagjinare, që është baraz me shumën e principalit të aktivit financiar të transferuar. Swap i normës së interesit nuk përjashton kualifikimin për mosnjohje të aktivit të transferuar duke bërë që pagesat mbi swap-in të mos jenë të kushtëzuara nga pagesat e bëra për aktivin e transferuar.
- (p) *Swap-et e shlyerjes (amortizimit) së normës së interesit.* Një njësi ekonomike mund të transferojë tek marresi një aktiv financiar me normë interesi të pandryshueshme, që ndërkohë është shlyer, dhe lidh me të një swap të shlyerjes së normave të interesit për të arkëtuar norma interesi të pandryshueshme dhe për të paguar norma interesi të ndryshueshme bazuar në një shumë imagjinare. Në qoftë se shuma imagjinare e swap-it shlyhet (amortizohet) në mënyrë të tillë që barazon në çdo kohë me shumën e principalit të aktivit financiar të transferuar të pashlyer, swap në përgjithësi bën që njësia ekonomike të ketë rrezikun kryesor të parapagimit, rast në të cilin njësia ekonomike ose vazhdon të njohë të gjithë aktivin e transferuar, ose vazhdon të njohë aktivin e transferuar deri në masën e përfshirjes të vazhdueshme. Në të kundërt, në qoftë se amortizimi i shumës imagjinare të swap-it nuk është i lidhur me shumën e principalit të pashlyer të aktivit të transferuar, një swap i tillë nuk bën që njësia ekonomike të ketë rrezikun e parapagimit mbi aktivin. Pra, nuk përjashtohet kualifikimi për mosnjohje i aktivit të transferuar meqë pagesat mbi swap-in nuk janë të kushtëzuara nga pagesat e bëra për aktivin e transferuar dhe swap-i nuk bën që njësia ekonomike të ketë ndonjë tjetër rrezik dhe përfitim të pronësisë mbi aktivin e transferuar.

AG54 Ky paragraf ilustron zbatimin e metodës së përfshirjes së njësisë ekonomike, kur kjo përfshirje e saj është në një pjesë të aktivit financiar.

Supozohet se një njësi ekonomike ka një portofol huash të parapagueshme, kuponi i të cilit dhe norma e interesit efektiv është 10 për qind, ndërsa shuma e principalit dhe kostoja e amortizuar është 10,000NJM. Ajo hyn në një transaksion në të cilin, në kthim të një pagese për 9,115NJM, marresi përfton të drejtën për 9,000NJM nga secili prej arkëtimeve të principalit plus interesin e lidhur me këtë për 9.5 për qind. Njësia ekonomike ruan të drejtat për 1,000NJM nga secili prej arkëtimeve të principalit plus interesin e lidhur me këtë për 10 për qind, plus marzhin e tepërt prej 0.5 për qind mbi pjesën e mbetur të principalit për 9,000NJM.

Arkëtimet nga parapagimet shpërndahen midis njësisë ekonomike dhe marresit proporcionalisht në raportin 1:9, por çdo shlyerje e vonuar zbritet nga interesi i njësisë ekonomike prej 1,000NJM, derisa interesi të mbarojë. Vlera e drejtë e huave në datën e transaksionit është 10,100NJM dhe vlera e drejtë e çmuar e marzhit të tepërt prej 0.5 për qind është 40NJM.

Njësia ekonomike përcakton që ka transferuar një sërë rreziqesh dhe përfitimesh të rëndësishme të pronësisë (për shembull, rrezikun e rëndësishëm të parapagimit), por ka ruajtur, gjithashtu, disa prej këtyre rreziqeve dhe përfitimeve të rëndësishme të pronësisë (për shkak të interesit të ruajtur të varur) si dhe ka ruajtur kontrollin. Prandaj, ajo zbaton metodën e përfshirjes së vazhdueshme.

Për të zbatuar këtë standard, njësia ekonomike e analizon transaksionin si (a) mbajtje të interesit të ruajtur plotësisht të përpjesëtuar prej 1,000NJM, plus (b) varësinë e këtij interesi të ruajtur për të siguruar një aktiv për garanci kredie për humbjet e kredisë tek marresi.

Njësia ekonomike llogarit që 9,090NJM (90 për qind \times 10,100NJM) të shumës së arkëtuar prej 9,115NJM përfaqëson shumën që i takon përpjesëtimit të plotë prej 90 për qind. Pjesa e mbetur e shumës së arkëtuar (25NJM) përfaqëson shumën e arkëtuar nga varësia e interesit të ruajtur për të siguruar një aktiv për garanci kredie për humbjet e kredisë tek marresi. Përveç kësaj, marzhi i tepërt prej 0.5 për qind përfaqëson shumën e arkëtuar për garanci kredie. Kështu, shuma gjithsej e arkëtuar për garanci kredie është 65NJM (25NJM + 40NJM).

Njësia ekonomike llogarit fitimin dhe humbjen neto nga shitja e 90 për qind të flukseve të mjeteve monetare. Duke supozuar se vlerat e drejta të veçanta për 90 për qind të pjesës së transferuar dhe 10 për qind të pjesës së ruajtur nuk janë të disponueshme në datën e transferimit, njësia ekonomike shpërndan vlerën kontabël (neto) të aktivit në përputhje me paragrafin 28, si më poshtë:

	<i>Vlera e drejtë e çmuar</i>	<i>Përqindja</i>	<i>Vlera kontabël (neto) e shpërndarë</i>
Pjesa e transferuar	9,090	90%	9,000
Pjesa e ruajtur	1,010	10%	1,000
Totali	10,100		10,000

Njësia ekonomike llogarit fitimin ose humbjen neto të saj nga shitja e 90 për qind të flukseve të mjeteve monetare duke zbritur nga shuma e arkëtuar vlerën kontabël (neto) të shpërndarë të pjesës së transferuar, d.m.th. 90NJM (9,090NJM – 9,000NJM). Vlera kontabël (neto) e pjesës së ruajtur nga njësia ekonomike është 1,000NJM.

Përveç kësaj, njësia ekonomike njih përfshirjen e vazhdueshme, që rrjedh nga varësia e interesit të ruajtur për humbjet e kredisë. Kështu, ajo njih një aktiv për 1,000NJM (maksimumi i shumës së flukseve të mjeteve monetare që nuk do të arkëtohej sipas varësisë), dhe një pasiv bashkëshoqërues prej 1,065NJM (që është maksimumi i shumës së flukseve të mjeteve monetare varësisë, d.m.th. 1,000NJM plus vlerën e drejtë të varësisë prej 65NJM).

Njësia ekonomike përdor të gjithë informacionin e mësipërm për të kontabilizuar transaksionin si më poshtë:

	<i>Debi</i>	<i>Kredi</i>
Aktivi origjinal	–	9,000
Aktivitet e njohura sipas varësisë ose interesi i mbetur	1,000	–
Aktivitet për shumën e arkëtuar në formën e marzhit të tepërt	40	–

Fitim ose humbje (fitim neto nga transferimi)	–	90
Pasivi	–	1,065
Mjete monetare të arkëtuara	9,115	–
Totali	10,155	10,155

Menjëherë duke ndjekur transaksionin, vlera kontabël (neto) e aktivit është 2,040 NJM përbërë nga 1,000 NJM, që përfaqëson koston e shpërndarë të pjesës së ruajtur, dhe 1,040NJM, që përfaqëson përfshirjen e vazhdueshme shtesë të njësisë ekonomike në varësi të interesit të ruajtur të saj për humbjet e kredisë (e cila përfshin marzhin shtesë prej 40NJM).

Në periudhat e mëpasshme, njësia ekonomike njihet duke përdorur garanci kredie (65NJM) mbi bazë përpjesëtimore me kohën, interesin e konstatuar nga njohja e aktivit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe një çdo zhvlerësim të kredisë mbi aktivin e njohur. Për të sqaruar këtë të fundit, supozohet që në vitin në vazhdim ka një humbje nga zhvlerësimi i kredisë mbi bazën e huave bazë prej 300NJM. Njësia ekonomike e zvogëlon aktivin e saj të njohur me 600NJM (300NJM në lidhje me interesin e ruajtur dhe 300NJM në lidhje me përfshirjen shtesë të vazhdueshme që rrjedh nga varësia e interesit të saj të ruajtur për humbjet e kredisë), dhe zvogëlon pasivin e njohur me 300NJM. Rezultati neto është rëndimi i fitimit ose humbjes me zhvlerësimin e kredisë prej 300NJM.

Mënyra e rregullt e blerjes ose e shitjes së një aktivi financiar (paragrafi 38)

- AG53 Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e aktiveve financiare njihet duke përdorur kontabilizimin në datën e tregtimit, ose kontabilizimin në datën e shlyerjes siç përshkruhet në paragrafet AG55 dhe AG56. Metoda e përdorur zbatohet vazhdimisht për të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që i përkasin të njëjtës kategori të aktiveve financiare, siç përkufizohen në paragrafin 9. Për këtë qëllim, aktivet e mbajtura për tregtim formojnë një kategori të veçantë të përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- AG54 Një kontratë që kërkon ose lejon të bëhet shlyerje për vlerë neto të ndryshimit në vlerën e kontratës nuk është kontratë e mënyrës së rregullt. Në fakt, një kontratë e tillë trajtohet si një derivativ në periudhën midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes.
- AG55 Datë tregtimi është data që një njësi ekonomike angazhon vetveten për të blerë ose shitur aktivin. Kontabilizimi në datën e tregtimit i referohet (a) njohjes së një aktivi për t'u arkëtuar dhe pasivit për t'u paguar në datën e tregtimit, dhe (b) mosnjohjes së një aktivi që është shitur, njohjen e çdo fitimi ose humbje neto nga shitja dhe njohjen e një shume të arkëtueshme nga blerësi për pagesën e bërë në datën e tregtimit. Në përgjithësi, interesi nuk fillon të konstatohet mbi aktivin dhe pasivin korrespondues deri në datën e shlyerjes kur kalon titulli.
- AG56 Data e shlyerjes është data që një aktiv livrohët tek ose nga një njësi ekonomike. Kontabilizimi në datën e shlyerjes i referohet (a) njohjes së një aktivi në datën kur ai përftohet nga njësi ekonomike dhe (b) mosnjohjes së një aktivi dhe njohjen çdo fitimi ose humbje neto nga shitja në datën që ai livrohët nga njësi ekonomike. Kur zbatohet kontabilizimi në datën e shlyerjes, njësi ekonomike kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivit, që do të përftohet gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes, në të njëjtën mënyrë siç kontabilizohet një aktiv i blerë. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivet e mbajtura me kosto ose kosto të amortizuara; njihet në fitim ose humbje për aktivet e klasifikuar si aktive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe njihet në kapitalin neto për aktivet e vlefshme për shitje.

Mosnjohja e aktivit financiar (paragrafet 39–42)

- AG57 Një pasiv financiar (ose pjesë e tij) është i dallueshëm kur një debitor ose:

- (a) e shlyen pasivin (ose pjesën e tij) duke paguar kreditorin, zakonisht me mjete monetare, aktive financiare të tjera, mallra ose shërbime; ose
- (b) ligjërisht është i çliruar nga përgjegjësia kryesore për pasivin (ose pjesën e tij) si nëpërmjet procesit gjyqësor, ose nga kreditori. (Në qoftë se debitori ka dhënë një garanci ky kusht mundet ende të plotësohet.)
- AG58 Në qoftë se një emetues i një instrumenti borxhi riblen instrumentin, borxhi shlyhet edhe në qoftë se emetuesi është një krijues tregu i këtij instrumenti ose synon ta rishesë atë në të ardhmen e afërt.
- AG59 Pagesa ndaj një pale të tretë, përfshirë një njësi besimi (disa herë i quajtur ‘anullim në thelb’), në vetvete nuk e lehtëson debitorin nga detyrimi kryesor ndaj kreditorit, në mungesë të çlirimit ligjor.
- AG60 Në qoftë se një debitor paguan një palë të tretë për të marrë përsipër një detyrim dhe e njofton kreditorin e tij që pala e tretë ka marrë përsipër detyrim e borxhit të tij, debitori duhet të çregjistrojë detyrimin e borxhit vetëm nëse plotësohet kushti në paragrafin AG57(b). Në qoftë se debitori paguan një palë të tretë për të marrë përsipër një detyrim dhe përfiton një çlirim ligjor nga kreditori i tij, debitori ka shlyer borxhin. Megjithatë, në qoftë se debitori është dakord t’i paguajë borxhin një pale të tretë ose direkt kreditorit të tij origjinal, debitori njeh një detyrim borxhi të ri ndaj një pale të tretë.
- AG61 Ndonëse çlirimi ligjor, nëse juridikisht ose nga kreditori, çon në mosnjohjen (çregjistrimin) e një pasivi, njësia ekonomike mund të njohë një pasiv të ri, nëse nuk plotësohet kriteri i mosnjohjes (çregjistrimit) i dhënë në paragrafet 15–37 për aktivet e transferuara. Në qoftë se kriteri nuk plotësohet, aktivi i transferuar nuk çregjistrohet, dhe njësia ekonomike njeh një pasiv të ri në lidhje me aktivet e transferuara.
- AG62 Në përputhje me qëllimin e paragrafit 40, termat janë plotësisht të ndryshëm në qoftë se vlera aktuale e skontuar e flukseve të mjeteve monetare sipas termave të reja, përfshirë edhe ndonjë tarifë të paguar neto për çdo tarifë të arkëtuar dhe të skontuar duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10 përqind e ndryshme nga vlera aktuale e skontuar e flukseve të mjeteve monetare të mbetura të pasivit financiar fillimor. Në qoftë se një shkëmbim i instrumentave të borxhit ose modifikim i termave trajtohet si një shlyerje, çdo kosto ose tarifë e kryer njihet si një pjesë e fitimit ose humbjes neto nga shlyerja. Në qoftë se një shkëmbim ose modifikim nuk trajtohet si një shlyerje, çdo kosto ose tarifë e kryer rregullon vlerën kontabël neto të pasivit dhe amortizohet për periudhën e mbetur të pasivit të modifikuar.
- AG63 Në disa raste, një kreditor e liron një debitor nga detyrimi i tij aktual për të bërë pagesa, ndërsa debitori merr përsipër një detyrim garancie për të paguar, nëse pala, e cila konsiderohet se ka përgjegjësinë kryesore, nuk i përmbush detyrimet. Në këto rrethana debitori:
- (a) njeh një pasiv financiar të ri bazuar në vlerën e drejtë të detyrimit të tij për garanci; dhe
- (b) njeh një fitim ose humbje neto bazuar në diferencën midis (i) shumave të paguara nga ana e shitësit dhe (ii) vlerës kontabël (neto) të detyrimit financiar fillimor pakësuar me vlerën e drejtë të pasivit financiar të ri.

Matja (paragrafet 43–70)

Matja fillestare e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare (paragrafi 43)

- AG64 Vlera e drejtë e aktivit financiar në njohje fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë, shih gjithashtu paragrafin AG76). Megjithatë, në qoftë se pjesa e shumës së dhënë ose të marrë është për diçka tjetër se sa për instrumentin financiar, vlera e drejtë e instrumentit financiar çmohet, duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafet AG74–AG79). Për shembull, vlera e drejtë e një huaje afatgjatë ose shume të arkëtueshme, që nuk mbart interes, mund të çmohet si vlera aktuale e të gjitha të hyrave të ardhshme të skontuara të mjeteve monetare duke përdorur normën mbizotëruese të tregut të interesit për një instrument të ngjashëm (i ngjashëm përsa i përket monedhës, afatit, llojit të normës së interesit dhe faktorëve të tjerë) me një klasifikim të ngjashëm të kredisë. Çdo shumë shtesë e huazuar është një shpenzim ose një zvogëlim e të ardhura me përjashtim kur ajo kualifikohet për njohje si një lloj tjetër aktivi.
- AG65 Në qoftë se një njësi ekonomike jep (krijon) një hua që mbart një normë interesi nën atë të tregut (p.sh. 5% kur norma e tregut për të njëjtën hua është 8%), dhe arkëton një shumë të parapaguar si kompensim, njësia ekonomike njeh huanë me vlerën e saj të drejtë, d.m.th. neto nga shuma që ajo

merr. Njësia ekonomike e rrit zbritjen nga fitimi ose humbja duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare (paragrafet 45 dhe 46)

- AG66 Në qoftë se instrumenti financiar, që është njohur më parë si një aktiv financiar, matet me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë e tij bie nën zero, ai është një pasiv financiar që matet në përputhje me paragrafin 47.
- AG67 Shembulli i mëposhtëm ilustron kontabilitetin për kostot e transaksionit në matjen fillestare dhe të mëpasshme të një aktivi financiar të vlefshëm për shitje. Një aktiv është blerë për 100NJM plus një komision blerje prej 2NJM. Fillimisht, aktivi njihet me një vlerë 102NJM. Data e afërt e raportimit financiar është një ditë më pas, kur çmimi i tregut i kuotuar i aktivitetit është 100NJM. Në qoftë se aktivi shitet, paguhet një komision prej 3NJM. Në këtë datë, aktivi matet me 100NJM (pa marrë parasysh komisionin e mudshëm të shitjes) dhe njihet një humbje në kapitalin neto për 2NJM. Në qoftë se për aktivin financiar të vlefshëm për shitje bëhen pagesa të pandryshueshme ose të përcaktuara, kostot e transaksionit amortizohen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në qoftë se për aktivin financiar të vlefshëm për shitje nuk bëhen pagesa të pandryshueshme ose të përcaktuara, kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet ose zhvlerësohet.
- AG68 Instrumentet që klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme maten me koston e amortizuar pa marrë parasysh synimin që ka njësia ekonomike për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Matja me vlerën e drejtë të shumave (paragrafet 48–49)

- AG69 Përkufizimi bazë i vlerës së drejtë presupozon që një njësi ekonomike funksionon në vijimësi pa patur synimin ose nevojën që të likuidohet, të ndërpresë materialisht shkallën e aktiviteteve të saj ose të ndërmarrë një transaksion në kushte të pavolitshme. Vlera e drejtë nuk është, pra, shuma që një njësi ekonomike do të kishte arkëtuar ose paguar në një transaksion të detyruar, likuidim të pavullnetshëm ose shitje me zbritje. Megjithatë, vlera e drejtë pasqyron cilësinë e kredisë të instrumentit.
- AG70 Ky standard përdor termat 'çmim oferte' dhe 'çmimi i ofruar' (disa herë i quajtur edhe si 'çmim aktual i ofertës') në kontekstin e çmimit të tregut i kuotuar, dhe termin 'marzhi midis çmimit të kërkuar dhe të ofruar' për të përfshirë vetëm kostot e transaksionit. Rregullimet e tjera që bëhen për të arritur tek vlera e drejtë (p.sh. rreziku i kredisë për palën tjetër) nuk përfshihen në termin 'marzhi midis çmimit të kërkuar dhe të ofruar'.

Tregu aktiv: çmimi i kuotuar

- AG71 Një instrument financiar konsiderohet si i kuotuar në një treg aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të gatshëm dhe vazhdimisht të disponueshëm nga një këmbim, shitës, broker, grup industrie, agjenci e vlerësimit të shërbimit ose rregullatore, dhe ato çmime që paraqesin kryerjen reale dhe në mënyrë të rregullt të transaksioneve të tregut midis palëve të palidhura me njeri-tjetrin. Vlera e drejtë përkufizohet duke u shprehur si një çmim i pranuar nga një blerës i vullnetshëm, dhe nga një shitës i vullnetshëm në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njeri-tjetër. Objektivi i përcaktimit të vlerës së drejtë për një instrument financiar, që tregtohet në një treg aktiv, është që të arrihet në një çmim me të cilin transaksioni me këtë instrument (d.m.th. pa u modifikuar ose u ripërpunuar) do të kishte ndodhur në datën e bilancit në tregun aktiv më fitimprurës në të cilin njësia ekonomike ka mundësi hyrjeje të drejtpërdrejtë. Megjithatë, njësia ekonomike rregullon çmimin në tregun më fitimprurës për të reflektuar ndonjë diferencë në rrezikun e kredisë të palës tjetër midis instrumenteve të tregtuar në këtë treg dhe atyre të vlerësuar. Ekzistenca e kuotimeve të publikuara të çmimeve në një treg aktiv është evidenca më e mirë e vlerës së drejtë dhe kur ato ekzistojnë përdoren për të matur aktivet financiare ose pasivet financiare.
- AG72 Çmimi i tregut i kuotuar, i përshtatshëm për një aktiv të mbajtur ose një pasiv për t'u shlyer, është zakonisht çmimi aktual i ofertës dhe për një aktiv që blihet ose pasiv që mbahet është çmimi i kërkuar. Kur një njësi ka aktive dhe pasive për kompensim të rreziqeve të tregut, mund të përdoret çmimi mesatar i tregut si bazë për të vendosur vlerën e drejtë për gjendjet e rrezikut të kompensimit dhe zbaton çmimin e ofertës ose çmimin e kërkuar mesatar si më të përshtatshmin në çeljen neto.

Kur çmimi aktual i ofruar dhe çmimi i kërkuar nuk janë të disponueshëm, çmimi i transaksionit më të fundit përbën evidencën e vlerës së drejtë aktuale për atë kohë sa nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në rrethanat ekonomike qysh nga koha e kryerjes së transaksionit. Në qoftë se kushtet kanë ndryshuar qysh nga koha e kryerjes së transaksionit (p.sh. një ndryshim në normën e interesit pa rrezik ndjek në vijim çmimin më të fundit të kuotuar për një obligacion të korporatës), vlera e drejtë pasqyron në mënyrën e duhur ndryshimin në kushtet duke iu referuar çmimeve aktuale ose normave aktuale të instrumenteve financiare të ngjashëm. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se njësi ekonomike mund të vërtetohet se çmimi i transaksionit më të fundit nuk është vlera e drejtë (p.sh. sepse ajo pasqyron vlerën që një njësi ekonomike do të arkëtonte ose paguante në një transaksion të detyruar, likuidim të pavullnetshëm ose shitje me zbritje), atëherë çmimi rregullohet. Vlera e drejtë e një protofoli të instrumenteve financiare është produkt i numrit të njësisve të instrumentit dhe i çmimit të tij të kuotuar të tregut. Në qoftë se kuotimi i publikuar i çmimit në një treg aktiv nuk ekziston për një instrument financiar në tërësinë e tij, por ekziston për pjesët përbërëse të tij, vlera e drejtë përcaktohet në bazë të çmimit përkatës të tregut për pjesët përbërëse.

- AG73 Në qoftë se norma (përveç çmimit) është e kuotuar në një treg aktiv, njësi ekonomike përdor këtë normë tregu të kuotuar si një e dhene në teknikën e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë. Në qoftë se norma e tregut e kuotuar nuk përfshin rrezikun e kredisë ose faktorë të tjerë që pjesëmarrësit e tregut do të përfshinin në vlerësimin e instrumentit, njësi ekonomike e rregullon për këta faktorë.

Treg jo aktiv: teknikë vlerësimi

- AG74 Në qoftë se për një instrument financiar nuk ka treg aktiv, një njësi ekonomike vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të tregut, të kryera midis palëve të ditura, të vullnetshme, të palidhura me njera-tjetrën, në qoftë se është e mundur, duke iu referuar vlerës së drejtë aktuale të një instrumenti tjetër që në thelb është i njëjtë, analizat e fluksit monetar të skontuar dhe modelat e vlerësimit të opsionit. Në qoftë se ka një teknikë vlerësimi që zakonisht përdoret nga pjesëmarrësit e tregut për të vendosur çmimin e instrumentit dhe është vërtetuar që ajo siguron çmuarje të besueshme të çmimeve që përftohen në transaksionet e tregut aktual, atëherë njësi ekonomike e përdor këtë teknikë.
- AG75 Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është që vendoset se cili do të ishte çmimi i transaksionit në datën e matjes në një shkëmbim midis palëve të palidhura, të motivuara nga konsideratat e një biznesi normal. Vlera e drejtë çmohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të njësisë ekonomike. Një teknikë vlerësimi pritet që të arrijë në një çmuarje realiste të vlerës së drejtë në qoftë se (a) ajo pasqyron në mënyrë të arsyeshme se si tregu do të mund të parashikonte çmimin e instrumentit dhe (b) inputet për teknikën vlerësimit pasqyrojnë, në mënyrë të arsyeshme, pritshmëritë e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut të kthimit të genësishëm në instrumentin financiar.
- AG76 Pra, një teknikë vlerësimi (a) përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të mermin parasysh në vendosjen e çmimit dhe (b) është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranuar për caktimin e çmimit të instrumenteve financiare. Periodikisht, një njësi ekonomike kalibron teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmërinë duke përdorur çmimet nga çdo transaksion aktual tregu të mbikëqyruar në të njëjtin instrument (d.m.th. pa bërë modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në të dhënat e disponueshme të tregut të mbikëqyruar. Një njësi ekonomike merr të dhëna tregu vazhdimisht në të njëjtin treg ku është krijuar ose është blerë instrumenti financiar. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar, në njohjen fillestare, është çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë), nëse vlera e drejtë e këtij instrumenti nuk është evidencuar nga krahasimi me transaksione të tjera aktuale të tregut të mbikëqyruar për të njëjtin instrument (d.m.th. pa bërë modifikim ose ripërpunim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi variablat e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyruara.
- AG76A Matja e mëpasshme e një aktivi financiar ose pasivi financiar dhe njohja e mëpasshme e fitimeve ose humbjeve neto do të bëhet në përputhje me kërkesat e këtij standardi. Zbatimi i paragrafit AG76 do të bënte që të mos njihet fitim ose humbje neto në njohjen fillestare të një aktivi financiar ose pasivi financiar. Në një rast të tillë, SNK 39 kërkon që fitimi ose humbja neto të njihet pas njohjes fillestare vetëm në atë masë që ajo rrjedh nga një ndryshim në një faktor (përfshirë edhe kohën), që pjesëmarrësit e tregut do ta mermin parasysh në caktimin e çmimit.
- AG77 Blerja fillestare ose krijimi i një aktivi financiar apo lindja e një detyrimi financiar është një transaksion tregu që përbën bazën për çmuarjen e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar. Në

veçanti, në qoftë se një instrument financiar është një instrument borxhi (siç është huaja), vlera e drejtë e tij mund të përcaktohet duke iu referuar kushteve të tregut, që kanë ekzistuar në datën e blerjes ose të krijimit të tij, dhe kushteve aktuale të tregut ose normave të interesit, që aktualisht përdoren nga njësia ekonomike, ose nga instrumente borxhi të tjera të ngjashme (d.m.th. të ngjashëm përsa i përket maturimit të mbetur, modelit të fluksit monetar, monedhës, rrezikut të kredisë, kolateralit dhe bazës së interesit). Në të kundërt, nëse nuk ka ndonjë ndryshim në rrezikun e kredisë të debitorit dhe në marzhin e zbatueshëm të kredisë pas krijimit të instrumentit të borxhit, mund të bëhet një çmuarje e normës aktuale të interesit të tregut duke përdorur një normë interesi bazë që pasqyron më mirë cilësinë e kredisë se sa instrumenti i borxhit bazë, duke mbajtur marzhin e kredisë konstant dhe duke e rregulluar për ndryshimin në normën bazë të interesit nga data e origjinës. Në qoftë se kushtet kanë ndryshuar qysh nga koha e kryerjes së transaksionit më të fundit, ndryshimi korrespondues në vlerën e drejtë të instrumentit financiar, që është i vlerësuar, përcaktohet duke iu referuar çmimeve aktuale ose normave aktuale për instrumente të ngjashëm, rregulluar sipas mënyrës së duhur, për çfarëdo diferencë nga instrumenti që është i vlerësuar.

AG78 I njëjti informacion mund të mos jetë i nevojshëm në secilën datë të matjes. Për shembull, në datën që njësia ekonomike jep një hua ose blen një instrument borxhi që nuk tregtohet aktivisht, njësia ekonomike ka një çmim transaksioni që është, gjithashtu, edhe çmim tregu. Megjithatë, në datën tjetër të matjes mund të mos ketë informacion për ndonjë transaksion të ri dhe ndonjë njësia ekonomike mund të përcaktojë nivelin e përgjithshëm të normës së interesit të tregut, ajo nuk mund të dijë çfarë niveli të kredisë ose rrezik tjetër do të merrnin parasysh pjesëmarrësit e tregut në caktimin e çmimit të instrumentit në këtë datë. Një njësia ekonomike mund të mos ketë informacion për transaksionet më të fundit për të përcaktuar marzhin e duhur të kredisë mbi normën bazë të interesit që ta përdorur në përcaktimin e normës së skontimit për llogaritjen e vlerës aktuale. Do të ishte e arsyeshme të supozohej, në mungesë të evidencës për të kundërtën, që nuk kanë ndodhur ndryshime në marzhin që ka qenë në datën kur është dhënë hua. Megjithatë, njësia ekonomike do të duhej të bënte përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse ka një evidencë që tregon se ka ndryshim në këta faktorë. Kur ka një evidencë se ka ndodhur ndryshimin, njësia ekonomike do duhej të merrte parasysh efektet e ndryshimit në përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentit financiar.

AG79 Kur bëhen analizat e fluksit monetar të skontuar, një njësia ekonomike përdor një ose më shumë norma skontimi të barabarta me normat mbizotëruese të kthimit për instrumentet financiare, që në thelb kanë të njëjtët terma dhe karakteristika, përfshirë cilësinë e kredisë së instrumentit, kohën e mbetur për të cilën norma e interesit kontraktual është e pandryshueshme, koha e mbetur për ripagim të principalit dhe monedhën në të cilën bëhen pagesat. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme afatshkurtëra, që nuk kanë normë interesi të shpallur, mund të maten me shumën fillestare të faturës, në qoftë se ndikimi i skontimit është jomaterial.

Treg jo aktiv: instrumente kapitali neto

AG80 Vlera e drejtë e investimeve në instrumente kapitali neto, që nuk kanë çmim tregu të kuotuar në një treg aktiv, dhe derivativëve të lidhur me ta, që duhet të shlyhen me anën e livrimit të një instrumenti të tillë kapitali neto të kuotuar (shih paragrafet 46(c) dhe 47), është e matshme në mënyrë të besueshme në qoftë se a) ndryshueshmëria në intervalin e çmuarjeve të besueshme të vlerës së drejtë nuk është e ndjeshme për këtë instrument ose (b) probabilitetet e çmuarjeve të ndryshme brenda intervalit mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme dhe të përdoren në çmuarjen e vlerës së drejtë.

AG81 Ka shumë situata në të cilat ndryshueshmëria në intervalin e çmuarjeve të arsyeshme të vlerës së drejtë të investimeve në instrumente kapitali neto, që nuk kanë çmim tregu të kuotuar, dhe derivativëve të lidhur me ta, që duhet të shlyhen me anën e livrimit të një instrumenti të tillë kapitali neto të pakuotuar (shih paragrafet 46(c) dhe 47), ka të ngjarë të mos jetë e rëndësishme. Normalisht, është e mundur të çmohet vlera e drejtë e një aktivi financiar që një njësia ekonomike ka blerë nga një palë e jashtme. Gjithsesi, në qoftë se intervali i çmuarjeve të besueshme të vlerës së drejtë është i rëndësishëm dhe probabilitetet e çmuarjeve të ndryshme nuk mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme, një njësia ekonomike përjashtohet nga matja e instrumentit me vlerën e drejtë.

Inputet për teknikat e vlerësimit

AG82 Një teknikë e përshtatshme për çmuarjen e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar të veçantë duhet të përfshijë të dhënat e tregut të mbikëqyrur mbi kushtet e tregut dhe faktorët e tjerë, që kanë

mundësi të prekin vlerën e drejtë të instrumentit. Vlera e drejtë e instrumentit financiar do të bazohet në një ose më shumë prej faktorëve të mëposhtëm (ndoshta edhe në faktorë të tjerë).

- (a) *Vlera në kohë e parasë (d.m.th. interesi bazë ose pa rrezik).* Normat bazë të interesit, zakonisht, mund të rrjedhin nga çmimet e obligacioneve qeveritare të mbikëqyrura dhe shpesh janë të kuotuar në botimet financiare. Këto norma ndryshojnë në mënyrë tipike nga të dhënat e pritshme të flukseve monetare të projektuara përgjatë kurbës të normave të interesit për një periudhë kohe të ndryshme. Për arsye praktike, një njësi ekonomike mund të përdorë një normë të përgjithshme lehtësisht të krahasueshme dhe të mirëpranuar, siç është LIBOR ose norma swap, si një normë bazë. (Meqë një normë e tillë si LIBOR nuk është një normë interesi pa rrezik, rregullimi për rrezikun e kredisë në përshtatje me instrumentin financiar të veçantë përcaktohet mbi bazën e rrezikut të saj të kredisë në lidhje me rrezikun e kredisë në normën bazë të saj.) Në disa vende, obligacionet e qeverisë qendrore mund të mbartin një rrezik kredie të rëndësishëm dhe mund të mos sigurojnë një normë interesi bazë të qëndrueshme për instrumentet e shprehura në këtë monedhë. Disa njësi ekonomike në këto vende mund të kenë një qëndrueshmëri më të mirë të kredisë dhe normë interesi më të ulët të huamarrjes, sesa qeveria qendrore. Në të tilla raste, normat bazë të interesit mund të jenë të përcaktuara në mënyrë më të përshtatshme, sipas referimeve në normat e interesit për obligacionet e korporatës, me norma më të larta interesi, të emetuara në monedhën e këtij juridiksioni.
- (b) *Rreziku i kredisë.* Ndikimi mbi vlerën e drejtë të rrezikut të kredisë (d.m.th. primi mbi normën bazë të interesit për rrezikun e kredisë) mund të rrjedhë nga çmimet e tregut të mbikëqyruar për instrumentet e tregtueshëm me cilësi kredie të ndryshme ose nga normat e interesit të mbikëqyruar të mbartura nga huadhënësit për huatë e klasifikimeve të ndryshme të kredisë.
- (c) *Çmimet e këmbimit në monedhë të huaj.* Tregjet aktive të këmbimit të monedhës ekzistojnë për monedhat kryesore dhe çmimet kuotohen përditë në botimet financiare.
- (d) *Çmimet e mallrave.* Ka çmime tregu të mbikëqyruar për shumë mallra.
- (e) *Çmimet për kapitalin neto.* Çmimet (dhe indekset e çmimeve) të instrumenteve kapitali neto të tregtueshëm janë lehtësisht të mbikëqyrshëm në shumë tregje. Vlera aktuale e bazuar në teknika mund të përdoret për të çmuar çmimin e tregut të instrumenteve të kapitalit neto për të cilët nuk ka çmime të mbikëqyruar.
- (f) *Luhatshmëria (d.m.th. madhësia e ndryshimeve të ardhshme në çmimet e instrumenteve financiare ose të ndonjë zëri tjetër).* Matjet e luhatshmërisë së zërave të tregtueshëm në mënyrë aktive mund të jenë të çmuar në mënyrë të arsyeshme mbi bazën e të dhënave historike të tregut ose duke përdorur luhatjet e nënkuptuara në çmimet aktuale të tregut.
- (g) *Rreziku i parapagimit dhe rreziku i heqjes dorë.* Modelet e parapagimit të pritshëm për aktivet financiare dhe modelet e pritshme të heqjes dorë për pasivet financiare mund të çmohen mbi bazën e të dhënave historike. (Vlera e drejtë e një pasivi financiar, prej të cilit mund të hiqet dorë nga ana e palës tjetër, nuk mund të jetë më pak se vlera aktuale e shumës nga e cila është hequr dorë —shih paragrafi 49.)
- (h) *Kostot e shërbimit të një aktivi financiar ose pasivi financiar.* Kostot e shërbimit mund të çmohen duke i krahasuar me tarifatat aktuale që mbahen nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut. Në qoftë se kostot e shërbimit të një aktivi financiar ose pasivi financiar janë të rëndësishme dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut duhet të përballojnë kosto të krahasueshme, emetuesi duhet t'i marrë parasysh ato në përcaktimin e vlerës së drejtë të këtij aktivi financiar ose pasivi financiar. Ka të ngjarë që vlera e drejtë në fillim të një të drejte kontraktuale për tarifa të ardhshme të jetë e barabartë me kostot e nisjes të paguara për to, vetëm nëse tarifatat e ardhshme dhe kostot përkatëse nuk janë të krahasueshme me ato të tregut.

Fitimet dhe humbjet neto (paragrafet 55–57)

AG83 Një njësi ekonomike zbaton SNK 21 për aktivet financiare dhe pasivet financiare, që janë zëra monetarë në përputhje me SNK 21, dhe që shprehen në monedhë të huaj. Sipas SNK 21, çdo fitim dhe humbje neto nga këmbimi në monedhë të huaj të aktiveve monetare dhe pasiveve monetare njihen në fitim ose humbje. Bën përjashtim zëri monetar që përcaktohet si një instrument mbrojtës në mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare (shih paragrafet 95–101), ose në mbrojtje të një investimi neto (shih paragrafin 102). Me qëllim njohjen e fitimeve dhe humbjeve neto nga këmbimi në monedhë të huaj sipas SNK 21, një aktiv financiar monetar i vlefshëm për shitje trajtohet sikur të

ishte i mbartur me koston e amortizuar në monedhë të huaj. Kështu, për të tilla aktive financiare, diferencat nga këmbimi që rrjedhin nga ndryshimet në koston e amortizuar njihen në fitim ose humbje dhe ndryshimet e tjera në vlerën kontabël (neto) njihen në përputhje me paragrafin 55(b). Për aktivet financiare të vlefshme për shitje që nuk janë zëra monetarë sipas SNK 21 (për shembull, instrumente kapitali neto), fitimi dhe humbja neto, që njihen drejtpërdrejt në kapitalin neto sipas paragrafit 55(b), përfshijnë çdo përbërës të lidhur me këmbimin në monedhë të huaj. Në qoftë se ka marrëdhënie mbrojtëse midis një aktivi monetar joderivativ dhe një pasivi monetar joderivativ, ndryshimet në përbërësin në monedhë të huaj të këtyre instrumenteve financiare njihen në fitim ose humbje.

Zhvlërësimi dhe mosarkëtueshmëria e aktiveve financiare (paragrafet 58–70)

Aktivitet financiar të mbartura me koston e amortizuar (paragrafet 63–65)

- AG84 Zhvlërësimi i një aktivi financiar, i mbartur me koston e amortizuar, matet duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të instrumentit financiar, sepse skontimi me normën aktuale të interesit të tregut, në fakt, do të impononte matjen me vlerën e drejtë të një aktivi financiar që ndryshe është i matur me koston e amortizuar. Në qoftë se termat e huasë, llogarive të arkëtueshme ose të investimit që mbahet deri në maturim janë rinegociuar ose ndryshe janë modifikuar për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit ose emetuesit, zhvlërësimi matet duke përdorur normën e interesit efektiv fillestar përpara modifikimit të termave. Flukset e mjeteve monetare në lidhje me llogaritë e arkëtueshme afatshkurtëra nuk skontohen në qoftë se ndikimi i skontimit është jomaterial. Në qoftë se një hua, llogari e arkëtueshme ose investim që mbahet deri në maturim ka një normë interesi të ndryshueshme, norma e skontimit për matjen e çdo humbje nga zhvlërësimi, sipas paragrafit 63, është norma aktuale e interesit efektiv e përcaktuar sipas kontratës. Sipas përvojës praktike, një kreditor mund të matë zhvlërësimin e një aktivi financiar, të mbajtur me koston e amortizuar, mbi bazën e vlerës së drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e tregut të mbikëqyrtur. Llogaritja e vlerës aktuale e flukseve të çmuara të mjeteve monetare të ardhshme të një aktivi financiar të kolateralizuar pasqyron flukset monetare që rezultojnë nga përfundimi i detyrimit (foreclosure) pakësuar me koston për përfundimin dhe shitjen e kolateralit, qoftë ose jo i mundshëm përfundimi.
- AG85 Procesi për çmuarjen e zhvlërësimit merr parasysh gjithë ekspozimin ndaj rreziqeve të kreditimit, jo vetëm ato nga cilësia e ulët e kredisë. Për shembull, në qoftë se një njësi ekonomike përdor një sistem klasifikimi (kategorizimi) të brendshëm të kredisë, ajo merr parasysh të gjitha kategoritë e kredisë, jo vetëm ato që pasqyrojnë një përkeqësim të fortë të kredisë..
- AG86 Nga procesi për çmuarjen e shumës së humbjes nga zhvlërësimi mund të kemi si rezultat një vlerë të vetme, ose një interval vlerash të mundshme. Në rastin më të fundit, njësi ekonomike nje një humbje nga zhvlërësimi të barabartë me vlerësimin më të mirë brenda intervalit⁵, duke marrë parasysh të gjithë informacionin e rëndësishëm të disponueshëm përpara se të publikohen pasqyrat financiare për kushtet ekzistuese në datën e bilancit.
- AG87 Me qëllim vlerësimin kolektiv të zhvlërësimit, aktivitet financiar grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë, që janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat në përputhje me termat kontraktuale (për shembull, mbi bazën e vlerësimit të rrezikut të kredisë ose procesit të kategorizimit që merr parasysh llojin e aktivitetit, të industrisë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin në të shkuarën dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Karakteristikat e zgjedhura janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupe të tilla aktivesh, sepse janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat në përputhje me termat kontraktuale të aktiveve që janë të vlerësuar. Megjithatë, probabilitetet e humbjes dhe statistikave të tjera të humbjes ndryshojnë në nivel grupi midis (a) aktiveve që janë të vlerësuar individualisht për zhvlërësim dhe që është konstatuar se nuk janë të zhvlërësuar dhe (b) aktiveve që nuk janë të vlerësuar individualisht për zhvlërësim, si rrjedhim mund të përdoret një mase e ndryshme zhvlërësimi. Në qoftë se një njësi ekonomike nuk ka një grup aktivesh me karakteristika të ngjashme të rrezikut, nuk bëhet një vlerësim shtesë.

⁵ SNK 37, paragrafi 39 përmban udhëzimin se si duhet të përcaktohet vlerësimi më i mirë në një interval rezultatesh të mundshme.

- AG88 Njohja e humbjeve nga zhvlerësimi mbi bazë grupi përfaqëson një hap të përkohshëm në pritje të identifikimit të humbjeve nga zhvlerësimi për aktivet individuale në grupin e aktiveve financiare, që janë të vlerësuara në mënyrë kolektive për zhvlerësim. Sapo sigurohet informacioni i duhur, që identifikon në mënyrë specifike humbjet nga aktivet e zhvlerësuara në mënyrë individuale brenda një grup, këto aktive hiqen nga grupi.
- AG89 Flukset e mjeteve monetare në një grup aktivesh financiare, që janë vlerësuar në mënyrë kolektive për zhvlerësim, vlerësohen në bazë të përvojës historike për humbjet nga aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë të ngjashme me ato të grupit. Njësitë ekonomike që nuk kanë ndonjë përvojë të humbjes specifike për njësinë ekonomike ose një përvojë të mjaftueshme, përdorin eksperiencën e grupit të babarbartë për grupet e krahasueshme të aktiveve financiare. Përvoja historike për humbjet rregullohet në bazë të të dhënave aktuale të mbikëqyrura për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale, që nuk prekin periudhën në të cilën bazohet periudha historike për humbjet, dhe për të shmangur efektet e kushteve në periudhën historike, që nuk ekzistojnë aktualisht. Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme të mjeteve monetare pasqyrojnë dhe janë drejtpërdrejt në përputhje me ndryshimet në të dhënat përkatëse të mbikëqyrura nga periudha në periudhë (siç janë ndryshimet në përqindjet e papunësisë, çmimet e pasurive të paluajtshme, çmimet e mallrave, statusin e pagesës ose faktorët e tjerë që janë tregues të humbjeve të ndodhura në grup dhe madhësia e tyre). Metodologjia dhe supozimet e bëra për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis çmuarjeve të bëra për humbjet dhe humbjeve të ndodhura aktualisht.
- AG90 Si shembull në zbatim të paragrafit AG89, një njësi ekonomike mund të përcaktojë, mbi bazën e përvojës historike, që një nga shkaqet kryesore të mosshlyerjes së huasë me kartë kredie është vdekja e huamarrësit. Njësia ekonomike mund të vëzhgojë që ritmi i vdekjes është i pandryshueshëm nga njeri vit në tjetrin. Gjithsesi, disa nga huamarrësit në grupin e huave me kartë kredie të njësisë ekonomike mund të kenë vdekur në këtë vit, gjë që tregon se ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi, edhe nëse njësia ekonomike nuk është në dijeni akoma se cili prej huamarrësve ka vdekur. Do të ishte e përshtatshme që të njihet një humbje nga zhvlerësimi për këto humbje ‘të ndodhura, por të paraportuara’. Megjithatë, nuk do të ishte e përshtatshme të njihet një humbje nga zhvlerësimi për vdekjet që priten të ndodhin në një periudhë të ardhshme, sepse rasti i pashmangshëm i humbjes (vdekja e huamarrësit) nuk ka ndodhur akoma.
- AG91 Kur përdoren përqindjet historike të humbjes në vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare, është e rëndësishme që informacioni për këto përqindje historike humbjes të zbatohet për grupet që janë përcaktuar sipas një mënyre në përputhje me grupet për të cilat janë vëzhguar përqindjet historike të humbjeve. Pra, metoda e përdorur duhet të bëjë që secili grup të jetë i lidhur me informacionin mbi përvojën e kaluar të humbjes në grupin e aktiveve me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe të dhënat përkatëse të vëzhguara që pasqyrojnë kushtet aktuale.
- AG92 Për të përcaktuar humbjet nga zhvlerësimi në një grup aktivesh financiare (p.sh. për huatë me tepicën më të vogël), mund të përdoren mënyra të bazuara në formula ose metoda statistikore, për aq kohë sa ato janë në përputhje me kërkesat e parashtruara në paragrafet 63–65 dhe AG87–AG91. Çdo model i përdorur duhet të përfshijë efektin e vlerës në kohë të parasë, të marrë parasysh flukset e mjeteve monetare për gjithë jetën e mbetur të një aktivi (jo vetëm për vitin tjetër), të marrë parasysh moshën e huasë brenda portofolit dhe të mos jap shkas për humbje nga zhvlerësimi në njohjen fillestare të një aktivi financiar.

Të ardhura nga interesi pas njohjes së zhvlerësimit

- AG93 Kur një aktiv financiar ose grup aktivesh financiarë të ngjashëm janë çregjistruar si rezultat i një humbje nga zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi njihen paskëtaj duke përdorur normën e interesit që është përdorur për të skontuar flukset e ardhshme të mjeteve monetare më qëllim matjen e humbjes nga zhvlerësimi.

Mbrojtja (paragrafet 71–102)

Instrumentet mbrojtës (paragrafet 72–77)

Kualifikimi i instrumenteve (paragrafet 72 dhe 73)

- AG94 Humbja potenciale mbi një opSION, që një njësi ekonomike shkruan, duhet të jetë mjaft më e madhe se fitimi neto potencial në vlerën e elementit të mbrojtur të lidhur. Me fjalë të tjera, një opSION i

shkruar nuk është efektiv në zvogëlimin e ekspozimit ndaj rrezikut të fitimit ose humbjes së një elementi të mbrojtur. Prandaj, një opsjon i shkruar nuk kualifikohet si një instrument mbrojtës vetëm nëse ai përcaktohet si një kompensim i një opsjoni të blerë, duke përfshirë atë që është i përfshirë në një instrument tjetër financiar (për shembull, një opsjon blerjeje (call) i shkruar i përdorur për të mbuluar një pasiv të kërkueshëm). Në të kundërt, një opsjon i blerë ka fitime neto ose humbje potenciale të barabararta ose më të mëdha se humbjet dhe prandaj ka potencialin për të zvogëluar ekspozimin e fitimeve dhe humbjeve ndaj ndryshimeve në vlerat e drejta ose flukset e mjeteve monetare. Rrjedhimisht, ai mund të kualifikohet si një instrument mbrojtës.

- AG95 Një investim që mbahet deri në maturim, i mbajtur me koston e amortizuar, mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës në një mbrojtje nga rreziku i monedhës së huaj.
- AG96 Një investim në një instrument kapitali neto të pakuotuar, që nuk mbahet me vlerën e drejtë, sepse vlera e tij e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, ose një derivativ që është i lidhur dhe duhet të shlyhet nëpërmjet livrimit të një instrumenti kapitali neto të pakuotuar (shih paragrafet 46(c) dhe 47), nuk mund të përcaktohet si një instrument mbrojtës.
- AG97 Instrumentet kapitali neto të vetë njësisë ekonomike nuk janë aktive financiare ose pasive financiare të njësisë ekonomike dhe prandaj nuk mund të përcaktohen si instrumente mbrojtës.

Elementët e mbrojtur (paragrafet 78-84)

Kualifikimi i elementëve (paragrafet 78-80)

- AG98 Një angazhim i përcaktuar për të blerë një biznes në një kombinim biznesi nuk mund të jetë një element i mbrojtur, me përjashtim të rrezikut nga këmbimi në monedhë të huaj, sepse rreziqet e tjerë që janë të mbrojtur nuk mund të identifikohen dhe të maten në mënyrë specifike. Këto rreziqe të tjera janë rreziqet e përgjithshme të biznesit.
- AG99 Një investim sipas metodës së kapitalit neto nuk mund të jetë një element mbrojtës në një mbrojtje me vlerën e drejtë, sepse metoda e kapitalit neto njih në fitim ose humbje pjesën e investitorit në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjes, dhe jo ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit. Për arsye të ngjashme, një investim në një filial të konsoliduar nuk mund të jetë element i mbrojtur në një mbrojtje me vlerën e drejtë, sepse konsolidimi njih në fitim ose humbje, fitimin ose humbjen e filialit, dhe jo ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit. Një mbrojtje e një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj është e ndryshme, sepse ajo është një mbrojtje e ekspozimit ndaj monedhës së huaj, jo një mbrojtje me vlerën e drejtë e ndryshimit në vlerën e investimit.
- AG99A Paragrafi 80 pohon se në pasqyrat financiare të konsoliduara, transaksionet parashikues ndërgrupor me probabilitet të lartë për rrezikun e monedhës së huaj mund të kualifikohen si elementë të mbrojtur në një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare, me kusht që transaksioni të shprehet në monedhë të huaj të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike, që hyn në këtë transaksion, dhe rreziku i monedhës së huaj do të prekë fitimin ose humbjen e konsoliduar. Për këtë qëllim një njësi ekonomike mund të jetë një shoqëri mëmë, filial, pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose degë. Në qoftë se rreziku i monedhës së huaj e një transaksioni parashikues ndërgrup nuk prek fitimin ose humbjen e konsoliduar, transaksioni ndërgrup nuk mund të kualifikohet si një element i mbrojtur. Zakonisht, ky është rasti për pagesat për përdorimin e pronës, pagesat e interesit ose shpenzimet e drejtimit midis anëtarëve të të njëjtit grup, nëse nuk ka një transaksion të jashtëm të lidhur. Megjithatë, kur rreziku i monedhës së huaj i një transaksioni parashikues ndërgrup prek fitimin ose humbjen e konsoliduar, transaksioni ndërgrup mund të kualifikohet si një element i mbrojtur. Një shembull është parashikimi i shitjeve ose blerjeve të inventarëve midis anëtarëve të të njëjtit grup, në qoftë se është një shitje inventari e bërë më parë tek një palë e jashtme ndaj grupit. Në mënyrë të ngjashme, parashikimi i një shitje ndërgrup të makinerive dhe pajisjeve nga njësi ekonomike grup, që i prodhon ato, në njësinë ekonomike grup që do t'i përdorë makineritë dhe pajisjet në veprimtaritë e saj, mund të prekë fitimin ose humbjen e konsoliduar. Kjo mund të ndodhë, për shembull, për shkak se makineritë dhe pajisjet do të amortizohen nga njësi ekonomike blerëse dhe shuma e njohur në fillim për makineritë dhe pajisjet mund të ndryshojë, në qoftë se transaksioni ndërgrup i parashikuar shprehet në një monedhë tjetër nga ajo funksionale e njësisë ekonomike blerëse.
- AG99B Në qoftë se mbrojtja e një transaksioni ndërgrup parashikues kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës, çdo fitim ose humbje, që njihet drejtpërdrejt në kapitalin neto në përputhje me paragrafin 95(a), do të riklasifikohet në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave rreziku i monedhës së huaj për një transaksion të mbrojtur prek fitimin ose humbjen e konsoliduar.

Përcaktimi i zërave financiarë si zëra të mbrojtur (paragrafet 81 dhe 81A)

- AG99C Në qoftë se një pjesë e flukseve të mjeteve monetare të aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar përcaktohet si një element i mbrojtur, atëherë kjo pjesë e përcaktuar duhet të jetë më e vogël se flukset monetare gjithsej të aktivitetit ose pasivitetit. Për shembull, në rastin e një pasivi, norma e interesit efektiv e të cilit është poshtë LIBOR, një njësi ekonomike nuk mund të përcaktojë (a) një pjesë të pasivitetit të barabartë me vlerën e principalit plus interesin në LIBOR dhe (b) një pjesë negative të mbetur. Megjithatë, njësi ekonomike mund të përcaktojë të gjitha flukset monetare të aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar në tërësi, si elementë të mbrojtur, dhe t'i mbrojë ata vetëm nga ndonjë rrezik i veçantë (p.sh. vetëm nga ndryshimet që lidhen drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR). Për shembull, në rastin e një pasivi financiar, kur norma e interesit efektiv të tij është 100 pikë bazë poshtë LIBOR, njësi ekonomike mund ta përcaktojë si element të mbrojtur të tërë pasivitetin (d.m.th. principalit plus interesi me LIBOR minus 100 pikë bazë) dhe mbron ndryshimin në vlerën e drejtë ose flukset monetare të këtij pasivi të tërë, që lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet në LIBOR. Njësi ekonomike mundet, gjithashtu, të zgjedhë një raport mbrojtjeje në vend të asaj një nga një, për të përmirësuar efektivitetin e mbrojtjes, siç përshkruhet në paragrafin AG100.
- AG99D Përveç kësaj, në qoftë se një instrument financiar me një normë të pandryshueshme, ndonjë herë është i mbrojtur pas krijimit të tij dhe ndërkohë normat e interesit kanë ndryshuar, njësi ekonomike mund të përcaktojë një pjesë të barabartë për një normë bazë, që është më e lartë se norma e kontraktuar paguar mbi zërin. Njësi ekonomike mund të veprojë kështu me kusht që norma bazë të jetë më e vogël se norma e interesit efektiv e llogaritur mbi bazën e supozimit që njësi ekonomike e ka blerë instrumentin në ditën e parë që e përcakton elementin e mbrojtur. Për shembull, supozohet se një njësi ekonomike krijon një aktiv financiar me normë të pandryshueshme për 100NJM, që ka një normë interesi efektiv prej 6 për qind në kohën që LIBOR është 4 për qind. Ajo fillon ta mbrojë aktivitetin pak më vonë, kur LIBOR është rritur në 8 për qind dhe vlera e drejtë e aktivitetit është ulur në 90NJM. Njësi ekonomike llogarit, që në qoftë se ajo do ta kishte blerë aktivitetin në datën e parë që e përcakton atë si element të mbrojtur për vlerën e drejtë të pastajme prej 90NJM, norma efektive do të ishte 9.5 për qind. Meqë LIBOR është më i vogël se kjo normë efektive, njësi ekonomike mund të përcaktojë një pjesë LIBOR prej 8 për qind, që përbëhet pjesërisht nga flukset monetare të interesit kontraktual dhe pjesërisht nga diferenca midis vlerës së drejtë aktuale (d.m.th. 90 NJM) dhe shumës së ripagueshme në maturim (d.m.th. 100NJM).

Përcaktimi i zërave jofinanciarë si zëra të mbrojtur (paragrafi 82)

- AG100 Ndryshimet në çmimin e një elementi ose një përbërësi të një aktivi jofinanciar, ose pasivi jofinanciar, në përgjithësi nuk kanë një efekt të parashikueshëm, të matshëm në mënyrë të veçantë, mbi çmimin e zërit që është i krahasueshëm me efektin, le të themi, një ndryshim në normat e interesit të tregut mbi çmimin e një obligacioni. Kështu, një aktiv jofinanciar ose një pasiv jofinanciar është një zë i mbrojtur vetëm në tërësinë e tij ose për rrezikun e këmbimit në monedhë të huaj. Në qoftë se ka një diferencë midis termave të instrumentit mbrojtës dhe termave të instrumentit të mbrojtur (siç është në rastin e mbrojtjes së blerjes së parashikuar të kafesë braziliene duke përdorur një kontratë të ardhshme për të blerë kafe kolumbiane në terma jo të ngjashëm), marrëdhënia mbrojtëse gjithsesi mund të kualifikohet si një marrëdhënie mbrojtëse nëse plotësohen të gjitha kushtet e paragrafit 88, duke patur parasysh që mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive. Për këtë qëllim, vlera e instrumentit mbrojtës mund të jetë më e madhe ose më e vogël se ajo e elementit të mbrojtur, në qoftë se kjo përmirëson efektivitetin e marrëdhënies mbrojtëse. Për shembull, mund të bëhen analizat e regresionit për të vendosur një marrëdhënie statistikore midis elementit të mbrojtur (p.sh. transaksioni me kafën braziliene) dhe instrumentit mbrojtës (p.sh. transaksioni me kafën kolumbiane). Në qoftë se ka një marrëdhënie statistikore të mirëqënë midis dy variablave (d.m.th. midis çmimeve për njësi të kafesë braziliene dhe asaj kolumbiane), pjerrësia e vijës së regresionit mund të përdoret për të vendosur raportin e mbrojtjes që do të maksimizojë efektivitetin e pritshëm. Për shembull, në qoftë se pjerrësia e vijës së regresionit është 1.02, një raport mbrojtës, bazuar në 0.98 të sasive të elementeve të mbrojtur kundrejt 1.00 sasive të instrumentit mbrojtës, maksimizon efektivitetin e pritshëm. Megjithatë, marrëdhënia mbrojtëse mund të rezultojë në mosefektivitet që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës të marrëdhënies mbrojtëse.

Përcaktimi i grupeve të zërave financiarë si zëra të mbrojtur (paragrafet 83 dhe 84)

AG101 Mbrojtja e një pozicioni neto të përgjithshëm (p.sh. pozicioni neto i të gjithë aktiveve me normë të pandryshueshme dhe pasive me normë me maturitete të ngjashëm), përveç një elementi specifik të mbrojtur, nuk kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës. Megjithatë, pothuajse i njëjti efekt në fitim ose humbje të kontabilitetit mbrojtës për këtë tip marrëdhënie mbrojtëse mund të arrihet duke përcaktuar si element të mbrojtur pjesë të zërave bazë. Për shembull, në qoftë se një bankë ka 100NJM aktive dhe 90NJM pasive me rreziqe dhe terma me natyrë të ngjashme dhe mbron ekspozimin për 10NJM neto, ajo mund të përcaktojë si element të mbrojtur 10NJM të këtyre aktiveve. Ky përcaktim mund të përdoret, në qoftë se këto aktive dhe pasive janë instrumente me normë të pandryshueshme dhe në këtë rast kemi një mbrojtje të vlerës së drejtë, ose nëse ata janë instrumente me norma të ndryshueshme dhe në këtë rast kemi një mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se një njësi ekonomike ka një angazhim të përcaktuar për të blerë në monedhë të huaj 100NJM dhe një angazhim të përcaktuar për të shitur në monedhë të huaj 90NJM, atëherë ajo mund të mbrojë vlerën neto 10NJM, duke blerë një derivativ dhe duke e përcaktuar atë si një instrument mbrojtës që lidhet me 10NJM të angazhimit të përcaktuar të blerjes prej 100NJM.

Kontabiliteti mbrojtës (paragrafet 85–102)

AG102 Një shembull i mbrojtjes së vlerës së drejtë është mbrojtja e një instrumenti borxhi me normë të pandryshueshme, nga ekspozimi ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë, si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit. Një mbrojtje e tillë mund të regjistrohet nga emetuesi ose mbajtësi.

AG103 Një shembull i mbrojtjes së fluksit të mjeteve monetare është përdorimi i swap për ndryshimin e normës së luhatshme të borxhit kundrejt normës të pandryshueshme të tij (d.m.th. mbrojtja e një transaksioni të ardhshëm ku flukse mjeteve monetare të ardhshme të mbrojtura janë pagesat e ardhshme të interesit).

AG104 Mbrojtja e një angazhimi të përcaktuar (p.sh. mbrojtja e ndryshimit në çmimin e lëndës djegëse në lidhje me një angazhim kontraktual të panjohur nga një njësi elektrike për të blerë lëndë djegëse me një çmim të pandryshueshëm) është një mbrojtje ndaj ekspozimit për një ndryshim në vlerën e drejtë. Kështu, një mbrojtje e tillë është një mbrojtje e vlerës së drejtë. Megjithatë, sipas paragrafit 87, një mbrojtje nga rreziku i këmbimit në monedhë të huaj të një angazhimi të përcaktuar, në të kundërt mund të trajtohet si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare.

Vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes

AG105 Një mbrojtje trajtohet si mjaft efektive vetëm në qoftë se plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- (a) Në fillim të mbrojtjes dhe në periudhat të mëpasshme, mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive, kur bëhet kompensimi i ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të lidhura me rrezikun e mbrojtur gjatë periudhës për të cilën është përcaktuar mbrojtja. Një pritshmëri e tillë mund të demonstrohet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë krahasimin e ndryshimeve të kaluara në vlerën e drejtë ose flukset e mjeteve monetare të elementit të mbrojtur, që janë të lidhura me rrezikun e mbrojtur për ndryshimet e kaluara në vlerën e drejtë, ose flukset e mjeteve monetare të instrumentit mbrojtës, ose duke demonstruar një korrelacion të lartë statistikor midis vlerës së drejtë ose flukseve të mjeteve monetare të elementit të mbrojtur dhe atyre të instrumentit mbrojtës. Njësia ekonomike mundet gjithashtu të zgjedhë një mbrojtje në raport (përqindje) në vend të asaj një nga një për të përmirësuar efektivitetin e mbrojtjes siç është përshkruar në paragrafin AG100.
- (b) Rezultatet aktuale të mbrojtjes janë brenda një intervali 80-125 për qind. Për shembull, në qoftë se rezultate aktuale janë të tilla që humbja nga instrumenti mbrojtës është 120NJM dhe fitimi neto nga instrumenti në mjete monetare është 100NJM, kompensimi mund të matet me raportin 120/100, i cili është 120 për qind, ose me raportin 100/120, i cili është 83 për qind. Në këtë shembull, duke supozuar që mbrojtja plotëson kushtin e pikës (a), njësia ekonomike do të arrinte në përfundimin që mbrojtja ka qenë mjaft efektive.

AG106 Efektiviteti vlerësohet, të paktën, në kohën që një njësi ekonomike përgatit pasqyrat e saj financiare vjetore ose ato të ndërmjetme.

- AG107 Ky standard nuk specifikon një metodë të vetme për vlerësimin e një mbrojtje efektive. Metoda që një njësi ekonomike përdor për vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes varet nga strategjia e saj e drejtimit të rrezikut. Për shembull, në qoftë se strategjia e drejtimit të rrezikut të një njësie ekonomike është që të rregullojë periodikisht vlerën e instrumentit mbrojtës, për të pasqyruar ndryshimet në pozicionin mbrojtës, atëherë njësi ekonomike kërkohet të demonstrojë që mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive vetëm për periudhën deri sa më pas vlera e instrumentit mbrojtës të rregullohet. Në disa raste, një njësi ekonomike përdor metoda të ndryshme për tipe të ndryshme të mbrojtjes. Dokumentacioni i një njësie ekonomike të strategjisë së saj të mbrojtjes përfshin procedurat për vlerësimin e efektivitetit. Këto procedura specifikojnë nëse vlerësimi pëfshin të gjitha fitimet ose humbjet neto nga një instrument mbrojtës ose nëse është përjashtuar vlera në kohë e instrumentit.
- AG107A Në qoftë se një njësi ekonomike mbron më pak se 100 për qind të ekspozimit ndaj rrezikut të një zëri, kështu p.sh. 85 për qind, ajo do ta përcaktojë elementin e mbrojtur që të jetë sa 85 për qind e ekspozimit dhe do të matë mosefektivitetin bazuar në ndryshimin në këtë 85 për qind të ekspozimit të përcaktuar. Sidoqoftë, kur mbrojtja është e përcaktuar për një ekspozim prej 85 për qind, njësi ekonomike mund të përdorë raportin mbrojtës (mbrojtjen në përqindje), sesa mbrojtjen një nga një, nëse kjo përmirëson efektivitetin e pritshëm të mbrojtjes, siç shpjegohet në paragrafin AG100.
- AG108 Në qoftë se termat e principalit të instrumentit mbrojtës dhe të aktivit, pasivit, angazhimit të përcaktuar ose transaksionit parashikues me probabilitet të lartë të mbrojtur, janë të njëjtë, ndryshimet në vlerën e drejtë dhe flukset e mjeteve monetare, të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun nga i cili mbrohet, mund të kompensojnë njeri-tjetrin, si në momentin mbrojtja ka filluar dhe më pas. Për shembull, një swap për norma interesi ka mundësi të jetë një mbrojtje efektive, në qoftë se shumat imagjinare dhe e principalit, afati, datat e rivlerësimit, datat e arkëtimeve dhe pagesave të interesit dhe principalit, dhe bazat për matjen e normave të interesit janë të njëjta si për instrumentin mbrojtës, ashtu dhe për elementin e mbrojtur. Përveç kësaj, mbrojtja me një kontratë të ardhshme e një blerjeje malli, parashikuar me probabilitet të lartë, mundet të jetë mjaft efektive në qoftë se:
- kontrata e ardhshme është për blerjen e të njëjtës sasi, të të njëjtit mall, në të njëjtën kohë dhe vend, sikurse blerja parashikuese e mbrojtur;
 - vlera e drejtë e kontratës së ardhshme (forward) në fillim është zero; dhe
 - edhe ndryshimi në skonton ose primin mbi një kontratë të ardhshme (forward) përjashtohet nga vlerësimi i efektivitetit dhe njihet në fitim ose humbje, edhe ndryshimi në flukset e mjeteve monetare të pritshme nga transaksioni parashikues me probabilitet të lartë bazohet në çmimin e ardhshëm (forward) për mallin.
- AG109 Nganjëherë instrumenti mbrojtës kompenson vetëm një pjesë të rrezikut të mbrojtur. Për shembull, një mbrojtje nuk do të ishte plotësisht efektive, në qoftë se instrumenti mbrojtës dhe elementi i mbrojtur janë të shprehur në monedha të ndryshme që nuk lëvizin në të njëjtin drejtim. Gjithashtu, një mbrojtje nga rreziku i normës së interesit duke përdorur një derivativ nuk do të ishte plotësisht efektive, në qoftë se një pjesë e ndryshimit në vlerën e drejtë të derivativit është e lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e kredisë së palës tjetër.
- AG110 Për t'u kualifikuar për kontabilitet mbrojtës, mbrojtja duhet të jetë e lidhur me një rrezik specifik të përcaktuar dhe të identifikuar dhe jo vetëm me rreziqet e përgjithshme të biznesit, dhe përfundimisht duhet të prekë fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike. Një mbrojtje nga rreziku i amortizimit moral të një aktivi fizik ose rreziku i shpronësimit të pasurisë nga qeveria nuk është e përshtatshme për kontabilitetin mbrojtës; efektiviteti nuk mund të matet, sepse këto rreziqe nuk janë të matshme në mënyrë të besueshme.
- AG111 Në rastin e rrezikut të normës së interesit, mbrojtja efektive mund të vlerësohet duke përgatitur një grafik maturimi për aktivin financiar dhe pasivet financiare që tregojnë ekspozimin neto të normës së interesit për çdo periudhë kohe, me kusht që ekspozimi neto është i lidhur me një aktiv ose pasiv specifik (ose një grup aktivesh ose pasivesh, ose një pjesë specifike e tyre) duke i dhënë shkas një ekspozimi neto, dhe mbrojtja efektive vlerësohet kundrejt këtij aktivi ose pasivi.
- AG112 Për të bërë vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes, në përgjithësi, një njësi ekonomike shqyrton vlerën në kohë të parasë. Norma e pandryshueshme e interesit mbi elementin e mbrojtur nuk është e nevojshme që të jetë e lidhur saktë me normën e pandryshueshme të interesit mbi swap-in e përcaktuar si një mbrojtje të vlerës së drejtë. Po kështu, as norma e ndryshueshme e interesit mbi një aktiv ose pasiv që mbart interes nuk është e nevojshme të jetë e njëjtë me normën e ndryshueshme të interesit mbi swap, i përcaktuar si një mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare. Vlera e drejtë e një swap derivon nga shlyerjet e tij neto. Normat e pandryshueshme dhe të

ndryshueshme të swap mund të ndryshohen pa prekur shlyerjen neto edhe në qoftë se ato ndryshojnë që të dyja me të njëjtën shumë.

AG113 Në qoftë se njësia ekonomike nuk plotëson kriterin e mbrojtjes efektive, atëherë ajo ndërpret zbatimin e kontabilitetit mbrojtës që nga data më e fundit, që është demonstruar se mbrojtja ka qenë efektive. Megjithatë, në qoftë se njësia ekonomike identifikon ngjarjen ose ndryshimin në rrethanat, e cila ka bërë që marrëdhëniet mbrojtëse të mos plotësojnë kriterin e efektivitetit, dhe demonstroi që mbrojtja ka qenë efektive përpara ndodhjes së ngjarjes ose ndryshimit në rrethanat, njësia ekonomike ndërpret zbatimin e kontabilitetit mbrojtës që nga data e ngjarjes ose ndryshimit në rrethanat.

Kontabiliteti mbrojtës me vlerën e drejtë për mbrojtjen e një portofoli nga rreziku i normës së interesit

AG114 Për mbrojtjen e vlerës së drejtë ndaj rrezikut të normës së interesit, bashkëshoqërues me portofolin e aktiveve financiare ose pasiveve financiare, një njësi ekonomike do të plotësonte kërkesat e këtij standardi në qoftë se ajo përmbush procedurat e përshkruara në (a)–(i) dhe paragrafet AG115–AG132 më poshtë.

- (a) Si pjesë e procesit të drejtimit të rrezikut, njësia ekonomike identifikon një portofol të zërave që duan të mbrohen nga rreziku i normës së interesit. Portofoli mund të përbëhet vetëm nga aktivet, vetëm nga pasivet, ose nga aktivet dhe pasivet bashkë. Njësia ekonomike mund të identifikojë dy ose më shumë portofole (p.sh. njësia ekonomike mund të grupojë aktivet e saj të vlefshme për shitje në një portofol të veçantë) dhe në një rast të tillë për çdo portofol të veçantë zbatohet udhëzimi i mëposhtëm.
- (b) Njësia ekonomike analizon portofolin në periudhat e rivlerësimit bazuar në datat e pritshme, sesa ato kontraktuale të rivlerësimit. Analizat në periudhat e rivlerësimit mund të kryhen në mënyra të ndryshme duke përfshirë programimin e flukseve të mjeteve monetare në periudhat në të cilat ato priten të kryhen, ose programimin e shumave imagjinare të principalit në të gjitha periudhat deri kur bëhet rivlerësimi i pritshëm.
- (c) Mbi bazën e kësaj analize, njësia ekonomike vendos për shumën që dëshiron të mbrojë. Njësia ekonomike përcakton si një element të mbrojtur një shumë të aktiveve ose pasiveve (por jo një shumë neto) nga portofoli i identifikuar të barabartë me shumën që ajo dëshiron ta përcaktojë si të mbrojtur. Kjo shumë, gjithashtu, përcakton masën e përqindjes që përdoret për testimin e efektivitetit në përputhje me paragrafin AG126(b).
- (d) Njësia ekonomike përcakton që të mbrohet nga rreziku i normës së interesit. Ky rrezik mund të jetë një pjesë e rrezikut të normës së interesit për secilin prej zërave në pozicion të mbrojtur, siç është norma bazë e interesit (p.sh. LIBOR).
- (e) Njësia ekonomike përcakton një ose më shumë instrumente mbrojtës për çdo periudhë kohe rivlerësimi.
- (f) Duke përdorur përcaktimet e bëra më sipër në pikat (c)–(e), njësia ekonomike vlerëson në fillim dhe në periudhat e mëpasshme, nëse mbrojtja pritet të jetë mjaft efektive gjatë periudhës për të cilën mbrojtja është përcaktuar.
- (g) Periodikisht, njësia ekonomike mat ndryshimin në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur (siç përcaktohet në pikën (c)), që është i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur (si është përcaktuar në pikën (d)), bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit, të përcaktuara në pikën (b). Më kusht që mbrojtja e përcaktuar aktualisht të rezultojë se ka qenë mjaft efektive, kur të vlerësohet duke përdorur metodën e dokumentuar të njësisë ekonomike për vlerësimin e efektivitetit, njësia ekonomike njeht ndryshimin në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur si një fitim ose humbje neto në fitim ose humbje dhe në njerin prej dy nënzërave në bilanc, si përshkruhet në paragrafin 89A. Ndryshimi në vlerën e drejtë nuk ka nevojë të shpërndahet sipas aktiveve ose pasiveve individuale.
- (h) Njësia ekonomike mat ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (siç përcaktohet në pikën (e)) dhe e njeht atë si një fitim ose humbje neto në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e instrumentit mbrojtës njihet si një aktiv ose pasiv në bilanc.
- (i) Çdo mosefektivitet⁶ do të njihet në fitim ose humbje si një diferencë midis vlerës së drejtë, duke iu referuar pikës (g), dhe asaj të referuar në pikën (h).

⁶ Në këtë kontekst zbatohen konsideratat për materialitetin njëjloj si në tërë SNRF-të.

- AG115 Kjo metodë përshkruhet më hollësisht më poshtë. Metoda duhet të zbatohet vetëm për mbrojtjen me vlerën e drejtë të rrezikut të normës së interesit që është i lidhur me një portofol të aktiveve financiare ose pasiveve financiare.
- AG116 Portofoli i identifikuar në paragrafin AG114(a) mund të përmbajë aktive dhe pasive. Në të kundërt, ai mund të jetë një portofol që përmban vetëm aktive, ose vetëm pasive. Portofoli përdoret për të përcaktuar shumën e aktiveve ose pasiveve që njësia ekonomike dëshiron të mbrojë. Megjithatë, portofoli në vetvete nuk është i përcaktuar si element i mbrojtur.
- AG117 Në zbatim të paragrafit AG114(b), njësia ekonomike përcakton datën e pritshme të rivlerësimit të një zëri si datën më të hershme kur ky zë pritet të maturohet ose të rivlerësohet për normat e tregut. Datat e pritshme të rivlerësimit çmohen në fillim të mbrojtjes dhe gjatë gjithë afatit të saj, bazuar në përvojën historike dhe informacion tjetër të vlefshëm, duke përfshirë informacionin dhe parashikimet në lidhje me normat e parapagimit, normat e interesit dhe ndërlidhjen midis tyre. Njësitë ekonomike, që nuk kanë ndonjë përvojë specifike të tyre ose një përvojë të mjaftueshme, përdorin eksperiencën e grupit të babarbartë për instrumentet e krahasueshme financiare. Këto çmuarje rishikohen periodikisht dhe përditësohen mbi bazën e eksperiencës. Në rastin e një zëri me normë të pandryshueshme, që është e parapagueshme, data e pritshme e rivlerësimit është data në të cilën zëri pritet të parapaguhet, nëse nuk rivlerësohet me normat e tregut në një datë më të hershme. Për një grup me zëra të ngjashëm, analizat në periudhat kohore bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit janë në formën e shpërndarjes së një përqindjeje të grupit, sesa sipas zërave individualë, për secilën periudhë kohe. Njësia ekonomike zbaton edhe metodologji të tjera për të tilla shpërndarje. Për shembull, ajo mund të përdorë një shumëfishues normash të parapagimit për të shpërndarë amortizimin (shlyerjen) e huave për periudha kohe bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit. Megjithatë, metodologjia për një shpërndarje të tillë do të jetë në përputhje me procedurat dhe objektivat e drejtimit të rrezikut të njësisë ekonomike.
- AG118 Në lidhje me përcaktimin e parashtruar në paragrafin AG114(c), në qoftë se në një periudhë kohe të veçantë të rivlerësimit, një njësi ekonomike çmon që ajo ka aktive me normë të pandryshueshme për 100NJM dhe pasive me normë të pandryshueshme për 80NJM dhe vendos të mbrojë të gjithë pozicionin neto prej 20NJM, atëherë ajo përcakton si element të mbrojtur aktivet me shumën 20NJM (pjesa e aktiveve).⁷ Përcaktimi shprehet si një ‘shumë e një monedhe’ (p.sh. në shumë dollarësh, euro, paund ose rand) se sa si aktive individuale. Kjo do të thotë që të gjitha aktivet (ose pasivet) nga të cilat është hequr shuma e mbrojtur –d.m.th. 100NJM e aktiveve në këtë shembull – duhet të jenë:
- (a) zëra të mbrojtur ata zëra që vlera e drejtë të cilëve ndryshon në përgjigje ndaj ndryshimeve në normën e interesit; dhe
 - (b) zëra, që do të ishin kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës të vlerës së drejtë, në qoftë se ata do të ishin përcaktuar si të mbrojtur në mënyrë individuale. Në veçanti, meqë standardi⁸ specifikon që vlera e drejtë e një pasivi financiar me një tipar kërkueshmërie pa afat (siç janë depozitat pa afat dhe disa lloje të tjera depozitash me afat) nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar që nga dita e parë që shuma mund të kërkohej për t’u paguar, pra një zë i tillë nuk mund të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës të vlerës së drejtë për çdo periudhë kohe përtej periudhës më të shkurtër në të cilën mbajtësi mund të kërkojë pagesën. Në shembullin e mësipërm, pozicioni i mbrojtur është një shumë aktivesh. Pra, të tilla pasive nuk janë pjesë e elementit të mbrojtur të përcaktuar, por përdoren nga njësia ekonomike për të përcaktuar shumën e aktivitetit që është projektuar si i mbrojtur. Në qoftë se pozicioni i dëshiruar për t’u mbrojtur nga njësia ekonomike është një shumë pasivesh, kjo shumë, që përfaqëson elementin e mbrojtur, duhet të zbritet nga pasivet me normë të pandryshueshme, përveç pasiveve që njësia ekonomike mund të kërkojë t’i paguajë në një periudhë më të hershme, dhe masa e përqindjes së përdorur për vlerësimin e mbrojtjes efektive, në përputhje me paragrafin AG126(b), duhet të llogaritet si një përqindje e këtyre pasiveve të tjerë. Për shembull, supozohet se një njësi ekonomike çmon që në një periudhë kohe të veçantë rivlerësimi ka 100NJM pasive me normë të pandryshueshme, që përbëhen nga 40NJM depozita pa afat dhe 60NJM pasive pa tiparin e kërkueshmërisë pa afat, dhe 79NJM aktive me normë të pandryshueshme. Në qoftë se njësia ekonomike vendos të mbrojë të gjithë pozicionin neto

⁷ Standardi lejon njësinë ekonomike të përcaktojë çdo shumë të aktiveve ose pasiveve të vlefshme të kualifikuar, d.m.th. në këtë shembull çdo shumë të aktiveve midis 0NJM dhe 100NJM.

⁸ shih paragrafin 49

prej 30NJM, ajo përcakton si element të mbrojtur pasivet prej 30NJM ose 50për qind⁹ të pasiveve pa tipar kërkueshmërie pa afat.

AG119 Gjithashtu, njësia ekonomike vepron në përputhje me kërkesat e tjera të përcaktimit dhe të dokumentimit që janë parashtruar në paragrafin 88(a). Për një portofol mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, ky përcaktim dhe dokumentim specifikon politikën e njësisë ekonomike për të gjithë variablat që janë përdorur për të identifikuar shumën që është mbrojtur dhe mënyrën e matjes së efektivitetit, përfshirë sa më poshtë:

- (a) cilat aktive dhe pasive janë përfshirë në mbrojtje portofoli dhe mbi ç'baza hiqen ata nga portofoli.
- (b) si i çmon njësia ekonomike datat e rivlerësimit, përfshirë se cilat janë supozimet për normat e interesit që përbëjnë bazën e çmuarjeve të normave të parapagimit dhe mbi ç'bazë ndryshojnë këto çmuarje. E njëjta metodë përdoret si për çmuarjet fillestare të bëra në kohën që një aktiv ose pasiv është përfshirë në portofin e mbrojtur, ashtu dhe për rishikimin më vonë të këtyre çmuarjeve.
- (c) numri dhe kohëzgjatja e periudhave të rivlerësimit.
- (d) sa shpesh njësia ekonomike do të testojë efektivitetin dhe cilën prej dy metodave në paragrafin AG126 do të përdorë.
- (e) metodologjia e përdorur nga njësia ekonomike për të përcaktuar shumën e aktiveve ose pasiveve që janë projektuar si elementë të mbrojtur dhe, në lidhje me këtë, masën e përqindjes së përdorur kur njësia ekonomike teston efektivitetin me metodën e përshkruar në paragrafin AG126(b).
- (f) kur njësia ekonomike teston efektivitetin duke përdorur metodën e përshkruar në paragrafin AG126(b), a do të bëjë testimin e efektivitetit individualisht për çdo periudhë kohe rivlerësimi, për të gjitha periudhat në total, apo duke i kombinuar të dyja.

Politikat e specifikuar në përcaktimin dhe dokumentimin e marrëdhënies mbrojtëse do të jenë në përputhje me objektivat dhe procedurat e drejtimit të rrezikut të njësisë ekonomike. Ndryshimet në politika nuk mund të jenë arbitrare. Ato duhet të justifikohen mbi bazën e ndryshimeve në kushtet e tregut dhe në faktorët e tjerë dhe të jenë në përputhje me objektivat dhe procedurat e drejtimit të rrezikut të njësisë ekonomike.

AG120 Instrumenti mbrojtës, duke iu referuar paragrafit AG114(e), mund të jetë një derivativ i vetëm ose një portofol derivativësh, të cilët të gjithë janë të ekspozuar ndaj rrezikut të mbrojtur të normës së interesit, të përcaktuar në paragrafin AG114(d) (p.sh. portofoli i swap-eve të normave të interesit që të gjitha janë të ekspozuara për LIBOR). Një portofol i tillë i derivativëve mund të ketë pozicione për kompensimin e rrezikut. Megjithatë, ai mund të mos përfshijë opsione të shkruara ose opSION të shkruar neto, sepse standardi¹⁰ nuk i lejon të tilla opsione të përcaktohen si instrumente mbrojtës (me përjashtim kur një opSION i shkruar është përcaktuar si një kompensim për një opSION të blerë). Në qoftë se instrumenti mbrojtës mbron shumën e përcaktuar në paragrafin AG114(c) për më tepër se një periudhë kohe rivlerësimi, atëherë bëhet shpërndarja për të gjitha periudhat që ai mbron. Megjithatë, i tërë instrumenti mbrojtës duhet të shpërndahet për këto periudha kohe rivlerësimi, sepse standardi¹¹ nuk e lejon një marrëdhënie mbrojtëse të jetë e projektuar vetëm për një pjesë të periudhës kohore gjatë të cilës instrumenti mbrojtës është në qarkullim (mbetet i pashlyer).

AG121 Kur një njësi ekonomike mat ndryshimin në vlerën e drejtë të një zëri të parapagueshëm në përputhje me paragrafin AG114(g), atëherë ndryshimi në normat e interesit prek vlerën e drejtë të një zëri të parapagueshëm në dy mënyra: ai prek vlerën e drejtë të flukseve monetare kontraktuale dhe vlerën e drejtë të parapagimit që ka një zëri i parapagueshëm. Paragrafi 81 i standardit lejon një njësi ekonomike të përcaktojë një pjesë të një aktivi financiar ose pasivi financiar, që kanë të njëjtin ekspozim ndaj rrezikut të përbashkët, si element të mbrojtur, duke bërë të mundur të matet efektiviteti. Për zërat e parapagueshëm, paragrafi 81A lejon një gjë të tillë duke projektuar elementin e mbrojtur në varësi të ndryshimit në vlerën e drejtë, që është i lidhur drejtpërdrejt me ndryshimet në normën e interesit të përcaktuar duke u bazuar në datat e pritshme të rivlerësimit, sesa në ato kontraktuale. Megjithatë, ndikimi që ndryshimet në normën e interesit të mbrojtur kanë mbi këto data të pritshme të rivlerësimit, do të përfshihet kur të përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur. Rrjedhimisht, në qoftë se datat e pritshme të rivlerësimit janë rishikuar (p.sh. për të pasqyruar një ndryshim në parapagimet e pritshme), ose në qoftë se të datat

⁹ $30NJM \div (100NJM - 40NJM) = 50$ për qind

¹⁰ shih paragrafet 77 dhe AG94

¹¹ shih paragrafin 75

aktuale të rivlerësimit ndryshojnë nga ato të pritshme, atëhere sipas paragrafit AG126, do të ketë mosefektivitet. Në të kundërt, ndryshimet në të datat e pritshme të rivlerësimit që (a) në mënyrë të qartë rrjedhin nga faktorë sesa nga ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit, (b) janë të palidhura me ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit dhe (c) mund të jenë të ndara në mënyrë të besueshme nga ndryshimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me normën e mbrojtur të interesit (p.sh. ndryshimet në normat e parapagimit rrjedhin natyrshëm nga një ndryshim në faktorët demografikë ose rregullimet tatimore sesa ndryshimet në normat e interesit) përjashtohen kur përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit mbrojtës, sepse ato nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur. Në qoftë se ka pasiguri në lidhje me faktorët që shkaktajnë këtë ndryshim në datat e pritshme të rivlerësimit ose njësisë ekonomike nuk është në gjendje të veçojë në mënyrë të besueshme ndryshimet që rrjedhin nga norma e mbrojtur e interesit nga ato që rrjedhin nga faktorë të tjerë, ndryshimi supozohet që rrjedh nga ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit.

- AG122 Standardi nuk i specifikon teknikat e përdorura në përcaktimin e shumës të përmendur në paragrafin AG114(g), domethënë ndryshimin në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur, që është i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur. Në qoftë se për të bërë një matje të tillë përdoren teknikat e vlerësimit statistikor ose të tjera, atëhere drejtimi duhet të presë rezultate të përafërta me ato që do të përftoheshin nga matja e të gjithë aktiveve ose pasiveve individuale që përbëjnë elementin e mbrojtur. Nuk është e përshtatshme të supozohet që ndryshimet në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur të barazojnë me ndryshimet në vlerën e instrumentit mbrojtës.
- AG123 Paragrafi 89A kërkon që në qoftë se elementi i mbrojtur për një periudhë të veçantë rivlerësimi është një aktiv, ndryshimi në vlerën e tij paraqitet në një nënzë të veçantë të aktiveve. Në të kundërt, në qoftë se elementi i mbrojtur për një periudhë të veçantë rivlerësimi është një pasiv, ndryshimi në vlerën e tij paraqitet në një nënzë të veçantë të pasiveve. Këta janë nënzëra të veçantë të përmendur në paragrafin AG114(g). Nuk kërkohet të bëhet një shpërndarje specifike midis aktiveve individuale (ose pasiveve individuale).
- AG124 Paragrafi AG114(i) vë në dukje që mosefektiviteti rrjedh në masën që ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur, të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, nuk është njëlloj me ndryshimin në vlerën e drejtë të derivativit mbrojtës. Një ndryshim i tillë rrjedh nga një sërë arsyesh, përfshirë:
- datat aktuale të rivlerësimit janë të ndryshme nga ato të pritshme, ose datat e pritshme të rivlerësimit që janë rishikuar;
 - zërat në portofolin e mbrojtur zhvlerësohen ose çregjistrohen;
 - datat e pagimit të instrumentit mbrojtës dhe elementit të mbrojtur janë të ndryshme; dhe
 - shkaqe të tjera (p.sh. kur një numër i vogël elementësh të mbrojtur mbartin interes me një normë më të ulët se norma bazë për të cilën ata janë projektuar si të mbrojtur, dhe për pasojë mosefektiviteti nuk është kaq i madh sa që portofoli si një i tërë nuk arrin të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës).

Ky lloj mosefektiviteti¹² duhet të identifikohet dhe të njihet në fitim ose humbje.

- AG125 Në përgjithësi, mosefektiviteti i mbrojtjes duhet të përmirësohet:
- në qoftë se njësisë ekonomike bën grafikun e zërave me karakteristika të ndryshme parapagimi në një mënyrë të tillë që merr parasysh dallimet në sjelljen e parapagimit.
 - kur numri i zërave në portofol është më i madh. Kur portofoli përmban vetëm pak zëra, mosefektiviteti është relativisht i lartë, në qoftë se një prej zërave parapaguhet më herët ose më vonë seç është parashikuar. Në të kundërt, kur portofoli përmban shumë zëra, sjellja e parapagimit mund të jetë e parashikuar me më tepër saktësi.
 - kur periudhat e rivlerësimit të përdorura janë më të vogla (p.sh. 1 muaj kundrejt 3 muajve periudhë rivlerësimi). Periudhat më të vogla të rivlerësimit zvogëlojnë efektin e një mospërputhjeje midis datave të rivlerësimit dhe të pagesës (brenda periudhës së rivlerësimit) të elementit të mbrojtur dhe atyre të instrumentit mbrojtës.
 - shpeshësia më e madhe me të cilën shumën e instrumentit mbrojtës rregullohet për të pasqyruar ndryshimet në elementin e mbrojtur (p.sh. për shkak të ndryshimeve në pritshmëritë e parapagimit).

¹² Në këtë kontekst zbatohen konsideratat për materialitetin njëlloj si në tërë SNRF-të.

AG126 Një njësi ekonomike teston efektivitetin periodikisht. Në qoftë se çmuarjet e datave të rivlerësimit ndryshojnë midis njerës datë në të cilën një njësi ekonomike vlerëson efektivitetin dhe tjetrës, ajo llogarit shumën e efektivitetit ose:

- (a) si diferencë midis ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (shih paragrafi AG114(h)) dhe ndryshimit në vlerën e tërë elementit të mbrojtur, që është i lidhur drejtpërdrejt me ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit (duke përfshirë efektin që ndryshimet në normën e mbrojtur të interesit kanë në vlerën e drejtë të çdo opsioni parapagimi të përfshirë). ose
- (b) duke përdorur përafrimin e mëposhtëm. Njësia ekonomike:
 - (i) llogarit përqindjen e aktiveve (ose pasiveve) në secilën periudhë rivlerësimi, që është e mbrojtur, mbi bazën e datave të çmuara të rivlerësimit në datën e fundit që testohet efektiviteti.
 - (ii) zbaton këtë përqindje për çmuarjen e rishikuar të shumës në këtë periudhë kohe rivlerësimi për të llogaritur shumën e elementit të mbrojtur bazuar në çmuarjen e rishikuar.
 - (iii) llogarit ndryshimin në vlerën e drejtë të çmuarjes së rishikuar të elementit të mbrojtur, që është i lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e mbrojtur, dhe e paraqet atë siç është parashtruar në paragrafin AG114(g).
 - (iv) njeh mosefektivitetin të barabartë me diferencën midis shumës së përcaktuar në pikën (iii) dhe ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (shih paragrafin AG114(h)).

AG127 Kur mat efektivitetin, njësi ekonomike dallon rishikimet për datat e çmuara të rivlerësimit të aktiveve ekzistuese (ose pasiveve) nga krijimi i aktiveve të reja (ose pasiveve), duke i konsideruar vetëm të parat si shkaktare të mosefektivitetit. Të gjitha rishikimet për datat e çmuara të rivlerësimit (përveç atyre të përjashtuara në përputhje me paragrafin AG121), përfshirë çdo rishpërndarje të zërave ekzistues midis periudhave, përfshihen kur bëhet rishikimi i shumës së çmuar në një periudhë kohe në përputhje me AG126(b)(ii) dhe po kështu edhe kur matet efektiviteti. Sapo njihet mosefektiviteti, siç është parashtruar më sipër, njësi ekonomike bën një çmuarje të re të aktiveve gjithsej (ose pasiveve) në secilën periudhë rivlerësimi, duke përfshirë aktivet e reja (ose pasivet) që janë krijuar qysh në periudhën e fundit të testuar për efektivitetin, dhe përcakton një shumë të re si element të mbrojtur dhe një përqindje të re si përqindje e mbrojtur. Procedurat e parashtruara në paragrafin AG126(b) përsëriten më pas në datën tjetër të testit të efektivitetit.

AG128 Zërat që janë planifikuar në fillim të periudhës së rivlerësimit mund të çregjistrohen për shkak të parapagimit më përpara seç pritej ose mund të pakësohen në vlerë për shkak të zhvlerësimit apo shitjes. Kur ndodh një gjë e tillë, shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë të përfshirë në nënzërin e veçantë, siç përmendet në paragrafin AG114(g), që ka lidhje me zërin e çregjistruar mund të hiqet nga bilanci dhe të përfshihet në fitimin ose humbjen neto që rrjedh nga kualifikimi për mosnjohje të zërit. Për këtë qëllim, është e nevojshme të njihet periudha(t) e rivlerësimit në të cilën zëri i çregjistruar ishte planifikuar, sepse kjo përcakton periudhën e rivlerësimit nga e cila ky zë duhet hequr si dhe shumën përkatëse të nënzërit të veçantë, siç përmendet në paragrafin AG114(g). Kur një zë çregjistrohet, në qoftë se ai mund të përcaktohet në cilën periudhë është përfshirë, ai hiqet nga kjo periudhë. Në qoftë se jo, ai hiqet nga periudha më e hershme, nëse shuma e çregjistrimit është më e larta e parapagimeve të pritshme ose të shpërndara mbi bazë sistematike dhe racionale në të gjitha periudhat që përmbajnë zërin e çregjistruar, kur zëri shitet ose zhvlerësohet.

AG129 Përveç kësaj, çdo shumë që ka lidhje me një periudhë të veçantë, që nuk është çregjistruar kur i ka mbaruar koha, njihet në fitim ose humbje në këtë kohë (shih paragrafin 89A). Për shembull, supozohet një njësi ekonomike që i programon zërat në tre periudha kohe rivlerësimi. Në ripërcaktimin e mëparshëm, ndryshimi në vlerën e drejtë të raportuar në një nënzë të vetëm në bilanc është një aktiv prej 25NJM. Kjo shumë përfaqëson shumat që lidhen drejtpërdrejt me periudhat 1, 2 dhe 3, përkatësisht 7NJM, 8NJM, dhe 10NJM. Në ripërcaktimin tjetër, aktivet që lidhen drejtpërdrejt me periudhën 1 ose paraqiten realisht ose riprogramohen në periudhat e tjera. Prandaj, shuma 7NJM çregjistrohet nga bilanci dhe njihet në fitim ose humbje. Shumat 8NJM dhe 10NJM lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë, përkatësisht, me periudhat 1 dhe 2. Këto periudha është e nevojshme që të rregullohen për ndryshimet në vlerën e drejtë siç përshkruhet në paragrafin AG114(g).

AG130 Për ilustrim të kërkesave të dy paragrafeve të mëparshme, supozohet që një njësi ekonomike i ka programuar aktivet duke i shpërndarë me një përqindje të portofolit për secilën periudhë të rivlerësimit. Supozohet gjithashtu që ajo ka programuar 100NJM për secilën nga dy periudhat e

para. Kur periudha e parë e rivlerësimit mbaron, aktivet për 110NJM çregjistrohen për shkak të ripagimit të pritshëm dhe të papritshëm. Në këtë rast, e gjithë shuma e nënzërit të veçantë, siç përmendet në AG114(g), e cila lidhet me periudhën e parë, hiqet nga bilanci, plus 10 për qind të shumës që lidhet me periudhën e dytë.

- AG131 Në qoftë se shuma e mbrojtur për periudhën e rivlerësimit zvogëlohet pa u çregjistruar aktivet (ose pasivet) përkatëse, shuma e përfshirë në nënzërin e veçantë, siç përmendet në paragrafin AG114(g), që lidhet me zvogëlimin, do të amortizohet në përputhje me paragrafin 92.
- AG132 Një njësi ekonomike mund të dëshirojë të zbatojë metodën e përshkruar në paragrafet AG114–AG131 për një portofol që më parë është trajtuar si mbrojtje e fluksit të mjeteve monetare në përputhje me SNK 39. Kjo njësi ekonomike mund të shfuqizojë përcaktimin e mëparshëm si mbrojtje të fluksit të mjeteve monetare në përputhje me paragrafin 101(d), dhe të zbatojë kërkesat e vendosura në këtë paragraf. Ajo, gjithashtu, ripërcakton mbrojtjen si një mbrojtje të vlerës së drejtë dhe zbaton metodën e përshkruar në paragrafet AG114–AG131 në mënyrë prospektive për periudhat kontabël të mëpasshme.

Periudha kalimtare (paragrafet 103-108B)

- AG133 Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë një transaksion parashikues ndërgrupor si një element të mbrojtur në fillim të periudhës vjetore që fillon më ose pas datës 1 janar 2005 (ose, për qëllime të rivlerësimit të informacionit krahasues, fillimi i një periudhe krahasuese më të hershme) në një mbrojtje që do të kualifikohej për kontabilitet mbrojtës në përputhje me këtë standard (siç është amenduar nga fraza e fundit e paragrafit 80). Kjo njësi ekonomike mund të përdorë këtë përcaktim për të zbatuar kontabilitetin mbrojtës për pasqyrat financiare të konsoliduara nga nisja e periudhës vjetore që fillon në ose pas datës 1 janari 2005 (ose nisja e periudhës krahasuese më të hershme). Gjithashtu, kjo njësi ekonomike duhet të zbatojë paragrafet AG99A dhe AG99B nga nisja e periudhës vjetore në fillim ose pas 1 janarit 2005. Megjithatë, në përputhje me paragrafin 108B, kërkohet të mos zbatohet paragrafi AG99B për informacionin krahasues për periudhat më të hershme.